

DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE

NUMËR 366 • VITI 34 • MAJ 2021 • SHEVAL 1442 • ÇMIMI 1 €

- As kërcënimet dhe as ofertat nuk e sprapsen Muhamedin a.s.
- Dimensionin individual dhe shoqëror të hilmit (butësisë) në dritën e Kuranit
- Roli i gruas në BLK për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm

Rreth kontributit dhe rolit të myslimanëve shqiptarë në mbajtjen dhe mbarëvajtjen e Kuvendit të Arbnit (1703)



Reagim

Me shqetësim kam përcjellë eskalimin e situatës në Jerusalem që filloi me dëbimin e dhunshëm të palestinezëve nga shtëpitë e tyre në Sheik Jarrah, për të vazhduar me atakimin dhe përdhosjen e institucionit të xhamisë së shenjtë Al-Aksa.

Shpreh brengën time të thellë dhe të besimtarëve myslimanë për dhunën e ushtruar ndaj banorëve palestinezë në Jerusalem dhe në territoret palestineze.

Eskalimi i konfliktit nga i cili humbën jetën njerëz të pafajshëm nga radhët e civilëve në fund të muajit të madhëruar Ramazan dhe në prag të festës së Fitër-Bajramit dëmton përpjekjet për marrëveshje ndërmjet dy popujve.

Jerusalemi është vendi i të gjitha feve e besimeve monoteiste, e si i tillë duhet të jetë edhe vend i bashkëjetesës e mirëkuptimit.

Lutemi që sa më parë Jerusalemi, Al-Aksa, dhe objektet e tjera të kultit të gjejnë qetësinë, ndërsa banorët e Jerusalemit të gjejnë paqen e sigurinë.


Prishtinë, 11 maj 2021

Myftiu i Kosovës

Naim ef. Tërnavë

Në këtë numër:

Editorial	4
Sabri Bajgora Komentimi i kaptinës El-Ahkaf – (2)	5
Dr. Ajni Sinani As kërcënimet dhe as ofertat nuk e sprapsen Muhamedin a.s.	8
Valmire Batatina Krasniqi Dimensioni individual dhe shoqëror i hilmit (butësisë) në dritën e Kuranit	12
Nexhmi Hoxha Fatihaja - Nëna e Librit	16
Argjent Xheladini Martesa në të drejtën e Sheriatit (2)	20
Dr. Jusuf el-Kardavi Gjendja dhe sfidat e të rinjve tanë	23
Muhamed Mutevelij esh-Sharavi Begatia e kënaqësisë	26
Prof. dr. Edin Tule Energjia negative në pusi	27
Prof. ass. dr. Rexhep Suma Format e shumta të mjeteve në komunikimin e daves	28
Nuridin Ahmeti Roli i krerëve fetarë myslimanë në unifikimin e alfabetit të gjuhës shqipe më 1908 (2)	31
Vaxhide Bunjaku Roli i gruas në BIK për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm	33
Elez Osmani Kujtime dhe të dhëna për haxhi Osmanin nga Morina (1)	35
Isra Hyseni Diskursi anti-emigrant si veçori e së djathtës populiste dhe ndikimi i tij politik në Evropë (1)	38
Drita e kulturës islame ka ndriçuar civilizimet botërore	41
Jeton Neziri Mësimi i fikhut në medresetë e Kosovës gjatë periudhës Osmane (1)	45
Klodiana Xhaferaj Historia e gjuhës arabe në Egjipt	48
M.sc. Artan S. Mehmeti Kontributi i Tusit (1201 – 1274) në gjeografi	50
Dr. Ardian Muhaj Rreth kontributit dhe rolit të myslimanëve shqiptarë në mbajtjen dhe mbarëvajtjen e Kuvendit të Arbnit (1703)	53
Agron M. Rexhepi Kontrolli mjekësor i sportistëve	57
Ma. Vehbi Shatri Haxhi Isa ef. Hasanaj	59
Aktivitete	61
Poezi	71



DITURIA ISLAME
REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE
E KULTURORE

Boton:

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës,
Prishtinë.

Kryeredaktor:

Dr. Ajni Sinani

Redaksia:

Prof. Sabri Bajgora, mr. Ramadan Shkodra,
dr. Fahrush Rexhepi, dr. Orhan Bislimaj,
dr. Faruk Sinani, mr. Muzaqete Kosumi,
mr. Besir Neziri dhe mr. Driton Arifi.

Sekretar në redaksi:

Dr. Rexhep Suma

Lektor & korrektor:

Bajram Zeqiri

Redaktor artistik & teknik:

Bashkim Mehani

Adresa:

Dituria Islame, rr. "Bajram Kelmendi" nr. 84,
10000 Prishtinë.

Tel & Fax: +383 38 224 024

email: dituriaislame@hotmail.com

dituriaislame@yahoo.com

www.dituriaislame.com

Parapagimi:

Evropë 25 €

Amerikë 40 USA \$

Shtypi:

Shtypshkronja "Printing press", Prishtinë

Martesa e myslimanes me jomyslimanin



“Mos u martoni me politeistët derisa të besojnë. Pa dyshim se skllavi besimtar është më i mirë se politeisti, edhe sikur t’ju pëlqejë...”

(El-Bekare, 221)

Të gjithë dijetarët myslimanë janë të një mendimi unanim se është e ndaluar që femra myslimane të martohet me cilindo qoftë, jashtë fesë së saj. Këtë e konfirmon edhe Ibën Mundhiri kur thotë se të gjithë dijetarët myslimanë që i kemi njohur janë të mendimit se një gjë e tillë është e ndaluar.

Imam Kurtubiu në “Xhamiul Bejan”, duke shpjeguar fjalët e Zotit, në ajetin kuranor “Mos u martoni me politeistët derisa të besojnë. Pa dyshim se skllavi besimtar është më i mirë se politeisti, edhe sikur t’ju pëlqejë...” (El-Bekare, 221), thotë se Allahu me përmendjen e tyre e ka ndaluar për myslimanen që të martohet me cilindo politeistë.

Për ta sqaruar këtë çështje, themi se Islami e lejon martesën e myslimanit me jomyslimanin dhe e ndalon martesën e myslimanes me jomyslimanin, ngase i gjithë legjislacioni islam është i ngritur mbi një urtësi të veçantë dhe mbi një interes të vërtetë për të dyja palët. Nga kjo shtrohet pyetja, se perse jomyslimanja lejohet për myslimanin, ndërkaq myslimania nuk lejohet për jomyslimanin, madje as edhe për ithtarët e librit? Ulemaja islame përgjigjen për këtë, veç tjerash, me sa vijon:

1. Islami është i lartësuar dhe asgjë nuk është i lartësuar mbi të. Dhe kavamja – përgjegjësia në martesë është në anën e burrit. Burri mund të ndikojë në gruan e tij, sa që ajo të mos mund t’i kryejë si duhet obligimet e saj fetare, gjë që mund të rezultojë edhe me braktisjen e fesë nga ana e saj. Gjithashtu prindi ndikon edhe te fëmijët të cilët e pasojnë babanë e tyre në fe.

2. Universalizmi dhe gjithëpërfshirja e Islamit dhe jo gjithëpërfshirja e feve të tjera. Kjo manifestohet në relacionet shoqërore që kanë të bëjnë edhe me institucionin e familjes dhe mirësjelljes ndaj saj.

Nga kjo rrjedhin tri situata:

a. Islami e ndalon martesën e myslimanit me idhujtaren apo me jobesimtare. Kjo për arsye se myslimani nuk mund t’i respektojë bindjet dhe traditat e bashkëshortes së tij idhujtare ose jobesimtare, gjë që do të çonte në prishjen e familjes dhe së fundi edhe në divorc. Islami e sheh shkurorëzimin si gjënë e lejuar më të urryer nga Zoti dhe nuk e stimulon atë. Prandaj, sipas Islamit është e ndaluar një martesë e tillë.

b. Islami e ka lejuar martesën e myslimanit me femrën e krishterë ose çifute, ngase Islami e respekton Isain a.s. (Jezusin), si të dërguar të Zotit, i cili ka lindur në mënyrë të jashtëzakonshme dhe e respekton nënën e tij, Merjemen (Marinë), si dhe e mbron atë nga shpifjet e ndryshme. Islami respekton edhe Musain a.s. (Mojsiun) dhe e konsideron atë të dërguar të Zotit për popullin çifut. Prandaj bashkëshortja e krishterë apo ajo çifute, që e respekton fenë e saj dhe dëshiron që edhe më tej (pas martese) të mbetet në fenë e saj të mëparshme mund ta bëjë një gjë të tillë dhe nuk do të gjente asgjë nga bashkëshorti ose nga familja e tij, që do ta largonte atë nga feja e saj, si dhe nuk do t’i nënshtrohej pakënaqësive, grindjeve apo edhe asaj më të keqes, ndarjes.

c. Islami e ka ndaluar martesën e jomyslimanit, të krishterit ose çifutit me femrën myslimane, ngase bashkëshorti jomysliman, i krishterë ose çifut nuk e beson Muhamedin a.s. si të dërguar të Zotit. Ata kanë paragjykime për Islamin dhe të dërguarin e tij. Prandaj, duke u nisur nga një qëndrim me platformë të pastër humane, është logjike që në Islam të jetë e ndaluar lidhja e martesave me karakter të tillë, ngase është e sigurt se në një atmosferë të tillë nuk do të ketë respektim të vlerave, gjë që pashmangshëm do të sillte mospajtime, kontradikta dhe në fund ndarje. Islami dëshiron familje të fortë, andaj llogarit që në bazat e tij të mos ketë marrëdhënie jo të qëndrueshme bashkëshortore.

Për rrjedhojë, lirisht mund të rezjetojmë se logjika islame nuk niset nga pikëpamje e kufizimit të lirisë në të drejtën martesore, por nga obligimi i ruajtjes së familjes nga shkatërrimi, gjë që do të shkaktohej për shkak të mosrespektimit të dispozitave të bashkëshortes myslimane nga bashkëshorti jomysliman dhe të afërmit e tij.

Dr. Ajni Sinani

Sabri Bajgora

Komentimi i kaptinës El-Ahkaf – (2)

Vërtetimi i ekzistencës së Allahut, i Njëshmërisë së Tij dhe tubimi pas Ringjalljes

حم ﴿١﴾ تَنْزِيلُ الْكِتَابِ مِنَ اللَّهِ الْعَزِيزِ الْحَكِيمِ ﴿٢﴾ مَا خَلَقْنَا
السَّمَاوَاتِ وَالْأَرْضَ وَمَا بَيْنَهُمَا إِلَّا بِالْحَقِّ وَأَجَلٍ مُّسَمًّى وَالَّذِينَ
كَفَرُوا عَمَّا أُنذِرُوا مُّعْرِضُونَ ﴿٣﴾ قُلْ أَرَأَيْتُمْ مَا تَدْعُونَ مِنْ دُونِ
اللَّهِ أَرُونِي مَاذَا خَلَقُوا مِنَ الْأَرْضِ أَمْ لَهُمْ شِرْكٌ فِي السَّمَاوَاتِ
اتَّبِعْنِي يَكْتَابْ مَنْ قَبْلَ هَذَا أَوْ أَثَارَةٍ مِنْ عِلْمٍ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ
﴿٤﴾ وَمَنْ أَضَلُّ مِمَّن يَدْعُو مِنْ دُونِ اللَّهِ مَنْ لَا يَسْتَجِيبُ
لَهُ إِلَى يَوْمِ الْقِيَامَةِ وَهُمْ عَنْ دُعَائِهِمْ غَافِلُونَ ﴿٥﴾ وَإِذَا حُشِرَ
النَّاسُ كَانُوا لَهُمْ أَعْدَاءً وَكَانُوا بِعِبَادَتِهِمْ كَافِرِينَ ﴿٦﴾

Koment:

1. *Hâ, Mîm.*

Kjo është surja e fundit nga grupi i sureve “Havamim” që fillojnë me shkronjat simbo- like Ha-Mim. Është folur gjerësisht, edhe më parë, se shkronjat simbolike të Kuranit, përbëjnë një urtësi të fshehtë të tij, kuptimin dhe urtësinë e cila fshihet pas tyre e di më së miri Allahu xh.sh. Forma e shkronjave që kanë ardhur në fillim të disa sureve, ishte një sfidë e drejtpërdrejtë për

idhujtarët mekas, të cilët ndonëse ishin të zotët në poezi, mbetën të pafuqishëm e të gjunjëzuar para fuqisë shprehëse të Kuranit famëlartë. Andaj, duke mos dashur të zgjero- hemi më tepër në këtë lëmë, mbetemi pranë konstatimit se këto shkronja përbëjnë një prej mrekullive më madhështore të Kuranit.

2. *Shpallja e Librit është prej Allahut, të Plotfuqishmit, të Urtit.*

Ky ajet, argumenton fuqishëm se Kurani është fjalë e Zotit, e zbritur prej të Plotfuqishmit e të Urtit. Ky

“*Hâ, Mîm. Shpallja e Librit është prej Allahut, të Plotfuqishmit, të Urtit. Ne nuk i krijuam qiejt e Tokën dhe atë që gjendet ndërmjet tyre, përpos me qëllim dhe me një afat të caktuar, e megjithatë, ata që nuk besuan janë mospërfillës ndaj paralajmërimeve që u bëhen. Thuaju: A nuk i shihni ata që i lutni në vend të Allahut? Më tregoni se çfarë krijuan ata në tokë?! A mos vallë kanë marrë pjesë në krijimin e qiejve?! Më sillni ndonjë Libër tjetër para këtij (Kuranit) ose ndonjë gjurmë diturie (nga Zoti), nëse flisni të vërtetën!*” Kush është më i humbur se ai, i cili, në vend Allahut, u lutet atyre që nuk mund t’u përgjigjen deri në Ditën e Kiametit. Ata janë të paditur për lutjet e tyre. Dhe kur të tubohen njerëzit (në Ditën e Llogarisë), ata (idhujt) do të jenë armiq të tyre dhe do t’ua mohojnë adhurimin e tyre.” – (El-Ahkaf, 1-6).

është kundërshtimi hyjnor që u bëhet haptazi shpifjeve të idhujtarëve se këtë Kuran po e sajonte vetë Muhamedi a.s., duke synuar famë, pasuri e pozitë. Prandaj, përmendja e këtyre dy emrave të Bukur të Allahut, i Plotfuqishëm dhe i Urtë, jep shenjë se Kurani është libër i zbritur me plot urtësi nga i Urti, i Plotfuqishmi që krijoi këtë ekzistencë me urdhrin hyjnor. “Bëhu!”. Kjo pjesë e ajetit: “Shpallja (Zbritja) e Librit është prej Allahut”, është e përshkruar me madhështi, të cilës nuk mund t’i



kundërvihet askush, sepse Ai që e ka shpallur këtë Kuran është Mbizotëruesi i tërë ekzistencës, është i Plotfuqishëm dhe i Urtë në caktimet dhe krijimin e Tij.¹ Prandaj, njerëzve, që logjikojnë, nuk u mbetet tjetër vetëm se të binden e të përulen para kësaj madhështie që të pushton me ngrohtësi e dashuri, ndërkohë, që idhujtarët, të verbuar nga prapësitë dhe ligësitë e shejtanit të mallkuar, e mohuan dhe e përgënjeshtroan dritën e udhëzimit që u erdhi.

Kurani famëlartë si Libër që i zbriti të Dërguarit të Allahut, me ajete dhe sure të caktuara, i ruajtur brez pas brezi, në zemrat dhe mendjet e besimtarëve, përbën vetëm një pjesë të Librit të Allahut, sepse pjesa tjetër është kjo gjithësi, e cila simbolizon Librin e hapur të Allahut, me plot argumente kozmologjike. Që të dyja këto libra nxisin për shikim, vrojtim e meditim dhe dëshmojnë për fuqinë dhe madhësinë e Allahut në krijim si dhe në mbajtjen e rregullit në këtë ekzistencë që Ai e krijoi. Si Kurani, ashtu edhe gjithësia dëshmojnë për urtësinë e Tij të pashoqe, ndërkohë që Libri i hapur i gjithësisë vërteton bindshëm çdo shkronjë të Kuranit si Libër i shkruar. Përderisa Kurani i shkruar vërteton Njëshmërinë e Allahut, se Ai është Zot i çdo gjëje dhe Krijues i çdo gjëje, i Cili përcakton dhe rregullon çdo çështje në këtë ekzistencë, Libri i hapur i gjithësisë flet me gjallëri për këto të vërteta, duke u nisur nga vetë krijimi i qiejve dhe i Tokës dhe i krijesave që i shpërndau nëpër to.²

3. Ne nuk i krijuam qiejt e Tokën dhe atë që gjendet ndërmjet tyre, përpos me qëllim dhe me një afat të caktuar, e megjithatë, ata që nuk besuan janë mospërfillës ndaj paralajmërimeve që u bëhen.

Ishte vullneti dhe urtësia e Allahut të Plotfuqishëm që të krijonte këtë gjithësi, që nënkupton qiejt dhe Tokën dhe krejt çka ka në mes tyre nga krijesat, dhe caktoi një afat për to, atëherë kur krejt kjo ekzistencë, me një urdhër të Tij, do të përmbysset e shkatërrohet,³ për të filluar një

**Fjala “bil hakki”
në këtë ajet, merr
dimensione të
shumta, dhe
nënkupton se
Allahu i ka krijuar
qiejt dhe Tokën
me qëllim të
caktuar, të cilin
krijim nuk i ka
paraprirë ndonjë
krijim apo
përmirësim tjetër.
(Sharavi)**

proces tjetër i jetës, ai i Ringjalljes dhe i marrjes në Llogari. Procesi i krijimit të qiejve me tërë madhësinë e tyre dhe të Tokës, si vend ku do të zhvillohej raca njerëzore, ndërlidhet fuqishëm edhe me dy emrat e bukur të Allahut të përmendur në ajetin e dytë të kësaj sureje: I Plotfuqishmi, I Urti, dhe dëshmon se kjo ekzistencë ka vetëm një Krijues të vetëm, i Cili është i Gjithëfuqishëm dhe i Urtë.⁴

Ajeti në fjalë është shumë i qartë, preciz dhe kuptimplotë, se kjo gjithësi është e krijuar me një qëllim të caktuar, me një rregull të përpiktë i cili nuk ndryshon dhe me nja afat të përfundimit të saj, të cilin nuk e di askush pos Allahut të Madhërishtëm. Dijetari i madh, Imam Sharavi, kur e komenton këtë pjesë të ajetit, thotë se fjala “bil hakki” në këtë ajet, merr dimensione të shumta, dhe nënkupton se Allahu i ka krijuar qiejt dhe tokën me qëllim të caktuar, të cilin krijim nuk i ka paraprirë ndonjë krijim apo përmirësim tjetër, por që nga fillimi, kjo gjithësi vazhdon të ekzistojë sipas një rregulli të përcaktuar hyjnor.⁵ E kur të vijë momenti i atij “afati të caktuar”, kjo gjithësi që e shohim do të pushojë së ekzistuari, dhe me shkatërrimin e saj, do të pasojë ringjallja dhe përjetësia në botën e Ahiretit.

Fundi i ajetit: “e megjithatë, ata që nuk besuan janë mospërfillës ndaj paralajmërimeve që u bëhen.”, tregon

për mëshirën dhe dhembshurinë e Allahut ndaj njeriut. Ai dërgoi pejgamberë të shumtë, të cilët i begatoi edhe me mrekulli të shumta mbinatyrore, për t’ua tërhequr vërejtjen popujve të tyre që të largoheshin nga mosbesimi apo adhurimi i idhujve, u zbriti Libra të shenjtë me të vetmin qëllim, përudhjen e njerëzimit në rrugën e drejtë. Por megjithatë, mohuesit, edhe përkundër këtyre fakteve bindëse, se kjo botë është kalimtare dhe se një ditë, krejt kjo çfarë shohim, do të shkatërrohet, nuk pranuan të besonin, se mund të ekzistojë diçka që nuk mund ta perceptonin me sytë dhe shqisat e tyre. Ata thjesht ishin mospërfillës ndaj të gjitha këtyre paralajmërimeve kuranore, andaj të tillët i pret ndëshkimin i dhimbshëm në Ahiret.

4. Thuaju: A nuk i shihni ata që i lutni në vend të Allahut? Më tregoni se çfarë krijuan ata në tokë?! A mos vallë kanë marrë pjesë në krijimin e qiejve?! Më sillni ndonjë Libër tjetër para këtij (Kuranit) ose ndonjë gjurmë diturie (nga Zoti), nëse flisni të vërtetën!

Pasi që idhujtarët në mënyrë kategorike mohonin Ditën e Gjykimit dhe Ringjalljen, Allahu i Madhërishtëm, sikur dëshiron që edhe njëherë t’ua japë rastin për t’u rikthyer në realitet, dhe nëpërmjet të Dërguarit a.s. iu drejtohet idhujtarëve të tregonin nëse këta idhuj që i adhuronin kot, kishin krijuar diçka?! Mos vallë ishin pjesëmarrës në krijimi e qiejve dhe të Tokës?! I Lartmadhërishtëm sikur i nxit të flisnin nëse kishin fakte logjike për këtë gjë, apo nëse kishin le të sillnin ndonjë argument, qoftë ai edhe nga ndonjë Libër i shenjtë para Kuranit siç ishin Tevrat, Zeburi dhe Inxhili ose prej fletushkave që u zbritën disa pejgamberëve, ose ndonjë gjurmë tjetër nga dituria e Zotit, e cila u qe dhënë disa të dërguarve të Allahut, të cilëve nuk u kishte zbritur ndonjë libër i shenjtë.

Por realiteti është se këta idhuj që i adhuronin, as nuk kanë krijuar gjë e as nuk janë pjesëmarrës në ndonjë

سُورَةُ الْحَقَّافِ

formë të krijimit, sepse janë thjesht gurë e dru, të ndërtuar në formë putash e statujash që të adhurohen nga mendjehetët dhe injorantët. Në lidhje me këtë flasin edhe ajete të shumta në Kuranin famëlartë, të cilat dëshmojnë, se Allahut, askush nuk ka mundësi t'i përzihet në sundim apo krijim, si p.sh.: "Thuaj: "A i keni parë idhujt që ju i adhuronin në vend të Allahut?! Më tregoni, çfarë kanë krijuar ata në Tokë?! Apo mos kanë ndonjë pjesë në qiej?! Mos vallë u kemi dhënë atyre ndonjë Libër, dhe ata mbështeten në të?! Jo, por mizorët i premtojnë njëri-tjetrit vetëm mashtrime" - (Fatir, 40); dhe: "Thuaj: "Thirrini ata, të cilët i menduat për zota në vend të Allahut!" Ata nuk kanë pushtet as sa pesha e një thërmije, qoftë në qiej apo në Tokë; dhe as që kanë në to ndonjë pjesë dhe Ai nuk ka prej tyre ndonjë ndihmës." - (Sebe'ë, 22) etj.

5. E kush është më i humbur se ai, i cili, në vend Allahut, u lutet atyre që nuk mund t'u përgjigjen deri në Ditën e Kiametit. Ata janë të paditur për lutjet e tyre.

Allahu i Madhërishtëm, në formë qortimi iu drejtohet edhe një herë idhujtarëve me fjalët, të cilat vlejné për mohuesit e Njeshmërisë në çdo kohë, se nuk ka humbje më të madhe se sa të adhurosh e t'i lutesh dikujt tjetër përveç Allahut. Nuk ka injorancë më të madhe se sa t'i lutesh atyre idhujve që nuk ishin tjetër veçse gurë dhe drurë të ngurtë, të cilët as nuk mund t'i dëgjonin lutjet e tyre, e lëre më t'u përgjigjen atyre.

Arsyja e përmendjes së fjalëve: "deri në Ditën e Kiametit", është një formë e shprehjes që përdoret figurativisht tek arabët, dhe ka

kuptimin: "derisa të zgjasë jeta në këtë botë", që do të thotë se prej tyre mos shpresoni asgjë, sepse ata nuk kanë as fuqi e as mundësi të bëjnë diçka për ju.

6. Dhe kur të tubohen njerëzit (në Ditën e Llogarisë), ata (idhujt) do të jenë armiq të tyre dhe do t'ua mohojnë adhurimin e tyre.

Kur të vijë Dita e Llogarisë së madhe, ku secili njeri do të përballet me amelet e tij, ajo do të jetë ditë e vështirë. Idhujtarët atë ditë do të stepen nga habia, sepse ata idhuj që i kishin adhuruar në këtë botë, tash do të shndërrohen në armiq të tyre. Sipas dijetarëve, në atë Ditë, Allahu do t'ju dhurojë këtyre idhujve mundësinë e të folurit, e këta do t'i mallkojnë idhujtarët pse i besuan si zota. Ata do të shfajësohen para Krijuesit fuqiplotë pse njerëzit i morën për zota, ashtu siç do të shfajësohen para Allahut edhe engjëjt, Isai a.s. dhe Uzejri a.s., për shkak se njerëzit i morën si zota dhe i adhuruan në vend të Allahut.

Në Kuran kemi shumë ajete që flasin për këtë tematikë, e prej tyre do të veçonim ajetet 81-82 të sures Merjem: "Ata morën në vend të Allahut zota të tjerë, për t'u krenuar me ta. Por jo! Ata (idhujt) do ta mohojnë adhurimin e tyre dhe do të bëhen armiq të tyre.", dhe ajetin 25 të sures El-Ankebut: "Ai (Ibrahimi) tha: "Dhe ai (Ibrahimi) tha: "Ju, në vend të Allahut, keni zgjedhur idhujt, për shkak të dashurisë midis jush në këtë jetë. Por, në Ditën e Kiametit do ta mohoni njëri-tjetrin dhe do ta mallkoni njëri-tjetrin. Fundi juaj do të jetë zjarri, dhe për ju nuk do të ketë ndihmëtarë."

Porosia e këtyre ajeteve - (1-6)

- Ajetet e para të kësaj sureje, sqarojnë bindshëm se Kurani nuk është fjalë e Muhamedit a.s., por është zbritje dhe Shpallje nga Allahu i Gjithëdijshëm dhe i Gjithëfuqishëm.

- Fjalët hyjnore në ajetin e tretë të kësaj sureje: "Ne nuk i krijuam qiejt e Tokën dhe atë që gjendet ndërmjet tyre, përpos me qëllim dhe me një afat të caktuar", dëshmojnë se krijuesi i vetëm i kësaj ekzistence është Allahu xh.sh. i Cili krijon me Vullnetin dhe Urtësinë e Tij. Kjo jetë ashtu siç e kishte fillimin, do ta ketë edhe fundin e saj, pas të cilës do të ketë ringjallje dhe dhënie të llogarisë, e pastaj varësisht nga veprat, përjetësi në Xhenet ose në zjarr të Xhehenemit.

- Fatkeqësisht, shumë prej këtyre argumenteve, hasën në vesh të shurdhër të jobesimtarëve, duke mos pranuar dritën e udhëzimit, prandaj, fundi i tyre tragjik do të jetë zjarri i Xhehenemit.

- Pasi Allahu xh.sh. ua sqaroi bazat themelore të besimit, Njeshmërinë, shpalljen - pejgamberinë dhe ringjalljen, tash i qorton idhujtarët për besimin e tyre të humbur, sepse adhurimi i idhujve ishte vërtet një kotësi, sepse ata idhuj ishin gjëra të ngurta që nuk mund t'i sillnin askujt dëm e as dobi. Përkundrazi, nëpërmjet tyre, shejtani i mallkuar kishte arritur të devijonte mendjet e njerëzve, duke i lënë shumë prej tyre në humbëtitë të përjetshme.

- vijon -

1. Grup autorësh, Et-Tefsir el mevdii li suveri-l Kuran, vëll. VII, Sharika, 2010, f. 180. 2. Sejjid Kutb, Fi Dhilalil Kuran, Kajro-Bejrut, 2003, vëll. VI, f. 3254. 3. Mus'afa el Adeviije, Et-Tes'hil li te'vili-t-tenzil -Tefsir Xhuz'u-l Ahkaf fi sualin ve xhevabin, Mekë, pa vit botimi, f. 8. 4. Dr. Muhamed Ebu Musa, Ale Hamim-El-Xhathijetu-el Ahkaf, dirasetun fi esrari-l bejan, Kajro, 2011, f. 330. 5. Muhamed Mutevel-li Esh-Sharavi, Tefsir esh-Sharavi-Havatiri havle-l Kurani-l Kerim, Kajro, 1991, f. 14153.

Dr. Ajni Sinani

As kërcënimet dhe as ofertat nuk e sprapsen Muhamedin a.s.

Fakti që i Dërguari i Allahut e vazhdonte thirrjen në Islam pavarësisht rethanave, i tërbonte politeistët. Ata filluan të intensifikonin luftën e tyre kundër myslimanëve, sepse feja islame u prekte interesat. Idhujtarët u drejtuan tek Ebu Talibi dhe kërkuan që ta pengonte nipin e tij ose të hiqte dorë nga mbrojtja e tij.

Një delegacion shkoi tek Ebu Talibi dhe i tha: “Ebu Talib! Nipi yt i ofendoi zotat tanë. E keqësoi fenë tonë. Ai tha se jemi të pamend dhe se baballarët e gjyshërit tanë kanë qenë në rrugën e gabuar. Tani, ti ose bëj që ai të heqë dorë nga këto; ose ti hiq dorë nga mbrojtja e tij.”¹ Ebu Talibi e qetësoi delegacionin me fjalë të mira dhe i largoi ata butësisht. Kurse Muhamedi a.s. vazhdoi t’i ftonë njerëzit në Islam.

Politeistët kur panë se asgjë s’ndryshoi, shkuan përsëri tek Ebu Talibi dhe i thanë: “O Ebu Talib! S’na mbeti më durim! Ti e di se biri i vëllait tënd e shan fenë dhe zotat tanë, kurse ne na fajëson për kokëtrashësi. Po që se nuk e bën tët nip të heqë dorë nga këto që bën, do të dalim kundër teje dhe atij! Ose bëje të heqë dorë nga kjo punë, ose hiq mbrojtjen prej tij! Pastaj e dimë ne se ç’i bëjmë!”²

Ebu Talibi ia tregoi Pejgamberit a.s. fjalët dhe qëndrimet e politeistëve dhe i tha: “Më mbro mua dhe veten!” I Dërguari i Allahut u mërzi shumë, se mos po tërhiqej xhaxhai i tij nga mbrojtja që i ofronte. Kurse

“O xhaxhai im! Të betohem se sikur kurejshët të kenë mundësi të më japin Diellin në dorën e djathtë dhe Hënën në dorën e majtë që të tërhiqem, unë nuk do ta bëj kurrë, deri kur Allahu ta lartësojë fenë, ose deri kur unë të vdes.

(Muhamedi a.s.)

myslimanët ishin ende të dobët dhe s’kishin fuqi t’u kundërviheshin politeistëve kurejshë të tërbuar, të dhënë ndaj pasurisë dhe fuqisë! Por me qëllim që i Dërguari i Tij të mund ta kapërcente situatën e vështirë ku ndodhej, Zoti i urdhëroi: “Po ti përmende Zotin tënd dhe plotësisht përkushtoj Atij! Zot i lindjes dhe i perëndimit, nuk ka të adhuruar tjetër të vërtetë pos Tij, pra Atë merre për mbështetje.” (El-Muzemil, 8-9).

Pas kësaj, të Dërguarit të Allahut iu largua shqetësimi. Me besim të palëkundur dhe me një guxim të lartë i tha Ebu Talibit fjalët e famshme: “O xhaxhai im! Të betohem se sikur kurejshët të kenë mundësi të më japin Diellin në dorën

e djathtë dhe Hënën në dorën e majtë që të tërhiqem, unë nuk do ta bëj kurrë, deri kur Allahu ta lartësojë fenë, ose deri kur unë të vdes.”³

Vendosmëria e Pejgamberit a.s. e preku në zemër Ebu Talibin i cili i tha: “O biri i tim vëllai! Eja dhe thuaj ç’të duash! Të betohem se s’do të të dorëzoj tek ata për asnjë çmim!” Madje, Ebu Talibi e kishte siguruar Abdulmutalibin i cili para se të vdiste, i kishte mbledhur të bijtë dhe i kishte pyetur se kush kishte për ta marrë nën mbrojtje nipin e tij. Ebu Talibi kishte thënë: “O im atë! Ti e di se unë s’jam i pasur, por, ama, jam zemërbutë dhe i dhembshur. E quaj si mirënjohje ndaj jetës sime që të kujdesem për birin e tim vëllai! Dhe po të jap fjalën për këtë!”⁴

Idhujtarët propozuan që ta këmbenin Umaren me Muhamedin a.s.

Pasi nuk e arritën që ta zmbrapsnin Muhamedin a.s. nga misioni i tij fisnik dhe kur panë se Ebu Talibi nuk po hiqte dorë nga nipi i tij, ata vendosën që ta shtonin presionin e tyre. Idhujtarët ia çuan Ebu Talibit Umaren, të birin e Velid bin Mugires, dhe i bënë një propozim të palogjikshëm: “Umare është më i fuqishmi dhe më simpatiku i të rinjve kurejshë. Merre ti dhe përfito nga mendja dhe fuqia e tij! Le të

bëhet biri yt! Kurse ne do të marrim tët nip i cili del kundër fesë së etërve të vet, i cili e përçan fisin dhe s'ia dëgjon fjalën. Na e dorëzo neve ta vrasim!” Ebu Talibi u tha: “Vallahi, shih se ç'propozim të keq që po më bëni! Ju doni të më jepni djalin tuaj që unë ta ushqej atë, kurse unë t'ua japë djalin tim që ju ta vrisni! Kështu, ë? Kjo është punë që s'bëhet.”⁵

Muhamedi a.s. e refuzoi ofertën e idhujtarëve për sundues të Mekës

I Dërguari i Zotit vazhdoi i vendosur dhe i pathyeshëm në misionin e tij. Prandaj idhujtarët u detyruan të zhdehen nga dehja e tyre, zëvendësuan metodat e torturimit dhe bënë përpjekje që me anë të një marrëveshjeje të ndalnin Muhamedin a.s.⁶ Pasi panë se s'nxorën gjë nga kërkesat dhe kërcënimet drejtuar Ebu Talibit, shkuan te Pejgamberi a.s. për ta marrë me të mirë. Për këtë qëllim ata dërguan Utbe bin Rebian te Muhamedi a.s., i cili i tha: “O biri i vëllait tim, ti ke një pozitë të lartë në mesin tonë, pasi që rrjedh nga një familje e mirë, por ti ke sjellë një gjë serioze me të cilën e ndave popullin

tonë. E ke quajtur mënyrën e jetesës së tij të budallepsur, ke folur për zotat e tij dhe të parët e tij i ke quajtur jobesimtarë. Dëgjomë, unë do të bëj disa oferta nga paria e Mekës me shpresë se do ta pranosh ndonjërin prej tyre. Nëse pasuria është ajo që kërkon, do të grumbullojmë një pasuri nga pronat tona që të jesh më i pasuri ndër ne. Nëse do nderim, do të bëjmë zotërinë tonë dhe nuk do të marrim vendim pa miratimin tënd. Nëse dëshiron mbretëri, do të bëjmë mbretin tonë, e nëse ke problem do të gjejmë një mjek dhe do të harxhojmë pasurinë tonë derisa shërimi yt të plotësohet.”⁷

Kur Utbe i mbaroi këto oferta, Muhamedi a.s. i tha: “Më dëgjo, o baba i Velidit dhe i lexoi një pjesë të Shpalljes që sapo kishte marrë:

“Ha, Mim. Zbritje prej të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëbërësit të madh! Libër që ajetet e tij janë të shkoqitura, duke qenë Kuran arabisht për një popull që di ta kuptojë. Është përgëzues dhe qortues, por shumica e tyre ia kthyen shpinën, prandaj ata nuk e dëgjojnë. Ata thanë: “Zemrat tona janë të mbyllura nga ajo që ti na thërret dhe në veshët tanë kemi shurdhim të rëndë, kështu që ndërmjet nesh dhe ndërmjet teje ekziston një perde, prandaj ti vepro sipas tëndes e ne

vazhdojmë tonën! Thuaj (o Muhamed): Unë jam vetëm njeri, sikurse edhe ju; mua më shpallet se Zoti juaj është vetëm Zoti Një, pra drejtojuni Atij dhe kërkon falje prej Tij. Për idhujtarët është mjerim i madh.” (Fussilet, 1-6).

Akoma pa përfunduar plotësisht Pejgamberi a.s., Utbe i frikësuar u ngrit dhe shkoi te shokët e tij. Pasi u ul ata e pyetën: “E ç'u bë? Çfarë lajme na solle?” Ai u përgjigj: “Për Zotin dëgjova fjalë që nuk i kam dëgjuar gjer më tani. Për Zotin, ato nuk janë vargje të poetit, as fjalë të magjistarit, e as murmuritje të fallxhorit. O popull, o kurejshë, bëhuni të dëgjueshëm dhe fenë e tij ma lini mua. Lëreni këtë njeri në gjendjen e tij dhe shmanguni nga ai. Betohem në Zotin se ligjërimi që dëgjova sjell porosi madhështore. Nëse arabët e refuzojnë, atëherë ajo do jetë e mjaftueshme për ju, por nëse të gjithë arabët e pranojnë atë, atëherë pushteti i tij do të jetë edhe i juaji, nami i tij do të jetë nami juaj, me të do të bëheni popull më fatlum.” Ata të tronditur i thanë: “O Ebu Velid, Muhamedi të paska bërë magji me gjuhën e tij!”⁸

Prijësit e kurejshëve e përsëritën përpjekjen duke e dërguar edhe një herë Utbe bin Rabia, bashkë me një delegacion. Shkuan te Muhamedi



“Unë s’kërkoj
asgjë prej jush, as
mall, as pasuri, as
sulltanat dhe as
prijësi! E vetmja
gjë që dua unë
prej jush, është
kjo: “Hiqni dorë
nga adhurimi i
idhujve dhe
adhuroni vetëm
Allahun që është
Një!



a.s bashkërisht.⁹ I Dërguari a.s. u tha atyre: “Kjo që po e thoni nuk ka të bëjë me mua. Me këtë që jam dërguar, nuk kam ardhur që të kërkoj pasuritë tuaja, as post e as pushtet mbi ju. Allahu më zgjodhi të Dërguar dhe më zbreti librin që të jem përgëzues dhe qortues. Unë ju njoftova me mesazhet e Zotit tim dhe ju këshillova. Nëse e pranoni prej meje atë me të cilën ju kam ardhur, ajo është fati juaj në këtë botë dhe në tjetrën, e nëse më refuzoni, do të duroj në caktimin e Allahut, derisa të gjykojë Allahu ndërmjet meje dhe juve”.¹⁰

Ata i thanë: “Meqë nuk i pranoni këto, ti e di se ne jemi shumë ngushtë për ujë e ushqim, prandaj lute Zotin tënd të na i bëjë kodrat ar, të na sjellë lumenj, të kemi kopshte dhe pallate prej ari!” Këto pyetje ishin shkak i shpalljes së ajeteve vijuese:¹¹

“Ata thanë: “Nuk të besojmë ty derisa të na nxjerrësh prej tokës burime”. Ose (nuk të besojmë derisa) të kesh kopshte me hurma e me rrush, e të bësh të rrjedhin vazhdimisht lumenj në mesin e tyre. Ose (nuk të besojmë derisa) të bie mbi ne qielli copa - copa, ashtu si po mendon ti (se do të na dënojë Zoti),

apo të na sjellësh Allahun dhe engjëjt pranë nesh. Ose të kesh një shtëpi prej ari, apo të ngjitesh lart në qiell, po ne nuk të besojmë për ngjitjen tënde derisa të na sjellësh një libër që ta lexojmë!” Thuaj: “Subhanallah - i Madhërishtëm është Zoti im, a mos jam unë tjetër vetëm se njeri, pejgamber?” (El-Isra, 90-93).

A është e logjikshme që njeriu që pretendon pushtetin dhe udhëheqjen të heshtë përpara personit i cili gjatë negociatave të shoqëruara me frikë, shpresë e kërcënim, i ofron pikërisht atë që ai pretendon dhe në fund t’i thotë atij se me këtë që jam dërguar, nuk kam ardhur që të kërkojë pasuritë tuaja, e as postin e pushtetin mbi ju?¹²

Muhamedi a.s. i refuzoi gjithë këto oferta dhe në vend të tyre zgjodhi më të vështirën. Këtë e përshkruan edhe James A. Michener: “Para mbarimit të jetës, Muhamedit a.s. i ofrohet mundësia që të bëhet sundimtar ose i shenjtë, por ai e refuzon edhe të parën edhe të dytën, duke insistuar në atë se ai është vetëm njeri i rëndomtë, detyra e të cilit është që t’ia komunikojë botës shpalljen e Zotit.”¹³

Pse Muhamedi a.s. nuk e pranoi kurrësi pasurinë, famën, pushtetin,

madhësitinë e rehatinë? Sikur të ishte i dhënë pas kërkesave materiale, udhëheqjes e pasurisë, a do t’i refuzonte ai gjithë ato oferta?! Njeriu duhet të mendojë, doemos, përse Muhamedi a.s., veçoi ashtu dhe a mund të dalin këto fjalë nga goja e një pretenduesi apo mashtruesi?!

Idhujtarët e Mekës pandehnin se do të mund ta bënin Pejgamberin a.s. të hiqte dorë nga çështja e tij me anë të pasurisë, pozitës dhe femrave që janë dobësia më e madhe e njeriut!

Ata mendonin se hz. Muhamedi nuk do t’u thoshte “Jo!” këtyre tri propozimeve që ata i kishin përdorur me sukses sa e sa herë ndaj ndonjë njeriu që e kishin vënë në shenjë. Pasuria, popullariteti dhe epshi janë tri kurthe egoiste që, në përgjithësi, e tresin vullnetin e njeriut. Mirëpo këto dhe gjëra të tjera të ulëta, nuk kishin pasur kurrë vend në jetën e ndritshme të të Dërguarit të Allahut. Në fakt, përgjigjja e hapur dhe e qartë e të Dërguarit të Allahut ishte: “Unë s’kërkoj asgjë prej jush, as mall, as pasuri, as sulltanat dhe as prijësi! E vetmja gjë që dua unë prej jush, është kjo: “Hiqni dorë nga adhurimi i idhujve dhe adhuronit vetëm Allahun që është Një!”¹⁴

Sinqeriteti dhe ndershmëria bëri që Muhamedi a.s. të jetë i durueshëm dhe t'i refuzojë të gjitha ofertat e idhujtarëve të Mekës. Edhe prifti dr. M. H. Duran, që u bë mysliman, thotë se njeriu duhet të mendojë, doemos, përse Muhamedi a.s., veprimi ashtu, nëse dëshiron të marrë përgjigjen e duhur, për këtë çështje dhe pyet: "A mundet njeriu të përfytyrojë një shembull të sakrificës së jetës, dashurisë dhe mirësisë ndaj të tjerëve, më të lartë se ky shembull?! Ne shohim këtu një njeri, i cili flizon lumturinë e tij personale për të mirën e të tjerëve. Ndërkaq, populli, për përmirësimin e gjendjes së të cilit ai bën përpjekje maksimale, ngrihet dhe e gjuan me gurë, sillet keq me të, e izolon dhe nuk i jep mundësinë për të kaluar një jetë të qetë, madje, as në izolim. Përkundër gjithë kësaj, ky njeri, refuzon që të pushojë së punuari për të mirën e tyre. A mundet që një mashtrues, njeri i pasinqertë, të tregojë një këmbëngulje dhe vendosmëri të tillë, besnikëri ndaj parimeve dhe ndaj tyre, deri në momentin e fundit, pa kurrfarë frike? Ai nuk u tregua i dobët përballë rreziqeve dhe persekutimeve të ndryshme, që s'mund të imagjinohen. Vërtet, ky besim dhe kjo përpjekje e vazhdueshme, këmbëngulësia dhe vendosmëria me të cilën e udhëhoqi Muhamedi a.s., luftën e tij deri në fitoren përfundimtare, është argument i qartë i bindjes së tij të plotë në thirrjen e tij. Sikur të kishte në vete, madje, vetëm një fije dyshimi ose të hamendej sadopak, ai kurrë s'do të arrinte t'i bënte ballë stuhisë, e cila vazhdoi për njëzet (e tri) vjet. Pas kësaj, a duhet të kërkojmë ndonjë argument tjetër, i cili do të dëshmonte për vërtetësinë dhe sinqeritetin e plotë të qëllimit, të moralit të drejtë dhe të lartësisë shpirtërore?"¹⁵

Madje në kohën kur Muhamedi a.s. i tha këto fjalë, myslimanët po u nënshtroheshin torturave dhe rreziqeve të shumta. Këto fjalë Muhamedi a.s. i tha kur myslimanët

dhe ai ishin në një pozitë shumë të vështirë, por bindja e plotë në Fuqinë e Zotit bënë që Pejgamberi a.s. të kishte qëndrim të paluhatshëm dhe ai nuk hezitoi për asnjë çast në vërtetësinë e misionit me të cilin e kishte ngarkuar Krijuesi i gjithësisë.

Propozimi për kompromis në adhurim

Idhujtarët nuk patën asnjë rezultat me ofertën që i bënë Muhamedit a.s. përmes Utbe bin Rebias, apo edhe nga një grup tjetër idhujtarësh, në mesin e të cilëve ishte Velid ibën Mugire dhe El As ibën Vaili.¹⁶ Kur Pejgamberi a.s. refuzoi çdo gjë, duke këmbëngulur në të vërtetën me të cilën ishte dërguar, idhujtarët mekas dërguan edhe një propozim tjetër duke i thënë: "Atëherë pra, adhuroi zotat tanë një vit dhe ne po adhurojmë Zotin tënd një vit. Kështu shuhet kundërshtimi mes nesh!"¹⁷

Muhamedi a.s. e refuzoi edhe këtë dhe, në lidhje me këtë ofertë të idhujtarëve, Zoti zbriti suren El-Kafirun: "Thuaj: O ju jobesimtarë! Unë nuk adhuroj çfarë ju adhuroni dhe ju nuk jeni adhurues të Atij që unë adhuroj. Unë nuk do të jem kurrë adhurues i atyre që ju i adhuroni dhe as ju nuk do të jeni adhurues të Atij që unë adhuroj! Ju

keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time!" (El-Kafirun, 1-6).

Kjo sure vërteton se adhurimi i takon vetëm Zotit, Një e të Vetëm. Prandaj propozimi që idhujtarët i bënë Muhamedit a.s., që ai të adhurojë një vit zotat e tyre, kurse vitin tjetër ata të adhuronin Zotin e Muhamedit a.s., ishte i papranueshëm dhe i refuzuar përgjithmonë. I Dërguari i Zotit e refuzoi qartazi propozimin dhe kjo sure u shpall për ta bërë të qartë pamundësinë për kompromis dhe tregti me normat e Allahut të Madhëruar, pamundësinë e propozimit të çdo forme të sinkretizmit fetar apo të pajtimtimit doktrinar ndërmjet feve dhe, rrjedhimisht, ndalimin e kryerjes së çdo rituali të përbashkët ndërfeetar.¹⁸

Këto dëshmi i mbështesin për muri të gjithë ata që supozojnë se motivi i Muhamedit a.s. në thirrjen e tij ishte dëshira për udhëheqje dhe pushtet, dhe ato vërtetojnë të kundërtën e supozimeve të tyre.

1. Safiurrahman el-Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i xhenetit, Prishtinë, 2002*, f. 99. 2. Osman Nuri Topbash, *Vargu i profetëve nën dritën e Kuranit, Hazreti Muhamed Muštafa, Shkodër, 2012*, f. 244. 3. Prof. dr. Ibrahim Saricam, *Hz. Muhamedi dhe mesazhi i tij universal, botimet e Kryesisë së Çështjeve Fetare të Turqisë, Ankara, 2018*, f. 137. 4. Ibni Hisham, 1, 276-278, sipas Osman Nuri Topbash, *Vargu i profetëve nën dritën e Kuranit, Hazreti Muhamed Muštafa, Shkodër, 2012*, f. 245. 5. Ibni Hisham, 1, sipas Osman Nuri Topbash, *op. cit.*, f. 245-46. 6. Safiurrahman el-Mubarekfuri, *Nektari i vulosur i xhenetit, op. cit.*, f. 130. 7. Martin Lings, *Muhamedi alejhi salam, jeta e tij sipas burimeve më të hershme, Logos A, Shkup, Prishtinë, Tiranë, 2011*, f. 75. 8. Mekijf Utbe bin Rabiah me Resulilah, *shih: https://islamstory.com/ar/artical/221* 9. Prof. dr. Ibrahim Saricam, *z. Muhamedi dhe mesazhi i tij universal, op. cit.*, f. 129. 10. Dr. Muhamed Seid Ramadan el-Buti, *Fikhu Sire, studime metodologjike-shkencore për biografinë e Muhamedit alejhi salam, Shkup, 2018*, f. 110. 11. H. Sherif Ahmeti, *përkthim me komentim në gjuhën shqipe, shih komentin në f. 337*. 12. Dr. Muhamed Seid Ramadan el-Buti, *Fikhu Sire, studime metodologjike-shkencore për biografinë e Muhamedit alejhi salam, op. cit.*, f. 112. 13. Mr. Ajni Sinani, *Të tjerët për Islamin, Prishtinë, 2015*, f. 127. 14. Ibni Kethir, *El-Bida'je, 111, 99-100, sipas Osman Nuri Topbash, Vargu i profetëve nën dritën e Kuranit, Hazreti Muhamed Muštafa, op. cit.*, f. 247-48. 15. Dr. Imadudin Halil, *Kalu anil islam, Rijad, 1412/1992*, f. 105-106, sipas: Ajni Sinani, *Të tjerët për Islamin, op. cit.*, f. 148. 16. Prof. dr. Ibrahim Saricam, *Hz. Muhamedi dhe mesazhi i tij universal, op. cit.*, f. 130. 17. Dr. Muhamed Seid Ramadan el-Buti, *Fikhu Sire, op. cit.*, f. 110. 18. Prof. Hasan I. Nahi, *Kurani i madhërishtë, shih komentin e sures El-Kafirun, f. 684*.



Valmire Batatina Krasniqi

Dimensioni individual dhe shoqëror i hilmit (butësisë) në dritën e Kuranit

Hilmi, si një nga virtytet më të rëndësishme të moralit islam, ndikon në zhvillimin e individit, po aq sa luan rol edhe në formësimin e një shoqërie të shëndoshë me virtyte të larta njerëzore.

Në literaturën islame, hilmi përshkruhet si një virtyt, pronarët e të cilit vlerësohen si njerëz të qetë, zemërbutë, që veprojnë me urtësi në raste zemërimi dhe që nuk nxitojnë në dënim ndaj të padrejtëve. Një ndër përshkrimet e tjera të atribuara për hilmin është edhe cilësimi i tij si një nocion përmbledhës i të gjitha virtyteve të bukura dhe mbizotërimit të mendjes mbi pasionet.¹

Roli i hilmit në zhvillimin moral të individit

Falja, zemërbutësia, urtësia, sikurse edhe zemërimi, mospërfillja dhe përçmimi janë emocione që çdo individ i bartë në vete, e të cilat fillojnë qysh me lindjen e tij. Në shkencën e psikologjisë, frenimi nga emocionet dhe mendimet negative siç janë zemërimi, dhe pakënaqësia në momentet e ballafaqimit me padrejtësi konsiderohet falje.² Ndërsa, në mënyrë që njeriu të mos jepet pas gjërave të përkohshme dhe traditave të këqija të shkaktuara nga fryma fisnore, Kurani famëlartë vendosi urtësinë dhe zemërbutësinë që do të thotë frenim i egos dhe mbrojtje nga zemërimi dhe dhuna. Në këtë mënyrë ai synon të mësojë

Në mënyrë që njeriu të mos jepet pas gjërave të përkohshme dhe traditave të këqija të shkaktuara nga fryma fisnore, Kurani famëlartë vendosi urtësinë dhe zemërbutësinë që do të thotë frenim i egos dhe mbrojtje nga zemërimi dhe dhuna.

qenien njerëzore që të përballet me energjitë negative ndaj vetes së tij apo ndaj të tjerëve, me luftën ndaj tendencave të këqija si dhe të përballoj dhe mposhtë egon e tij. Hilmi në kuptimin kuranor paraqet individin i cili është një strukturë e përfutur nga bashkimi i disa aftësive intelektuale siç janë: mendja, intelijenca, njohuria, përvoja, mundësitë fizike dhe materiale, dhe disa virtyte morale siç janë: falja, toleranca, durimi, mbizotërimi i vetvetes së tij, duke menaxhuar dhe tejkaluar zemërimin dhe duke mos u zhytur në nxitje dhe provokime. Pra, njeri i urtë dhe i mençur konsiderohet çdo person mendjemprehtë që vepron me mendjen e tij dhe që i

përgjigjet provokimeve duke parashikuar se çfarë rezultati mund të sjellë fundi i një debati, bisede apo diskutimi të caktuar.

Në suren e tretë të Kuranit famëlartë, në ajetet 133-134 është urdhëruar në këtë mënyrë: “Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe Xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit.”³

Në versetin e parë, fillimisht besimtarëve u tërhiqet vëmendja me një ftesë për parajsën, hapësira e të cilit është sa qiejt e Toka dhe menjëherë vazhdohet me përmendjen e karakteristikave që duhet të posedojnë njerëzit e denjë për këtë vend e që janë: Shpenzimi në rrugën e Zotit në kohëra të bollëkut (mirëqenies) dhe të vështirësive (pakësimi), mposhtja dhe mbizotërimi i zemërimit dhe falja e gabimeve të njerëzve pa asnjë kompensim. Nëse të gjitha këto veprime bëhen për të përfutur kënaqësinë e Allahut, padyshim që do të këtë shpërblim në këtë botë dhe në botën tjetër. Prandaj mund të vihet re se ndjenja e devotshmërisë te njerëzit manifestohet me virtytin e hilmit, pra me mposhtjen e zemërimit dhe faljen e njerëzve. Përveç kësaj në versetet më sipër, marrëdhënia hilm-ihsan (urtësi-mirësi) tërheq vëmendjen në mënyrë të veçantë. Njerëzit të cilët janë të

bindur në mbikëqyrjen e vazhdueshme të Krijuesit dhe veprojnë me këtë ndërgjegje, veprojnë ose sillen në mënyrën më të përsosur. Sipas Raziut me frazën “e mposhtin zemërimin” janë për qëllim njerëzit të cilët edhe pse zemërohen nuk vazhdojnë në të, e mposhtin dhe e mbizotërojnë atë. Kjo sjellje nuk rrjedh në mënyrë të rastësishme, por është si rezultat i hilmit, pra rrjedh nga urtësia dhe durimi.⁴

Njerëzit me virtyte të tilla, pavarësisht se janë në gjendje t’u hakmerren e t’u kundërvihen atyre prej të cilëve kishin përjetuar padrejtësi, nuk e bëjnë një gjë të tillë. Dominimi i zemërimit është virtyt i madh i cili mësohet me durim dhe përpjekje. Të jesh i durueshëm dhe të falësh është diçka që kërkon vullnet të fortë. Tejkalmi i zemërimit është hapi i parë, por nuk është i mjaftueshëm. Për këtë arsye, në versetet e mësipërme zemërimi trajtohet në mënyrë të veçantë duke përmendur faljen e fajeve të njerëzve. Personi i cili është i mposhtur nga zemërimi zhvillon një ndjenjë rëndimi dhe një zjarr në zemrën e tij. Mirëpo nëse zgjedh faljen, shpëton nga barra e rëndesa dhe rifiton qetësinë e mendjes dhe ndërgjegjes.

Kjo lë të nënkuptohet se gjërat të cilat përshkruhen në këto versete kuranore mund të arrihen pas një procesi serioz të vetë-edukimit, pjekurisë dhe vetëbesimit, dukuri këto të cilat ndihmojnë në formësimin e një personaliteti dhe karakteri të qëndrueshëm, karakter ky me të cilin qenia njerëzore gjen paqen në veten dhe në rrethin e tij. Sipas asaj që transmetohet nga Ibën Omeri, në lidhje me këtë çështje i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Nuk ka glënjë më të madhe për sa i përket veprës së mirë në prani të Allahut sesa një glënjë zemërimi e gëlltitur nga një besimtar vetëm me qëllim të fitimit të kënaqësisë së Allahut.”⁵ Kjo tregon se me të vërtetë gëlltitja apo mposhtja e zemërimit dhe falja e njerëzve janë veçori me të cilat shquhen besimtarët e devotshëm

Bamirësia, drejtësia në marrëdhëniet me njerëzit, si dhe largimi nga mizoria, arroganca, epshi dhe pasionet janë disa nga veçoritë e hilmit.

e që të gjitha këto arrihen përmes një edukimi serioz në frymën e Kuranit famëlartë.

Veprimi me urtësi shpëton njeriun nga emocionet dhe mendimet e gabuara, zemrës i shton paqe dhe rehati shpirtërore, çon në lehtësimin e barrës, brengës dhe uljen e stresit. Falja e gabimeve të të tjerëve është akti më i bukur dhe është liria më e madhe. Kurse njeriu që akumulon urrejtje në veten e tij ngjason me atë që mbart një barrë të rëndë në shpinën e tij me të cilën i kufizohet

liria. Po ashtu me akumulimin e zemërimit, njeriu mund t’i shkaktojë helmim dhe shkatërrim vetes së tij dhe të nxisë në ndëshkim apo hakmarrje të padrejtë. Ndërsa ndjesia për të hequr dorë edhe kur posedon fuqinë për të ndëshkuar është më e kënaqshme sesa ndjenja e hakmarrjes.

Megjithatë, me faljen ndaj gabimeve të njerëzve nuk nënkuptohet nënshtrim i plotë ndaj padrejtësive dhe parregullsive që mund të bëhen nga njerëz të pandërgjegjshëm e zullumqarë. Vargjet e mëposhtme në veprën “Safahat” të poetit dhe mendimtarit të famshëm Mehmet Akif Ersoj përshkruajnë karakterin e stolisur me urtësi dhe zemërbutësi dhe të qëndrueshëm në raste të caktuara: “Nëse unë jam i urtë, kush tha se jam dele e butë? Ndoshta mund t’i pritët qafa ime, por nuk dorëzohet që ta tërheqësh kah të duash.”⁶ Si rezultat, mund të themi se të posedosh një karakter të stolisur me urtësi do të thotë të posedosh një tipar të përgjithshëm moral që kërkon cilësinë e tolerancës dhe karakter të butë, pjekuri dhe veçori pozitive të sjelljes.



Roli i hilmit në formimin e një shoqërie të virtutshme

Hilmi, sikur që është një ndër karakteristikat më të rëndësishme për zhvillimin e personalitetit, ai po ashtu luan një rol jashtëzakonisht të madh edhe në zhvillimin e një shoqërie të shëndoshë dhe të virtutshme. Bamirësia, drejtësia në marrëdhëniet me njerëzit, si dhe largimi nga mizoria, arroganca, epshi dhe pasionet janë disa nga veçoritë e hilmit. Individët të cilët shquhen me këto karakteristika krijojnë marrëdhënie shoqërore të shëndosha, ndërsa ata të cilët i nënshtrohen zemërimit të tyre janë shkaktarë të shkatërrimit të rendit në shoqëri dhe prishjes së miqësive të shumta duke i kthyer në armiqësi.

Allahu i Madhëruar duke theksuar rëndësinë e forcimit të marrëdhënieve njerëzore dhe besnikërisë në vendosjen e paqes shoqërore urdhëron: “Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë. Ky virtyt u dhurohet vetëm atyre që durojnë dhe

vetëm atyre që kanë një fat të madh.” (Fussilet, 34-35)

Parimi “Të keqen ktheje me të mirë”, është një princip themelor në krijimin e një shoqërie të shëndoshë. Në sqarimin e këtij verseti kuranor Zemahsheri thotë: “Nëse dikush ju bënë ndonjë të keqe, është mirë që t’ia falni, por që t’ia ktheni me të mirë është vepër edhe më fisnike. Në rast të tillë edhe armiku shndërrohet në mik.”⁷ Sipas shumë komentatorëve, në këto versete vihet në pah fakti që besimtarët janë të denjë për të bërë vepra të mira. Si rezultat vepruesit e së mirës në këtë botë respektohen, ndërsa në botën tjetër i pret shpërblim i shumëfishtë. Andaj porositet për durim ndaj sjelljes arrogante dhe injorante të njerëzve, sepse herët apo vonë edhe ata do të jenë të turpëruar nga përfundimi famëkeq i këtyre veprave.

Falja është një nga metodat edukative të Islamit e cila preferohet më shumë sesa ndëshkimi apo hakmarrja qoftë edhe me të drejtë. Kurse kthimi i të keqes në të njëjtën masë shton hidhërimin, zemërimin dhe humb turpin. Fakti që luftimi i të keqes me të mirë i kthen armiqësitë në miqësi të sinqerta është një shpjegim i rëndësishëm

për psikologjinë morale dhe paqen sociale.

Edhe pse mosmarrëveshjet ndër-mjet njerëzve mund të parandalohen me rregulla ligjore, për mbarëvajtjen e një shoqërie të shëndoshë, principi i faljes do të jepte rezultate shumë më të frytshme. Në ditët e sotme kur liritë individuale janë në shkallën më të lartë, nevoja për edukimin dhe këshillimin e njerëzve kah principet e mirësisë dhe të drejtësisë që përfshijnë: faljen, bamirësinë dhe pranimin e të drejtës së tyre është shumë aktuale. Më e kërkuara ndër

Vazhdimësia në zemërim dhe urrejtje shkakton presion mbi trupin e njeriut dhe me kalimin e kohës mund të bëhet faktor kyç i shumë sëmundjeve neurologjike, dëmtimit të sistemit imunitar, çekuilibrit hormonal dhe rritjes së presionit në gjak.



këto principe është falja, e në veçanti në raste kur hakmarrja është e mundur dhe e lehtë, sepse një tolerancë dhe falje e tillë do të largonte ftohtësinë dhe armiqësinë e njerëzve. Me parimin e faljes dhe kthimit të së keqes me të mirë janë për qëllim rastet e shkeljeve të të drejtave personale, ndërsa kur vije në fjalë sistemi i besimit dhe të drejtat publike nuk mund të bëhet falje për tolerancë. Toleranca ndaj të keqes nuk duhet të kundërshtojë parimet themelore të fesë dhe nuk duhet të dëmtojë të mirën e përbashkët të shoqërisë dhe individit.

Mungesa e hilmilit, rezultat i shumë problemeve në shoqëri

Në këtë epokë kur është shtuar padrejtësia dhe gjykimimi mizor, hilmii i cili në vete ngërthen durimin, qetësinë dhe respektin për të gjitha gjallesat, i rekomanduar dhe këshilluar me Kuran dhe Sunet, është më se i domosdoshëm. Gazaliu, duke thënë se hilmii është ilaç i çdo dhembjeje,⁸ kishte për qëllim të sqaronte se mungesa e tij është shkaktar i shumë problemeve dhe sëmundjeve shoqërore.

Emocionet negative siç janë zemërimi, urrejtja, zilia, mendimi i keq, fjala e keqe, kacafytja dhe vrasja, rrjedhin si rezultat i një veprimi të pamenduar, i nënshtimit ndaj egos dhe kënaqësive të përkohshme. Njerëzit që u nënshtrohen këtyre ambicieve dhe e humbin kontrollin ndaj tyre nuk mund t'i shohin gjërat me qetësi. Emocionet negative të cilat rrjedhin si mungesë e urtësisë dëmtojnë po ashtu shëndetin psikik dhe fizik të qenies njerëzore. Vazhdimësia në zemërim dhe urrejtje shkaktan presion mbi trupin e njeriut dhe me kalimin e kohës mund të bëhet faktor kyç i shumë sëmundjeve neurologjike,

dëmtimit të sistemit imunitar, çekuilibrit hormonal dhe rritjes së presionit në gjak.

Mungesa e urtësisë përveç që është shkaktar i shumë problemeve tek individ, ajo po ashtu shkaktan edhe shumë trazira brenda familjeve dhe shoqërisë. Siç dihet, dinamika themelore e komunikimit brenda familjes është dashuria dhe dhembshuria. Të duash kërkon dhembshuri, kurse mëshira shumëfishohet me dashuri. Një individ nuk mund që në të njëjtën kohë të thotë: “Edhe e dua atë edhe e rrahë!”, sepse kur ngritët dora për dhunë, atëherë nuk mund të bëhet falje për dashuri dhe dhembshuri. Kjo dhe sjellje të ngjashme janë shkaktare të shkatërrimit të foleve të cilat janë krijuar për të gjetur paqen dhe lumturinë. Ashtu sikur që një zemër e sëmurë shkaktan shqetësime në të gjithë trupin, një familje që nuk mund të mbajë një lidhje të shëndoshë dhe të frytshme mund të rezultojë me kriza të mëdha shoqërore. E që e gjitha rrjedh si shkak i mungesës së urtësisë dhe faljes së ndërsjellë.

Në lidhje me këtë, Zoti i Madhëruar na sjellë shembullin më të mrekullueshëm që ka ndodhur ndonjëherë në historinë njerëzore: “Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishte i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj, falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet,

Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.” (Ali Imran, 159).

Ky ajet kuranor pasi që tregon atë se Zoti Fuqiplotë e kishte pajisur Muhamedin a.s. me fisnikëri të lartë e zemër të butë dhe urtësi, flet për sjelljen e tij të suksesshme dhe mënyrën e përfutimit të zemrave të njerëzve, në të njëjtën kohë thekson se sjellja e vrazhdë dhe e keqe do të ndikonte negativisht në suksesin e mesazhit hyjnor. Kjo nënkupton edhe faktin që morali dhe vetë-educimi janë ndër gjërat me të rëndësishme për çdo individ. Ata të cilët nuk frenojnë dhe edukojnë anën shpirtërore të tyre nuk mund të udhëheqin me të tjerët.

Dhembshuria, mirësia, butësia, të qenit i ndjeshëm dhe i butë, të qenit i durueshëm, të vepruarit me dinjitet, gëlltitja e zemërimit, të qenit i qetë, i përlulur dhe dinjitoz janë nga cilësitë e mira morale të besimtarëve. Kombinimi dhe aplikimi në jetën e përditshme i këtyre cilësive të bukura mund të përkufizohet si hilmii. Pronarët e urtësisë janë ata njerëz me moral të lartë, që nuk hakmerren, dinë të mbrojnë të drejtat e tyre, nuk poshtërohen dhe nuk heqin dorë asnjëherë nga rruga e faljes. Në të njëjtën kohë vlen të theksohet se hilmii duke qenë një gjendje shpirtërore që ngërthen në vete cilësi të larta morale, është një tregues i shkëlqyeshëm i pjekurisë. Për këto arsye, ai pasqyron ekuilibrin e sjelljes së mendjes dhe është gjendja shpirtërore më e lartë që kërkohet nga çdo besimtar.



1. *Universiteti: “Uludağ”, Bursa/Turqi, İnstitutu i Shkencave Sociale, Fakulteti i Ilahijatit, Bazat e Shkencave Islame/Tefsir. El-Xhurxhani, Mu'xhemu l-Tâ'rifat, Kajro: Daru l-Fazile, f. 98; Et-Tahanevi, Keshshafu l-İstilahati l-Funun ve l-'Ulum, Bejrut: Mektebetu Lubnan, 1996, V. I, f. 706. 2. Yaşaroğlu, Kamil, “Kin ve Nefreti Sevgiye Dönüştüren Erdem: Affetmek, Simpoziumi: Kutlu Doğum Haftası “Hz. Peygamber ve Kardeşlik Hukuku”, Ankara, f. 244. 3. Ali Imran, 135-136. 4. Er-Razi, Mefâtihi l-Gajb, Liban: Daru l-Fikr, 1401/1981, V. IX, f. 7. 5. İbni Maxhe, 3. 6. Mehmet Akif Ersoy, Safahat, Ankara: Şhi'pia botuese: Türkiye Diyanet Vakfı, 2010, f. 358. 7. Ez-Zemahsheri, El-Keshshaf, Rijad: Mektebetu l-Ubejkan, 1418/1998, V. III, f. 392. 8. Gazali, İhau Ulumi d-Din, İstanbul: Merve Basım, 1993, V. III, f. 398.

Nexhmi Hoxha

Fatihaja - Nëna e Librit

“Betohem në Atë, që shpirtin tim ma ka në dorë se si ajo nuk ka zbritur as në Tevrat, as në Zebur, as në Inxhil dhe as në Kuran. Ajo është sure me shtatë ajete që përsëriten, e që më është dhënë njësoj si Kurani i Madhërishtëm.”
(Muhamedi a.s.)

Vlera dhe rëndësia e sures Fatiha

Janë të shumta hadithet e Pejgamberit a.s. të cilat flasin për vlerën dhe rëndësinë e sures Fatiha. Transmeton Buhariu në koleksionin e tij nga Seid bin el-Mualaja, i cili ka thënë: “Isha duke u falur në xhami dhe më thirri i Dërguari i Allahut a.s., e të cilit nuk iu përgjigja derisa e kreu namazin. Pastaj kur shkova tek ai më tha: “Çka të pengoi për të mos ardhur?” “Isha duke u falur” – iu përgjigja. Ai tha: “A s’ka thënë Allahu: “O ju që besuat përgjigjuni Allahut dhe të Dërguarit kur t’ju thërret...”¹, pastaj shtoi: “Do të të mësojë një sure para se të dalësh

Duke lexuar pjesën e parë të kësaj sureje, ajetet (1-5), besimtari dëshmon besimin e vet në njëshmërinë e Zotit, duke e përshkuar Atë me cilësitë e Tij më të bukura.

nga xhamia, e cila është surja më e rëndësishme e Kuranit.” Më mori pastaj për dorë dhe kur deshi të dilte i thashë: “O i Dërguari i Allahut, a nuk më thatë se do të ma mësoje një sure, e cila është surja më me vlerë e Kuranit?” Ai më tha: “El-hamdu lil-lahi Rab-bil alemin..., është me shtatë ajete të përsëritura, e cila më është zbritur ashtu si edhe Kurani i Madhërishtëm.”²

Gjithashtu, transmetohet nga Imam Ahmed i Musnedin e tij, se Ubeje ibën Kabi ia ka lexuar Pejgamberit a.s. suren El-Fatiha, dhe ai ka thënë: “Betohem në Atë, që shpirtin tim ma ka në dorë se si ajo nuk ka zbritur as në Tevrat, as në Zebur, as në Inxhil dhe as në Kuran. Ajo është sure me shtatë ajete që përsëriten, e që më është dhënë njësoj si Kurani i Madhërishtëm.”³

Zbritja e sures Fatiha

Surja Fatiha është njëra ndër suret që ka ngjallur diskutime të shumta te dijetarët për vendin e zbritjes së saj. Nga mendimet e tyre se a është e zbritur në Meke para hixhretit apo ka zbritur në Medine, dalin këto qëndrime:

Shumica e dijetarëve mendojnë se surja Fatiha është sure mekase, madje e para e zbritur komplet. Argument për këtë ata e marrin ajetin kuranor: “Ne t’i kemi dhënë shtatë (ajete) që përsëriten, si dhe Kuranin e Madhërishtëm.”⁴



Ky qëndrim rrjedh nga Aliu, Ibën Abasi, Ali ibën Husejni, Katadeja etj.

Në grupin e dytë bëjnë pjesë dijetarët të cilët mbrojnë mendimin se kjo sure është medinase. Ky mendim rrjedh nga Ebu Hurejre, Ata bin Jesari, Muxhahidi, Zuhriu etj.

Disa komentues të Kuranit mbrojnë mendimin se surja El-Fatiha ka zbritur dy herë, një herë në Meke para hixhretit, me rastin e obligimit të namazit, ndërsa herën e dytë ka zbritur në Medine, me rastin e ndërrimit të Kibles. Sipas këtyre dijetarëve, kjo sure do të duhej të quhej surja mekase-medinase.

Ebu Lejth es-Semarkandi mendon se gjysma e sures ka zbritur në Meke, ndërsa gjysma tjetër ka zbritur në Medine.⁵

Ibën Atije tregon se disa dijetarë mendojnë se Xhibrili a.s. nuk ia ka zbritur Pejgamberit a.s. këtë sure, duke u bazuar në hadithin e Pejgamberit a.s., të cilin e transmeton Muslimi nga Ibën Abasi, i cili ka thënë: “Kanë qenë duke qëndruar së bashku Xhibrili a.s. me Pejgamberin a.s., dhe nga qielli është dëgjuar një zë. Xhibrili a.s. ngriti kokën e tij dhe tha: “Kjo derë e qiellit e hapur sot, nuk është hapur kurrë më parë”, dhe prej saj zbriti një melaqe dhe më pas Xhibrili tha: “Kjo melaqe e zbritur sot në tokë nuk ka zbritur asnjëherë më parë”, i përshëndeti dhe i tha: “Të përgëzojë me dy drita, të cilat të janë dhënë ty, e që nuk ju kanë dhënë asnjë pejgamberi para teje, e ato janë surja Fatiha dhe fundi i sures El-Bekare.”⁶

Kjo sure në vete përmban shtatë ajete, në të cilat janë përmbledhur qëllimet themelore të cilat i synon Kurani fisnik, e që janë:

Besimi në Zotin Një, të Vetëm, Krijues të gjithësisë, i emëruar dhe i cilësuar me emrat dhe cilësitë më të bukura;

Besimi në ringjallje, në jetën e pasosur, në botën tjetër, në përgjegjësinë para Zotit, në Ditën e Gjykimit dhe në shpërblimin me të mira ose me ndëshkimin për veprat e këqija të bëra në këtë jetë;

Quhet "Es-sebul methani" (shtata e përsëritur), për faktin se janë shtatë ajete që përsëriten për çdo namaz.

Besimi dhe bindja e patundshme se vetëm Zotit i takon adhurimi dhe se të gjitha të mirat duhen kërkuar vetëm prej Tij;

Besimi në ligjin e Zotit, sipas së cilit të gjitha të mirat ua dhuroi atyre që ndoqën rrugën e drejtë dhe i ndëshkoi ata të cilët u larguan dhe humbën rrugën e drejtë.

Duke lexuar pjesën e parë të kësaj sureje, ajetet (1-5), besimtari dëshmon besimin e vet në njëshmërinë e Zotit, duke e përshkuar Atë me cilësitë e Tij më të bukura, njëh sundimin e Tij absolut mbi këtë botë e botën tjetër dhe e njëson Atë si të Vetmin që meriton adhurim dhe lutje për ndihmë. Në pjesën e dytë të kësaj sureje, ajetet (6-7), myslimani i lutet Allahut, Zotit të vet, që ta udhëzojë atë në rrugën e drejtë e ta largojë atë nga çdo gjë që shkakton zemërimin e Allahut dhe nga çdo humbje.

Emërtimet e sures Fatiha

Në emërtimin e kësaj sureje gërshetohen emra të ndryshëm, me atribute e cilësi të larta që dëshmojnë për rëndësinë e kësaj sureje. Kurtubiu në tefsirin e tij thotë se surja Fatiha është emërtuar me dymbëdhjetë emra,⁷ ndërsa më të njohurit janë tre:

El-Fatiha (hapja). Është quajtur kështu ngase me të fillon apo hapet libri i Allahut xh.sh. Taberiu ka thënë se quhet El-Fatiha, ngase me leximin e saj fillon leximi i Kuranit dhe këndohet në namaze.

Umul-Kitab (Surja e parë e Librit – Nëna e Librit). Quhet kështu për faktin se në vetvete përmbledh qëllimet kryesore të Kuranit, siç janë madhërimi dhe falënderimi i Allahut, vërtetimi i njëshmërisë së Allahut, adhurimi i Allahut, kërkesa për udhëzim në rrugën e drejtë dhe përforcimi në besim, tregime për popujt e mëhershëm, pasqyrimi i njerëzve që Zoti është i kënaqur me ta, vendi i atyre që Zoti është i hidhëruar me ta etj. Kjo është si një përmbledhëse që i përmbledh në vete të gjitha kapitlat.

Es-sebul methani (shtata e përsëritur). Kjo për faktin se janë shtatë ajete që përsëriten për çdo namaz.⁸

Dispozitat e sures Fatiha

Çdo ajet apo çdo sure e zbritur nga Allahu xh.sh. ka urtësitë, mësimet, dispozitat, të cilat nxirren nga ai ajet apo ajo sure. Edhe nga surja Fatiha, dijetarët siç i kanë nxjerrë urtësitë dhe mësimet, i kanë nxjerrë edhe dispozitat me të cilat ne jemi të obliguar.

A konsiderohet besmeleja ajet i Kuranit apo jo?

Të gjithë dijetarët janë të pajtimtë se besmeleja është pjesë e ajetit të Kuranit të sures En-Neml, 30, por ata janë të ndarë në mendime se a është besmeleja ajet i Fatihas dhe i çdo sureje tjetër?!

Mendimi i parë – Është ajet i Fatihas dhe i çdo sureje tjetër dhe këtë mendim e përkrahë medhhebi shafi. Argument i tyre është hadithi i Pejgamberit a.s., të cilin e transmeton Ebu Hurejra r.a., i cili ka thënë: “Kur ta këndon Elhamdulilahi rabil alemin... (Fatiha), këndonjeni Bismillahir-rrahmani-rrahim, ngase ajo është nëna e Kuranit, nëna e librit, shtata e përsëritur dhe besmeleja është një prej ajeteve të saj.”

Mendimi i dytë – Nuk është ajet i Fatihas dhe i asnjë sureje tjetër,

përveç i sures En-Neml dhe këtë mendim e përkrahë medhhebi malikij. Këta për argument kanë hadithin e transmetuar nga Enesi r.a., i cili ka thënë: “Jam falur pas Pejgamberit a.s., Ebu Bekrit, Omerit, Othmanit dhe të gjithë kanë filluar me Elhamdulillah...” Në transmetimin e Muslimit thuhet: “Nuk kanë thënë bismilahun as në fillim e as në fund të leximit.”

Mendimi i tretë – Është ajet i plotë i Kuranit, i cili ka zbritur për t’i ndarë suret dhe këtë mendim e përkrahë medhhebi hanefi. Këta thonë se përderisa janë të shkruara në Kuran, kjo do të thotë se janë ajete të Kuranit, mirëpo nuk është ajet i çdo sureje, ngase hadithet që argumentojnë se nuk e kanë filluar Elhamdulillahin me Bismilah, tregojnë se ajo nuk është prej Fatihës. Sahabët kanë thënë se ne nuk kemi ditur t’i ndajmë suret derisa ka zbritur besmeleja.⁹

Cila është dispozita e besmeles në namaz?

Fukahatë janë të ndarë në mendime rreth dispozitës së besmeles në namaz, varësisht prej këndvështrimit se a konsiderohet besmeleja ajet i Kuranit apo jo?

Mendimi i parë – Malikitë e ndalojnë këndimin e besmeles në

namaze farze, pavarësisht se a janë namaze me zë apo pa zë, as para Fatihës, e as para sureve të tjera, ndërsa e lejojnë këndimin e saj në namaze nafle.

Mendimi i dytë – Hanefitë vlerësojnë se leximi i besmeles duhet të bëhet në çdo rekat para Fatihës, pa zë, e në qoftë se e lexon edhe para sureve të tjera nuk ka vërejtje.

Mendimi i tretë – Shafitë mendojnë se leximi i besmeles është vaxhib në çdo rekat, nëse namazi është me zë, atëherë lexohet me zë, e në qoftë se namazi është pa zë, atëherë lexohet pa zë.

Mendimi i katërt – Hanbelitë mendojnë se leximi i besmeles duhet të bëhet heshtas, pa zë dhe nuk është sunet që të lexohet me zë.

Shkak për këtë janë mospajtimet e tyre se a konsiderohet besmeleja ajet i Fatihës, apo i fillimit të çdo sureje tjetër apo jo.

A duhet të lexohet Fatihaja në namaz?

Rreth kësaj çështje, dijetarët janë të ndarë në dy mendime:

Mendimi i parë – Xhumhuri (malikitë, shafitë, hanbelitë) janë të mendimit se leximi i Fatihës në namaz është i domosdoshëm, si kusht për pranimin e namazit, e nëse

e lë atë edhe pse këtë mund ta bëjë, atëherë namazi i tij nuk pranohet. Argument i tyre është hadithi i Pejgamberit a.s., i transmetuar nga Ubade ibën Samiti, i cili ka thënë: “Nuk ka namaz për atë që nuk e këndon Fatihan e Librit.”¹⁰

Mendimi i dytë – Hanefitë mendojnë se namazi pranohet edhe pa leximin e Fatihës, mirëpo nuk duhet që të lihet ajo, porse namazi nuk prishet me lënien e Fatihës, d.m.th. nuk është farz leximi i Fatihës në namaz. Leximi i saj është vaxhib. Sipas hanefive, është farz leximi i një ajeti të gjatë apo i tri ajeteve të shkurtra. Argument për këtë ata marrin ajetin kuranor që Allahu ka thënë: “Pra, lexoni sa t’ju vjen më lehtë nga Kurani.”¹¹ Ndërsa nga Suneti kemi hadithin të cilin e transmeton Ebu Hurejre r.a., në rastin e personit të cilit Pejgamberi a.s., ia mësoi namazin dhe në këtë hadith ceket: “Pastaj lexo sa t’ju vjen më lehtë prej Kurani.”¹²

A duhet të lexojë xhemati pas imamit?

Të gjithë dijetarët janë të pajtimit se kur xhemati e arrin imamin në ruku atij i hiqet barra e të lexuarit të Kuranit të atij rekati. Mirëpo, ata janë të ndarë në mendimet se a



Hanefitë dhe shumica e malikive janë të mendimit se imami duhet ta thotë aminin pa zë, pa marrë parasysh se a janë namazet me zë apo pa zë, ngase kjo është vetëm dua. Këta argumentojnë me veprimin praktik të Pejgamberit a.s., e të cilin e transmeton Enesi r.a., ku thotë se amini i pazëshëm nuk bie në kundërshtim me mësimet e Pejgamberit a.s., i cili në fillim e thoshte aminin me zë me qëllim të mësimin dhe të udhëzimit se si duhet vepruar në namaze.



e as në ato të pazëshme. Si argument për këtë ata marrin ajetin kuranor: “Kur lexohet Kurani, dëgjojeni atë me vëmendje dhe heshtni” si dhe hadithi i Pejgamberit a.s., që ka thënë: “Kush lidhet pas imamit, leximi i tij (imamit) është edhe leximi i tij.”¹⁵

A lejohet të këndohet Fatihaja në gjuhën jo arabe në namaz?

Dijetarët janë në konsensus se nuk lejohet këndimi i Kuranit në gjuhët e tjera në namaz, përveç në gjuhën arabe, pa marrë parasysh se a e di ta këndosh atë me rregulla në gjuhën arabe apo jo, ngase Kurani është mrekulli e Allahut me fjalët e tij origjinale, dhe nëse ndryshohet del nga sistemi dhe mrekullia që ka.¹⁶

Thënia e aminin pas Fatihasë

Shprehja e aminin ka ardhur në kuptim të foljes në mënyrën urdhërore “Pranoje o Zot lutjen tonë.” Është sunet që të thuhet amini pas përfundimit të sures Fatiha, ani pse kjo nuk është pjesë përbërëse e sures Fatiha. Kjo është vërtetuar nga Pejgamberi a.s., i cili ka thënë se: “Më ka mësuar Xhibrili a.s. të them amini me rastin e përfundimit të kësaj sureje.”

Dijetarët janë pajtuar unanimisht se secili duhet ta thotë aminin vetmas pas sures Fatiha, mirëpo janë të ndarë në mendime se a duhet të thuhet me

zë apo pa zë.

Mendimi i parë – Hanefitë dhe shumica e malikive janë të mendimit se imami duhet ta thotë aminin pa zë, pa marrë parasysh se a janë namazet me zë apo pa zë, ngase kjo është vetëm dua. Këta argumentojnë me veprimin praktik të Pejgamberit a.s., e të cilin e transmeton Enesi r.a., ku thotë se amini i pazëshëm nuk bie në kundërshtim me mësimet e Pejgamberit a.s., i cili në fillim e thoshte aminin me zë me qëllim të mësimin dhe të udhëzimit se si duhet vepruar në namaze.

Mendimi i dytë – Shafitë dhe hanbelitë mendojnë se thënia e aminin duhet të bëhet me zë kur namazet janë me zë dhe duhet të bëhet heshtas kur namazet janë pa zë. Si argument për këtë ata marrin hadithin e transmetuar nga Vail bin Haxheri r.a., i cili ka thënë: “E kam dëgjuar Pejgamberin a.s., i cili pasi e ka lexuar “gajril magdubi alejhim ve le dalin”, thoshte: “Amin”, duke zgjatur zërin.”¹⁷

1. El-Enfalë, 24. 2. Zuhejli, Vehbetu, Tefsiru-l Munir, Damask, 2003, fq. 57. 3. Zuhejli, Vehbetu, Tefsiru-l Munir, Damask, 2003, fq. 57. 4. El-Hixhr, 87. 5. Behrami, Emin, Përkthimi dhe komentimi i El- Istiadhesë, El -Besmelesë dhe i suretu -l- Fatihasë, Prishtinë, 1998, fq. 212-215. 6. Tefsiru-l-Kurtubij-jî el-xhamiu li ahkamil-Kuran, Ebu Abdullah Muhamed bin Ahmed el-ensarij el-Kurtubij, Vëllimi I, Kajro, fq. 92. 7. Tefsiru-l-Kurtubij el-xhamiu li ahkamil-Kuran, Ebu Abdullah Muhamed bin Ahmed el-ensarij el-Kurtubij, Vëllimi I, Kajro, fq. 88. 8. Muhamed Ali Sabuni, Tefsirul Ajetu el-ahkam, Vëllimi I, Damask, 1993, fq. 13-14. 9. Muhamed Ali Sajis, Tefsiru ajeti-l-ahkam, Vëllimi I, Damask, 1999, fq. 18-21. 10. El-Buhari, nr: 756, 1/151; Muslimi, nr: 394, 1/295. 11. Muzemil, 20. 12. El-Buhari, nr: 793, 1/158; Muslimi, nr: 397, 1/398. 13. El-Buhari, nr: 756, 1/151; Muslimi, nr: 394, 1/295. 14. Araf, 204. 15. Muhamed Ali Sabuni, Tefsirul Ajetu el-ahkam, op. cit., fq. 47-59. 16. Zuhejli, Vehbetu, Tefsirul Munir, Damask, 2003, fq. 70. 17. Behrami, Emin, Përkthimi dhe komentimi i El- Istiadhesë, El -Besmelesë dhe i suretu -l- Fatihasë, Prishtinë, 1998, fq. 210-211.

duhet të lexohet Fatihaja pas imamit apo jo?

Mendimi i parë – Shafitë dhe hanbelitë janë të mendimit se leximi i Fatihas nga xhemati pas imamit është i detyrueshëm – vaxhib, pavarësisht se a është namazi me zë apo pa zë. Këtë e argumentojnë me hadithin e cekur më lartë se: “Nuk ka namaz për atë që nuk e këndon Fatihan e Librit.”¹³

Mendimi i dytë – Malikitë janë të mendimit se Fatihaja lexohet pas imamit nëse namazi është pa zë, e nëse namazi është me zë, atëherë ajo nuk lexohet. Argument për këtë përmendin hadithin e lartcekur, kur namazi është pa zë, ndërsa kur namazi është me zë, atëherë ata argumentojnë me ajetin kuranor: “Kur lexohet Kurani, dëgjojeni atë me vëmendje dhe heshtni.”¹⁴

Mendimi i tretë – Hanefitë janë të mendimit se xhemati nuk duhet të lexojë asgjë, as në namazet e zëshme

Argjent Xheladini

Martesa në të drejtën e Sheriatit (2)

Me anë të martesës bashkëshortët ndihmohen në formimin e familjes, në edukimin e fëmijëve dhe në punët e përditshme gjatë jetës, ku secili plotëson punën e tij.

Qëllimet martesore

Martesa është një lidhje e ndershme dhe e begatshme, të cilën Zoti i Lartësuar e bëri për të mirën dhe dobinë e njeriut. Me lidhjen e martesës sendërtohen edhe lidhjet e forta ndër njerëzore. Me anë të saj formohet familja, arrihen lidhje të ngushta ndërmjet familjeve, shtresave, racave dhe popujve.

Me të, njerëzit do t'i arrijnë qëllimet e tyre të mira dhe do t'i plotësojnë dëshirat që kanë. E drejta e Sheriatit e ka nxitur dhe e ka pëlqyer martesën për shkak të efekteve të saj të dobishme për individin, shoqërinë dhe njerëzimin në përgjithësi. Disa nga qëllimet kryesore të martesës janë:

a) Ruajtja e gjinisë njerëzore - Është çështje themelore dhe e pa diskutueshme se martesa nënkupton shtimin e gjinisë njerëzore dhe paraqet faktorin kryesor për vazhdimësinë dhe qenësinë e saj derisa të jetë kjo botë. Edhe në Kuranin e Madhëruar tregohet për rëndësinë shoqërore të saj ku thuhet: "Zoti krijoi për ju bashkëshorte nga vetë lloji juaj, e prej bashkëshorteve tuaja fëmijë e nipa."¹ Edhe profeti Muhamed (paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të!), për rëndësinë e shtimit thotë: "Martohuni që të shtoheni. Unë do të mburrem me ju para popujve tjerë."²

Martesa është rruga më e mirë për të lindur fëmijë dhe për t'u shumëzuar me pasardhës, në mënyrë që jeta të vazhdojë. Kështu ruhen lidhjet gjenetike, të cilave e drejta e Sheriatit u ka kushtuar një rendësi të veçantë.³ Ruajtja e gjinisë njerëzore, e civilizimit dhe e vazhdimësisë

së saj në funksion të njeriut si mëkëmbës i Zotit varet nga funksionimi i mekanizmit për lindje dhe shtim. Vazhdimësia e racës në procesin e vet kërkon strukturë, që vepron në mënyrë të organizuar.⁴

b) Formimi dhe ruajtja e familjes - Me anë të martesës bashkëshortët ndihmohen në formimin e familjes, në edukimin e fëmijëve dhe në punët e përditshme gjatë jetës, ku secili plotëson punën e tij.⁵ Po të mos ishte martesa, shoqëria do të mbushej me fëmijë të pa ligjshëm dhe jashtë kujdesit familjar. Pra, gruaja merret me punët e saj dhe me gjithë atë që i përshtatet asaj si femër. Me fjalë të tjera, ajo kryen detyrat e saj ndaj burrit, kujdeset për familjen, për ruajtjen dhe edukimin e fëmijëve. Edhe burri bën punët e veta dhe gjithë atë që i takon natyrës së tij. Të gjitha këto arrihen në sajë të gjuhës së përbashkët për ndihmë të ndërsjellë bashkëshortore për formimin e familjes me edukatë dhe themele të shëndosha.⁶

c) Qetësimi shpirtëror - Marrëdhënit në familje, ndërmjet të gjithë anëtarëve të saj, janë faktori më i rëndësishëm, veçanërisht ndërmjet burrit dhe gruas, por jo si marrëdhënie të nxitura nga interesi. Ato duhet të jenë marrëdhënie shpirtërore, ndarje e përbashkët e së mirës dhe së keqes, marrëdhënie që kultivon dashuri, mirësjellje, mëshirë dhe ndihmë në momentet vendimtare.⁷ Prehja shpirtërore, dashuria dhe mëshira që ndien njeriu ndaj palës tjetër e që nuk mund t'i gjejë jashtë jetës bashkëshortore dhe nga të cilat kurrësi nuk mund të heqë dorë, konsiderohen nevoja të domosdoshme biopsikike dhe shpirtë-

Prehja shpirtërore, dashuria dhe mëshira që ndien njeriu ndaj palës tjetër e që nuk mund t'i gjejë jashtë jetës bashkëshortore dhe nga të cilat kurrësi nuk mund të heqë dorë, konsiderohen nevoja të domosdoshme biopsikike dhe shpirtërore.

rore. Kjo mëshirë dhe kjo dashuri specifike mund të arrihet vetëm në jetën bashkëshortore legjitime.⁸

d) Mbrojtja nga e ndaluara (harami) - Nuk ka dyshim se ndër qëllimet kryesore të martesës është edhe mbrojtja nga lidhjet jashtëmartesore dhe largimi nga amoralitetet e tjera. Martesa është rruga për t'u mbrojtur dhe për të shpëtuar nga dëshirat epshore. Me anë të martesës, njeriu plotëson me rrugë hallall (të lejuara) dëshirën epshore që përmbahet në krijimin e tij.⁹ Kënaqja e epsheve është një faktor që mbron nga amoraliteti, mirëpo kjo nuk realizohet ndryshe përveç se me vendosmëri dhe qëllim të pastër. Prandaj ai detyrohet të martohet që ta realizoj epshin e vet me atë që Zoti i Lartësuar e lejoi.

e) Nxitja e dashurisë prindërore - Me anë të martesës lind dashuria e madhe e prindërve ndaj fëmijëve të tyre. Kjo shihet qartë në ndikimin e madh që ka dashuria e prindërve te fëmijët dhe në sukseset gjatë përkujdesjes, edukimit, ruajtjes së interesave të tyre për një jetë të mirë dhe ardhmëri të gëzueshme.¹⁰

Kushtet për lidhjen e martesës

Prej mirësisë të së drejtës së Sheriatit dhe saktësisë së tij në vënien e dispozitave është që për çdo akt, çfarëdo qoftë ai, ka vendosur rregulla me të cilat rregullohen ato dhe përcaktohet vlefshmëria e tyre për t'u zbatuar dhe për të funksionuar. Çdo pune juridike që kryhet duhet t'i paraprijnë disa kushte elementare të caktuara të cilat duhet plotësuar për të qenë valide kontrata. Pasi që edhe martesë është një kontratë e përpiluar me pëlqimin e të dy palëve (burrit dhe gruas) ajo në vete duhet të përmbajë elementet e caktuara të cilat i japin fuqi ligjore. Që të jetë martesë e vlefshme sipas të drejtës së Sheriatit personat që dëshirojnë të lidhin martesë, duhet t'i plotësojnë disa kushte para se të bëhet lidhja e martesës e ato janë:

Propozimi për lidhjen e martesës dhe pranimi i propozimit - Propozimi mund të bëhet nga cilado palë qoftë, ndërsa pranimin e propozimit e bënë pala të cilës i është bërë propozimi. Kur kontrahetohet një martesë, asaj duhet t'i paraprijë një propozim i drejtpërdrejtë, i qartë, i ndjekur nga një pranim përgjegjës nga ana tjetër. Që të dyja elementet, edhe propozimi edhe pranimi, duhet të jenë të qarta dhe të shprehura gojarisht, në qoftë se palët kontraktuese janë vetë të pranishme. Përndryshe, zëvendësimi i të shprehurit gojarisht mund të bëhet me shkrim.¹¹

E drejta e Sheriatit i ka vënë këto dy fjalë, propozimin e pranimin, si argument për pajtim, për arsye se pajtimi është çështje shpirtërore, të cilën nuk mund ta kuptojmë përfundimisht me anë të shprehjes së këtyre fjalëve, propozimit dhe pranimi.¹²

Shprehjet më të mira për kontratën e martesës, për të cilat juristët e të drejtës

së Sheriatit janë të një mendimi janë: “e lidhi kurorën me ty” ndërsa nga ana e vajzës “martohem me ty” ose shprehja e kujdestarit të saj “vajzën që e kam në kujdestari e martoj për ty”. Në këto mënyra pala e parë bënë propozimin e martesës, e nëse në atë rast, pala tjetër thotë: “pranova”, martesë konsiderohet e lidhur, por duhet të plotësohen edhe kushtet të tjera.¹³

Kujdestari (veliu) i vajzës - Për vlefshmërinë e martesës, sipas numrit më të madh të juristëve islam, kusht është pajtimi i kujdestarit (veliu) të vajzës. Shumica e juristëve konsiderojnë se gruaja nuk mund ta martojë vetveten, bazuar në fjalën e të Dërguarit të Zotit (paqja dhe bekimi i Zotit qofshin mbi të!): “Nuk ka martesë, veçse me kujdestar.”¹⁴ Nëse gruaja e marton vetveten e saj, atëherë martesë e saj është e pa vlefshme, pa marrë në konsideratë faktin nëse ky akt u ndërmor në mënyrë direkte nga ajo, apo ia ngarkoi këtë dikujt tjetër. Përjashtim bëjnë juristët e shkollës juridike hanefij,¹⁵ të cilët e lejojnë që gruaja ta martoj veten. Gjithashtu, ajo ka të drejtë ta autorizoj këtë të dojë, një person, që do ta martojë atë. Mendimin e vet ata e argumentojnë me fjalët e Zotit të Lartësuar: “...mos i pengoni që të martohen sërish për burrat e tyre, nëse pajtohen të jetojnë mirë...”¹⁶

Gjithashtu, për argument i kanë marrë edhe fjalët vijuese të Profetit të Zotit: “Gruaja ka të drejtë më të madhe (në aspektin e martesës) se kujdestari i saj.”¹⁷

Kujdestar për femrën konsiderohet ai mashkull i cili e ka arritur moshën e pjekurisë, i shëndosh mendërisht dhe që ka me të lidhje gjaku, por nga ana e babait dhe jo nga farefisi i nënës. Prej

atyre që i plotësojnë këto kushte janë: babai, gjyshi nga ana e babait, djali (për vejushën), djali i djalit, vëllai (prej babës dhe nënës), vëllai nga ana e babait, xhaxhai (nuk bën pjesë xhaxhai i cili është vëlla me babanë vetëm nga ana e nënës së tyre), djemtë e xhaxhait dhe djemtë e djemve të tyre.¹⁸

Nuk marrin pjesë në kujdestarinë e femrës vëllezërit vetëm nga nëna dhe as djemtë e tyre. Po ashtu nuk merr pjesë në kujdestari edhe gjyshi i saj nga ana e nënës dhe dajallarët.¹⁹ Nëse femra nuk ka përgjegjës, apo mungon për një kohë të gjatë, apo nuk pranon që ta martojë me një njeri të denjë, e marton prijësi siç ka ardhur në fjalën e Profetit: “Prijësi është përgjegjës për atë që nuk ka përgjegjës.”²⁰

Kjo që ta kemi të njohur se çfarë përgjegjësie ka veliu ndaj atij që Zoti i Lartësuar e ka bërë përgjegjës, ngase kjo punë me të vërtetë është porosi nga Zoti i Lartësuar, e ka obligim të kujdeset për të dhe këtë porosi duhet ta vendosë në vendin e vet. Atij nuk i lejohet të manipulojë më të për qëllime personale ose ta martojë më dikë që nuk përshtatet, për shkak se ai lakmon në diç që i ofrohet për të, sepse kjo konsiderohet tradhti.²¹

Zoti i Madhëruar thotë: “O ju që besuat, mos e tradhtoni Zotin dhe të dërguarin, e kështu të tradhtoni amanetet tuaja ndërsa e dini sa e keqe është kjo.”²²

Dëshmia në martesë - Këtë kusht do ta sqarojmë duke u përqendruar në çështjet e mëposhtme:

a) Statusi i dëshmisë në jurisprudencën islame - Sipas mendimit të shumicës së juristëve islam,



martesa nuk mund të lidhet pa prezencën e dy dëshmitarëve nga shkaku se nëpërmjet tyre mbrohen të drejtat dhe konfirmohet marrëveshja. Martesa nuk konsiderohet e vlefshme derisa dëshmitarët të jenë të pranishëm gjatë lidhjes së martesës.²³ Profeti (paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi të!) ka thënë: “Nuk ka martesë pa praninë e kujdestarit dhe dy dëshmitarëve të drejtë.”²⁴

b) Kushtet e dëshmitarëve - Përveçse martesa nuk mund të jetë e vlefshme pa prezencën e dy dëshmitarëve, është kusht që dëshmitarët të plotësojnë kushte për dëshmi. Nuk mund të jetë çdokush dëshmitar, nëse nuk i plotëson këto kushte:

- Dëshmitari duhet të jetë i mençur, ngase dëshmia e të çmendurit nuk vlen për martesë.

- Dëshmitari duhet të jetë moshërritur, në pubertet, sepse dëshmia e të miturit nuk pranohet, madje edhe nëse është në gjendje t'i dallojë gjërat.

- Për dëshmi duhet të jenë dy meshkuj, apo në mungesë të tyre, një mashkull dhe dy femra.

- Është kusht që dëshmitarët të jenë të lirë, sepse dëshmia e robit në kontratën e martesës nuk është e vlefshme.

- Dëshmitarët duhet t'i dëgjojnë fjalët e të dy palëve dhe t'i kuptojnë qëllimet e fjalëve dhe gjuhën e tyre. Në këtë aspekt, dëshmia e të përgjyurrit, shurdhit, memecit dhe të dehurit është e papranueshme.²⁵

c) Kushhtëzimi i drejtësisë për dëshmitarët – Për sa i përket kushtëzimit të drejtësisë për dëshmitarët, hanefitë mendojnë se ky nuk është kusht dhe martesa është e vlefshme edhe me dëshminë e mëkatarëve. Kushdo që pranohet të jetë kujdestar i gruas gjatë aktit të martesës është i vlefshëm të jetë edhe dëshmitar, sepse qëllimi i dëshmisë në martesë është shpallja e saj.²⁶ Ndërsa juristët e shkollës juridike shafij²⁷ thonë: Duhet që dëshmitarët të jenë të drejtë duke u bazuar në thënien e sipërpërmendur, në të cilin Profeti (paqja dhe mëshira e Zotit

qofshin mbi të!) ka thënë: “Nuk ka martesë pa praninë e kujdestarit dhe dy dëshmitarëve të drejtë.”

Sipas tyre, në qoftë se martesa kryhet me dëshminë e dy të panjohurve (që nuk dihet nëse janë të drejtë apo jo), atëherë kjo dëshmi lejohet.²⁸

d) Dëshmia e grave - Dijetarët e shkollës juridike shafij dhe hanbeli²⁹ kushtëzojnë që dëshmitarët të jenë burra. Sipas tyre, akti i martesës me dëshminë e një burri dhe dy grave nuk është i vlefshëm. Ata argumentojnë se martesa nuk është kontratë materiale, nuk ka një qëllim të tillë dhe në të marrin pjesë zakonisht vetëm burrat. Për këtë arsye kjo nuk mund të kryhet me dëshminë e grave.³⁰

Ndërsa juristët e shkollës juridike hanefij kanë mendim tjetër lidhur me këtë çështje dhe deklarojnë: martesa mund të lidhet me prezencën e dy dëshmitarëve (meshkuj) ose me prezencën e një mashkulli dhe dy femrave.³¹

Barabarësia e dëshmisë së dy grave me dëshminë e një burri nuk do të thotë se burri është më i besueshëm se sa femra, por e drejta e Sheriatit e dallon natyrën e të dy palëve. Sipas parimeve sheriatike nuk preferohet që femra të marrë pjesë në tubimet e meshkujve. Mu për këtë bëhet dallimi në dëshmi ndërmjet gjinisë femërore dhe mashkullore. Mashkulli ka më shumë mundësi se sa femra për ta lajmëruar masën për lidhjen e kësaj kontrate, sepse atij i jepet rasti të kontaktoj më shumë me njerëz nëpër tubime të ndryshme.³² Gjykohet kështu ngase dëshmia e kontratës së martesës është thjesht lajmërim e asgjë më tepër.

Zoti i Lartësuar thotë: “Kërkoni të dëshmojnë dy dëshmitarë burra nga mesi i juaj, e në qoftë se nuk janë dy burra, atëherë një burrë e dy gra nga dëshmitarët që i pëlqeni.”³³

1. En-Nahl, ajeti 72. 2. Hadithin e transmeton Ebu Daudi, hadithi nr.2050. 3. Sejid Sabik, vep. e cit., fq. 89. 4. Ahmed Hurshid, Familja dhe Islami, Tiranë, 2000, fq. 17. 5. Abdullah N. Ulvan, Rregullat e fejesës e të martesës dhe detyrimet e bashkëshortësisë, Tetovë, 1993, fq. 9. 6. Ibid. 7. Ahmed Hurshid, vep. e cit., fq. 24. 8. Grup

autorësh, vep. e cit., fq. 53. 9. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, E Drejta Islame (FIKH) III, Stamboll, 2013, fq. 10. 10. Abdullah Nasih Ulvan, vep. e cit., fq. 11. 11. Hamude Abdulati, vep. e cit., fq. 60. 12. Abdullah Nasih Ulvan, vep. e cit., fq. 43. 13. Muhamed Ahmed Kenan, Elementet Themelore te Jetës Bashkëshortore, Goštivar, 2005, fq. 45. 14. Hadithin e transmeton Ebu Davudi kapitulli i martesës, tema: Kujdestari, hadithi me nr. 2085. 15. Hanefitë janë pasuesit e shkollës juridike hanefite (njërës nga katër shkollave juridike të së drejtës islame) të themeluar nga En-Numan bin Thabit, teolog dhe jurist fetar, i njohur me emrin Ebu Hanife, i lindur rreth vitit 699 në Kufë-Irak. Pas vdekjes së mësuesit të tij të quajtur Hamadit, Ebu Hanife bëhet autoriteti më i madh mbi çështjet e të drejtës islame dhe përfaqësuesi më i njohur i shkollës së Kufes të mendimit juridik. Ai ka pasur shumë nxënës privat, më të njohurit kanë qenë Ebu Jusufi, Muhamedi dhe Zuberi. Ka dhënë mendime juridike me cilësi të këshilltarit juridik privat (myfiut), por nuk ka kryer funksionin e kadiut. Ka vdekur në Bagdad në vitin 767. (Shih: Mr. Fikret Karçi, “Historia e së drejtës së sheriatit”, fq.61). Vlen të theksohet se myslimanët e Kosovës janë pasues të mendimit dhe shkollës hanefite në çështjet juridike praktike që nga depërtimi i fesë islame në këto troje. 16. El-Bekare, ajeti 232. 17. Hadithin e transmetojnë Ebu Daudi, Muslimi dhe Nesahiu. 18. <http://www.studentet.info/modules/ipboard/index.php?showtopic=39832>. 19. Ibid. 20. Hadithin e transmetojnë Ahmed, Ebu Daudi. 21. Muhamed ibn Salih el-Uthejmin, vep. e cit., fq. 4. 22. El-Enfalë, ajeti 27. 23. Sejid Sabik, vep. e cit., fq. 128. 24. Hadithin e transmeton Darakutni (Hadith Sahih. Sahih el-Xhami 7557). 25. Grup autorësh, vep. e cit., fq. 68. 26. Sejid Sabik, vep. e cit., fq. 130. 27. Shafitë janë pasuesit e shkollës juridike shafite (njërës nga katër shkollave juridike të së drejtës islame) të themeluar nga Muhamed bin Idris bin Abbas esh-Shafiu i cili lindi në vitin 767 në Gaza. Mësimet i mori nga shumë dijetarë, njëri prej tyre edhe Imam Maliku. Pas akuzave ndaj tij dërgohet në Bagdad ku shoqërohet me nxënësin e Imam Ebu Hanifes, Muhamed esh-Shejbani. Shoqërimi i tij me këtë jurist ndikoi në zhvillimin e mëvonshëm juridik të Shafiu. Mendimi juridik irakian ka zhvilluar te Shafiu qëndrim kritik ndaj tradicionalizmit të Imam Malikut. Vdiq në Egjipt në vitin 819 në moshën 58 vjeçare. (Shih: Mr. Fikret Karçi, “Historia e së drejtës së sheriatit”, fq.71). 28. Sejid Sabik, vep. e cit., fq. 130. 29. Hanbelitë janë pasuesit e shkollës juridike hanbelite (njërës nga katër shkollave juridike të së drejtës Islame) të themeluar nga Ahmed bin Hanbeli i lindur në Bagdad në vitin 780. Është shkolluar në Bagdad, qendër e atëhershme e shkencave dhe kulturës. Ka dëgjuar ligjëratat nga nxënësi i Imam Ebu Hanifes, Ebu Jusufi dhe dijetarë të tjerë. Vdiq në Bagdad në vitin 855. (Shih: Mr. Fikret Karçi, “Historia e së drejtës së sheriatit”, fq.75). 30. Sejid Sabik, vep. e cit., fq.131. 31. Abdulhamid Mahmud Tuhmaz, vep. e cit., fq.80. 32. Grup autorësh, vep. e cit., fq. 69. 33. Kuran, El-Bekare, ajeti 282.

Dr. Jusuf el-Kardavi

Gjendja dhe sfidat e të rinjve tanë

Perioda e rinisë është perioda më e rëndësishme, por njëkohësisht edhe më e rrezikshmja. Madje, ajo është etapë e gjallërisë dhe prodhimit, periodë e vrullit, vendosmërisë dhe aktivitetit. Ajo është perioda e fuqisë, e cila buron në mes dy dobësive: dobësisë së fëmijërisë dhe dobësisë së pleqërisë.

Nga kjo mund të vërehet rëndësia e kësaj etape dhe orientimit të drejtë të popullit në të, prandaj kujdesi për të është detyrë e jona, në mënyrë që ajo të mos shkatërrohet dhe të degenerohet. Vërtet, rinia është pasuria më e çmueshme. Njeriu është pasuria më e madhe, ndërsa rinia është segmenti më i rëndësishëm i kësaj pasurie njerëzore. Prandaj, nëse dëshiron ta njohësh ardhmërinë e një populli, atëherë shiko gjendjen e rinisë së tij. Çfarë bën rinia e tij? Cilat janë qëllimet jetësore të tyre? Si sillen, për çka mendojnë, për çka ëndërrojnë, çka ndodhë në ndejat dhe tubimet e tyre?

Roli i rinisë

A ka gjë më esenciale për muslimanin se të interesohet për rolin e rinisë sonë dhe njohjen e rëndësisë së kësaj etape, për të cilën Allahu do t'i pyesë njerëzit, posaçërisht në Ditën e Gjykimit. Pejgamberi a.s. ka thënë: “Në Ditën e Gjykimit, rob nuk do ta hedh asnjë hap, gjersa të mos pyetet për katër gjëra: Jetën ku e ka harxhuar, rininë si e ka jetuar, pasurinë prej nga e ka fituar dhe në se e ka shpenzuar, si dhe për diturinë se çfarë ka bërë me të.” (Bejhekiu dhe të tjerët nga Muadh ibën Xhebeli r.a). Atëherë çdo njeri le të përgatisë përgjigje për këto pyetje.

Ka të rinj që rininë e kanë kaluar në bindje ndaj Allahut xh.sh., sepse Allahu ua ka mundësuar të jetojnë në një ambient të mirë, dhe nuk e kanë njohur rrugën e devijimit, as nuk kanë kryer mëkate të mëdha, e as nuk i kanë anashkaluar farzet. Në këtë mënyrë janë rritur në bindje ndaj Allahut xh.sh. dhe janë bërë një nga shtatë personat të cilët Allahu xh.sh. do t'i vendosë nën hijen (mbrojtjen) e Tij, kur nuk do të ketë hije tjetër pos hijes së Tij.

Por kjo nuk do të thotë se atij që në kohën e rinisë së vet është zhytur në mëkate, ka rënë në zgrip dhe kështu ka devijuar, dhe se dyert i janë mbyllur, ngase dyert e pendimit



gjithnjë janë të hapura, ndërsa nga njerëzit më të dashur të Allahut xh.sh., është i riu që pendohet.

Perioda e rinisë është një aspekt i rëndësishëm për të cilin duhet të interesohemi të gjithë, kjo është përgjegjësia jonë kolektive. Ajo është përgjegjësi e vet të riut nëse është në moshën e pjekurisë, i mençur, sepse Allahu xh.sh. ka thënë: *“Secili njeri është peng i veprës së vet.”* (El-Muddeththir, 38).

Përgjegjësia familjare ndaj të rinjve

Përgjegjësia familjare, do të thotë përgjegjësi e babait dhe nënës. Përgjegjësia e tyre shtrihet deri në moshën e pjekurisë së fëmijëve të tyre dhe pas pjekurisë së tyre. Është e domosdoshme të mbikëqyrën dhe të orientojnë fëmijët. Të mos ia lëmë që preokupim kryesor i babait të jetë sigurimi i jetesës për fëmijët e vet, ashtu siç nuk duhet të jetë preokupim sigurimi i veshmbathjes së bukur, automobilin të shtrenjtë ose mbushjen e kuletës së tyre me para sa të duan. Nuk duhet të preokupohemi për përmbushjen e të gjitha këtyre të mirave, ngase disa prej prindërve (baballarëve) nuk dinë dhe as që brengosen për asgjë për bijtë dhe bijat e tyre. Disa nuk i pyesin bijtë e tyre ku shkojnë, ku i shpenzojnë paratë, ku rrinë, cilët janë shokët e tij, falen apo jo, i kanë kryer obligimet shkollorë apo jo, këtë apo atë,....?

Detyrë e prindit është të kujdeset për fëmijët e vet dhe t'i kontrollojë ata, sepse është kujdestar i tyre. Nuk mjafton vetëm t'u sigurosh ushqim, e që pastaj të mos interesohesh për asgjë për kryerjen e obligimeve të Islamit. Mos të ju kënaqin diplomat e bijve tuaj me sukseset dhe punët e larta shtetërore, e që gjatë kësaj shkon rrugës së Xhehenemit, e sa vend i tmerrshëm që është ai. A dëshiron që fëmija yt të digjet në zjarr? Jo, atëherë ruaje prej tij: *“Ruajeni veten dhe familjen tuaj nga zjarri.”* (Et-Tahrim, 6).

Detyrë e prindit është të kujdeset për fëmijët e vet dhe t'i kontrollojë ata, sepse është kujdestar i tyre.

Sigurimi i jetesës nuk duhet të jetë synim i vetëm, sepse kjo mund të jetë rrezik. Dhënia e parave fëmijëve bëhet rreziku dhe dëmi më i madh për ta, pasi që ata mund t'i keqpërdorin paratë.

Sfidat e të rinjve

Është me rëndësi që zbrazëti e kohës së rinisë dhe shpirtit të tyre të mbushet dhe të stoliset me vepra të mira dhe aktivitete të ndryshme, si: aktivitete sportive, kulturore, relaksuese, fetare, të cilat do t'i lidhnin për ideale të mëdha, për shkak të cilave dhe për të cilat do të jetojnë. Pjesën më të madhe të rinisë e hasim në kotësi. Rinisë i mungon familja me të cilën do ta përmbshte këtë boshllëk. Rinia jonë ndjen

boshllëk në punë dhe në ditët e pushimit.

Çështje kryesore e shumë asocioneve, organizatave joqeveritare dhe institucioneve është rinia dhe problemet e saj me alkoolin, narkotikët dhe veset e tjera, pa i llogaritur ata që e konsumojnë duhanin dhe belatë e tjera. Në pyetje janë statistikatat dhe numrat e mëdhenj të rinisë, e në veçanti në fokus është rinia e këtij vendi.

Te ne, ka parregullsi dhe delikuencë, e kush është përgjegjës për dështimin e kësaj rinie, brenga e vetme e së cilës është dëgjimi i këngëve dhe imitimi i aktorëve dhe muzikantëve të huaj?!

Duke u zbuluar me lloj-lloj unaza e zinxhirë ari, ata nuk bëjnë dallim mes hallallit dhe haramit, as nuk i dinë detyrat e tyre, duke i shkaktuar dëm vetvetes, familjes dhe popullit të vet.

Çfarë dobie ka nga një rini e tillë? A mund të ketë dobi prej tij ashtu siç ka qenë i dobishëm Usama ibën Zejdi r.a., i cili në moshën 18 vjeçare i ka prirë ushtrisë myslimane, në të cilën gjendeshin disa shokë të Pejgamberit a.s. që ishin të moshuar? Rinia jonë a mund ta bëjë atë që e ka bërë Muhamed el-Fatih, i cili e çliroi Kostandinopojën (Stambollin e sotëm) dhe e rrëzoi shtetin



romak-bizantin në vitin 1453, dhe që ishte vetëm në moshën 23 vjeçare. Ata ishin të rinj që në vete mbartnin ambiciet e të moshuarve. Prioritet e rinisë së dikurshme ishin që të zgjoheshin dhe të jetonin, të ndërtonin dhe të flijoheshin për hir të Islamit, gjersa rinia jonë është në humbje!

Përgjegjësia shoqërore ndaj të rinjve

Kush është përgjegjës për këtë humbje? Sa janë përgjegjës baballarët dhe nënat e tyre? Sa janë ata të interesuar për bijtë dhe bijat e veta?

Sa është përgjegjëse shoqëria, mediumet, kultura, radio-televizionet, teatrot, kinematë, etj.?

A janë përgjegjës klubet rinore që merren me aktivitetet sportive, futboll dhe animin për këtë apo atë reprezentacion? A janë përgjegjës dijetarët dhe ligjëruesit të cilët nuk qajnë kokën për këtë segment, as për udhëheqjen e drejtë?

Duhet ditur fakti se të gjithë bashkërisht jemi përgjegjës, duke filluar prej prindërve e deri te funksionet më të larta, siç ka thënë Pejgamberi a.s.: “Të gjithë ju jeni rojtarë dhe të gjithë ju jeni përgjegjës për kopenë tuaj.” (Buhariu, Muslimi, Ahmedi, Ebu Davudi, dhe Tirmidhiu nga Abdullah ibën Omeri r.a.). Të gjithë duhet të mendojmë.

Rinia e humb orientimin e drejtë dhe ku mund ta gjejnë atë kur para vetes ndodhen mjetet mediale dhe televizionet me programet më të deformuara me amoralitet të cilat i prezantojnë.

Të rinjve u nevojitet autoriteti dhe modeli, ndërsa a mund të gjejë një model të duhur në shtëpi? A mund të gjejë në shkollë apo shoqëri?

Fatkeqësisht, modele të tilla të duhura sot ka gjithnjë e më pak. Sot është vështirë të gjendet një baba i cili mund të jetë shembull për fëmijët e tij, as pedagog tek i cili nxënësit do të

shohin autoritetin dhe edukatorin e duhur. Është vështirë të gjendet ky lloj, pos atyre të cilët i ka mëshiruar Allahu xh.sh., ndërsa ata, siç duket, janë të rrallë.

Neve na nevojitet ndihma e rrethit që kësaj rinie t'i ndihmojmë në edukimin e drejtë. Duhet të përpiqemi për krijimin e një ambienti të tillë, të cilin në çdo vend do ta shfrytëzonte rinia për të jetuar me jetë islame.

Fatkeqësisht ne marrim nga Perëndimi, me dëshirë që të jetojmë një jetë perëndimore, por a duhet njëmend Perëndimi të jetë shembull për jetën tonë? Religjioni i tyre a është si feja jonë? Vlerat e tyre a janë si ato tonat? Zakonet a i kanë si tonat?

Jo, me siguri s'janë. Dallimi është shumë i madh, për këtë arsye, nuk na lejohet vesternizimi, ngase duhet ditur kush jemi dhe në cilën tokë ndodhemi.

Duhet të kuptojmë se kujdesi për të rinjtë nuk nënkupton vetëm kujdesin për trupin e tyre, por kujdesi për trupin, mendjen, zemrën dhe ndjenjat. Kujdesi ndaj të rinjve duhet t'i përfshijë të gjitha këto aspekte.

Ekziston gabimi kryesor dhe themelor për kujdesin e të rinjve anëmbanë botës islame, pasi që përgjegjësit mendojnë se ata janë përgjegjës vetëm për sport, e një mendim i tillë është i gabuar. Sporti është një pjesë, e nuk është i tëri, ai nuk është pjesa kryesore e as më i madhi.

Nuk ka pengesë që njerëzit të luajnë futboll, por e ndaluar është që futbollit të bëhet idhull të cilin njerëzit e adhurojnë, dhe për të cilin ndahen në grupe.

Çfarë vlera kemi prej kësaj? Ne e dëshirojmë një të ri të shëndosh me trup, besim, mendje, vendosmëri dhe sjellje.

Për këtë qëllim, të gjithë mekanizmat duhet të ndihmohen se si të kujdesen dhe t'i drejtojnë në mënyrën më të mirë, derisa të bëhet shembull i gjallë, mysliman i vërtetë, i cili denjësisht do të deklarohet si anëtar i

fesë dhe popullit të vet. I riu i tillë është i dobishëm, dhe kjo është pasuria të cilën e kërkojmë. E duam një të ri i cili do t'i bindet urdhrat të Zotit, madje edhe me çmim të gjakut dhe jetës. Dëshirojmë shembullin e djaloshtit i cili i kontrollon pasionet e veta, që do të përmbahet nga harami dhe që do të largohet nga pa dëgjueshmëria, do ta ruajë veten nga kërkesat negative, t'i frikohet Allahu xh.sh., një gjë e tillë siç vërehet te Jusufi a.s.. E dëshirojmë një të ri me karakter të butë dhe të pastër që i bindet natyrës dhe respekton Librin, siç ka qenë Jahja a.s..

Vërtet, biseda për rininë dhe problemet e tyre është mjaftë e gjatë. Këto janë vetëm disa këshilla të cilat desha t'i përmend, dhe përmes tyre i kujtoj të gjithë njerëzit duke filluar nga prindërit, ua kujtoj këtë rini e cila dëshiron të realizojë qëllimet e larta të fesë që janë bërë të huaja në vendin tonë. Rinia e këtij ymeti dëshiron të ndihmojë fenë e vet.

Falënderuar qoftë Allahu, ekzistojnë të rinj të mirë. Ekzistojnë me mijëra të rinj dhe të reja të cilët Allahu xh.sh. i ka udhëzuar. Ata paraqesin rilindjen bashkëkohore islame. Kjo është rilindje e vërtetë dhe origjinale, por sa është përqindja e tyre me të tjerët? Ata janë pakicë në krahasim me shumicën tjetër dërmuese.

E kemi të ndaluar që ta injorojmë çështjen e rinisë, haram është t'i humbim ata e të mos mendojmë lidhur me çështjet e tyre.

Prandaj, vëllezër, para së gjithash rini, prindër, përfaqësues të pushtetit, përfaqësues të rinisë, myslimanë kudo që ndodheni, kini frikë nga Allahu xh.sh. kur është fjala për këtë pasuri të çmueshme e cila është me vlerë të madhe dhe që paraqet të ardhmen e një populli.

Përktheu: Dr. Faruk Ukallo, (Burimi “Predikimet e Shejh El-Kardavit”, përgatitur nga Halid Essâd, mektebetu vehbeh, Kajro, 2001, vëllimi IV).

Muhamed Mutevelij esh-Sharavi

Begatia e kënaqësisë

Shejhu i nderuar, Muhamed Mutevelij esh-Sharavi (Allahu e mëshiroftë), tregon: “Në një ditë Ramazani, isha duke u kthyer në shtëpi, një orë para akshamit. Më ndaloi një njeri i varfër, i cili prezantonte në ligjëratat e mia në xhami, më përshëndeti me aq mallëngjim, sa që bëri që sytë e mi të lotojnë, e më tha: “Të betohem që për hatër të Allahut të vish sonte tek unë në iftar.”

Shejhu thotë: “Mu lidh gjuha nga mallëngjimi i tij dhe dëshirova që t’ia plotësoja dëshirën, mu ndriçua në zemrën time ajo për të Cilin u betua për nder të Tij, por i thashë: “O vëlla, familja ime më pret dhe rrethanat e mia nuk më lejojnë një gjë të tillë, por...” E gjeta veten time duk e pasuar atë deri te shtëpia e tij, por nuk e dija as vendin e as gjendjen e tij, në këtë kohë të ngushtë para iftarit.”

Arritëm te shtëpia e tij, ai kishte një dhomë dhe kuzhinë, si dhe një vend shumë të vogël dhe të hapur përjashta, të cilin e kishte blerë nga shokët e tij, kishte një hyrje me shkallë të vjetra nga druri, që nuk mund t’i bartnin dy veta, andaj duhej të ngjiteshim me kujdes në shkallët e vjetra të drurit dhe të dobëta, si pasojë e varfërisë. Lumturia e mbushte zemrën e këtij njeriu, shprehjet e falënderimit dhe kënaqësisë buronin nga buzët e tij, duke më thënë:

“Shiko o zotëria im, kjo shtëpi është prona ime (dhe e gjithë prona i takon Allahut), dhe askujt në botë nuk i kam borxh asnjë groshë. Shiko o zotëria im, dielli lind pranë dhomës sime në mëngjes dhe perëndon në anën tjetër. Këtu lexoj Kuran në mëngjes dhe para perëndimit të diellit, ndërsa bashkëshortja ime qëndron tek ajo dritarja dhe i lutet Zotit për mua. Pasha Allahun, o zotëria im, më duket sikur banoj në Xhenet.”

Shejhu vijon e thotë: “E gjithë kjo është duke i ndodhur dëgjimit tim, ndërsa unë isha duke u ngjitur në shkallët me kujdes, duke u frikësuar që të mos bie. Për disa çaste arritëm te dhoma dhe u ula, ndërsa

Kënaqësia nuk është në pasurinë e shumë të paguajmë çmimin e saj, por kënaqësia është në lidhjen e mirë me Allahun dhe me atë që Allahu e ka caktuar për ne.



njeriu shkoi te bashkëshortja e tij dhe me zë të ulët i tha: “Përgatite iftarin sepse sonte shejhu do të jetë mysafiri ynë”, ndërsa ajo ia ktheu: “Pasha Allahun, nuk kemi asgjë tjetër pos fasules, por edhe sikur të kishim, nuk kemi kohë, sepse iftari është për gjysmë ore.”

Shejhu thotë: “E dëgjova bisedën ndërmjet tyre dhe kur u kthye i zoti i shtëpisë i thashë: “O vëllai im, unë kam një kusht për ty. Unë bëj iftar me hurmat e mia dhe me ujë, pastaj nuk ha deri gjysmë ore pas ezanit, derisa të tretën hurmat dhe uji, e fali akshamin dhe pastaj nuk ha tjetër pos fasules dhe patateve të pjekura.”

Njeriu tha: “Si urdhëroni zotëria im!” Shejhu tha: “Tani më lër mua të vetmohem me Zotin tim.” Shejhut iu plotësua ajo që e dëshironte, bëri iftar dhe shkoi.

Ai thotë: “I zgjodha patatet, sepse ato gjenden te të varfrit, duke llogaritur se ata i kanë ato. Dola dhe isha i tëri i kapluar me lumturi dhe gëzim. E desha botën nga gjuha e këtij njeriu, i cili nuk ndalej duke e falënderuar Allahun për mirësitë që ia ka dhuruar, për shtëpinë dhe për këtë jetë të bukur, me të cilën është duke u kënaqur.”

Shejhu vazhdon e thotë: “Pas disa ditësh mora një ftesë për një iftar me një grup njerëzish të dalluar, te një tregtar i pasur, ndërsa ai ishte prej atyre që Allahu e kishte begatuar me pasuri, prestigj, famë dhe familje. Vendi ku do të bënim iftar ishte një kopsht i madh, me të gjitha të mirat dhe gjërat e këndshme, në mes ishte një shtëpi që i ngjante një pallati, aty te kopshti kishte edhe disa kuaj të shtrenjtë. E bëmë ifarin te ky njeri. Pastaj gjatë daljes sonë, ky njeriu mu afrua mua dhe filloi të ankohej për ngushtësinë e jetës, problemet me tregtinë, problemet me fëmijët dhe bashkëshorten, për lakminë e të tjerëve ndaj tij, harxhimet e shumta për t’i kënaqur të gjithë njerëzit, mërzinë e tij nga kjo jetë dhe dëshirën e tij për të vdekur, që të lirohet nga këto vështirësi.”

Shejhu thotë: “Pasha Allahun, nga dera e të zotit të shtëpisë, e deri te dera e veturës sime, ky njeri ma nxiu botën para syve të mi, më mbylli gjoksin dhe frymëmarrjen time. Pastaj hipa në veturën time dhe e drejtova shikimin tim kah qielli dhe thashë: “Falënderimi i takon Allahut për begatinë e kënaqësisë”.

Kënaqësia nuk është në pasurinë e shumë të që e paguajmë çmimin e saj, por kënaqësia është në lidhjen e mirë me Allahun dhe me atë që Allahu e ka caktuar për ne.

Përktheu nga gjuha arabe: Muhamed Sadiki

Prof. dr. Edin Tule

Energjia negative në pusi

Të jesh mysliman apo myslimane nuk d.m.th., të ecësh rreth e përqark dhe të bësh vepra të mira, sa do të thotë të kesh vizion të qartë të kuptimit të rolit personal në vendin dhe kohën ku jeton.

Aspekti moral-humanitar i Islamit nuk është një segment i rastësishëm i cili fisnikëron mozaikun e personalitetit islam, i cili është jo i plotë nëse ky mozaik nuk është i komponuar në harmoni në imazh më të madh historik dhe me rol më të qartë konstruktiv.

Në atë moment që ymeti është tërësi e bamiërësve indiferent, të preokupuar me shpëtim individual, pa vetëdije proaktive, e cila i kupton gabimet historike personale dhe është i përgatitur që të ndryshohet, varësisht nga ky konceptim, atëherë myslimanët kanë përfunduar si gjah i copëtuar në barqet e ujërve kolonialist botëror.

Aktivitetet që ndodhin në këtë ambient të ri të jetesës së tyre, nëse nuk janë plotësisht të asimiluar, atëherë reduktohen në gjënim kundër trupit të ri që i ka përbirë, ani pse në llogari të tij shpesh parazitohen, ose elementet e përpunuara në organizimin e ri sillen sikur vaji dhe uji, duke u refuzuar rreth linjës së hollë të demarkacionit.

Transmeton Ebu Dherri r.a., se i Dërguari i Allahut a.s. ka thënë: “Ju do ta pushtoni Egjiptin. Ajo është tokë në të cilën shfrytëzohet kirati. Kur ta pushtoni, silluni mirë me banorët e tij, ngase ata kanë të drejtë për mbrojtje dhe lidhje familjare. Kur të shihni që në të grinden dy njerëz për vendosjen e tjegullës, dilni (ikni) nga aty.” Ebu Dherri ka thënë: “Kam parë Abdurrahman b. Shurahbil b. Hasenin dhe vëllain e tij duke u grindur për vendin e një tjegulle dhe e kam lëshuar Egjiptin.” (Muslimi)

Hadithi i cituar është përplot urtësi dhe direktiva. Ajo që bie në sy në veçanti është mënyra se si i Dërguari i Allahut i ka sensibilizuar bashkëkohësit e tij, duke

tërhequr vëmendjen në shikim të parë në fenomenet naive dhe duke i udhëzuar në aksione të dobishme.

Nuk ka reformator të vërtetë pa sensibilitet të stërholluar, i cili vëren edhe lëvizjet më të vogla në shoqëri dhe varësisht nga kjo vepron me kohë dhe në mënyrë konstruktive.

I Dërguari i Allahut a.s. e paralajmëron Ebu Dherrin r.a. që gjenerata e tij në të ardhmen e parashikueshme do ta pushtojë një shtet të ri, duke ia rikujtuar kështu disa të drejta të banorëve të atij shteti dhe e kushtëzoi në lëshimin e asaj toke me pamjen e një fenomeni interesant.

Pyetjet që duhen parashtruar në këtë vend janë:

Për çfarë është problematik fenomeni i dy njerëzve që grinden për vendin e një tjegulle?

Përse ky fenomen është i rrezikshëm në atë masë, sa që Pejgamberi a.s. e ka rekomanduar Ebu Dherrin r.a. që në mënyrë radikale të largohet nga hapësira ku jetojnë këta dy njerëz?

Hadithi udhëzon qartë për rrezikun nga njerëzit që imponojnë tema marginale. Dëmi i cili fshihet në qasjen e tillë të jetës udhëzon në mosekzistimin e qartë të vizionit konsolidues të këta njerëz dhe rreth tyre.

Gatishmëria e tyre për çikërrime rreth temave që nuk kanë kurrfarë vlere kreative, deri te kontekstet e bezdisshme dhe konfliktet e ashpra tregon një dezorientim të shpirtrave të mbyllur që përhapin energji negative në përputhje me nivelin e mjerë të vibracioneve mendore të tyre. Çdo përpjekje jashtë institucionale e ngritjes së nivelit të tyre të të menduarit dhe të interesimit është e destinuar në pa sukses, posaçërisht

nëse institucionet ekzistuese myslimane lëshojnë vizionin afatgjatë dhe strategjinë e ruajtjes së këndvështrimit të ymetit në pikën e qartë të ardhmërisë.

Është tërësisht e qartë që nëse përgjegjësit me kohë nuk plotësojnë vakumet e hapësirës mendore të një populli, do të mbizotërojnë dobësitë njerëzore dhe epshet e ulëta të tyre. Nëse dështojnë institucionet, individët nuk duhet të bien në kurthin e marrjes reaktive me temat e çikërrimtarëve, ngase kështu do të humbin shumë kohë dhe energji dhe pandieshëm do të bëhen si ata.

Temat e vdekura janë sikurse topat e vdekur në tenis që bien mu pas rrjetës, andaj këshillohet lëshimi i tyre me qëllim të kursimit të energjisë për ata topa, rrugëtimi kthyes i së cilëve ka perspektivë.

Paraqitja e njerëzve që merren me tema marginale është shenjë që tregon në ekzistimin e katastrofës më të madhe, ndaj së cilës duhet të sillemi ashtu siç sillemi ndaj idesë së ndërtimit të shtëpisë në skajet e greminës.

Katastrofa e tërë situatës rrjedh nga gërshetimi i vendosjes gabim të diagnozave, mosekzistimit të rasteve dhe humbjes së kohës kolektive dhe potencialit. Rezultat i këtij gërshetimi është pashpresa, dëshpërimi, izolimi, eskepizmi, misticizmi dhe shumë forma të tjera pa kohë.

Marrë nga libri i autorit në fjalë “Dimensionet socio-psikologjike në Kuran”

Përktheu dhe përshtati: Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi

Prof. Ass. dr. Rexhep Suma

Format e shumta të mjeteve në komunikimin e daves

Vetë mjeti në shumicën e rasteve nuk ka ndikim në realizimin e pikësnyimit, as në përmbajtjen e predikimit që paraqitet, as në mënyrën e adhurimit dhe as në thelbin e thirrjes. Ndikimi i tij është te zhvillimi, procesi që ndodh, në shtimin e qartësisë, në memorizimin e informacionit, në zgjerimin e hapësirës së thirrjes, në lehtësimin e kryerjes së tij.

Në fushën e thirrjes islame (dave) mjetet që shfrytëzohen në komunikimin e mësimave hyjnore janë të shumta, aq më shumë ku bota ka shënuar revolucion teknologjik në aspektin e komunikimin ndërnjerëzor. Mjete (el-vesile) nga ana etimologjike ka kuptimin:

1. Vegël, send, makinë, tërësi pajisjesh etj., që shërben për të bërë një punë, për të kryer një veprim a veprimtari, për të udhëtuar etj.; çdo gjë që përdoret për të bërë një punë. Mjet i thjeshtë. Mjete shkollore. Mjete mbrojtëse. Mjete tokësore (detare, ajrore). Mjetet luftarake (e motorizuara). Mjetet e punës. Mjetet e transportit (e komunikacionit). Mjetet e lundrimit (e udhëtimit). Mjetet e mësimi. Mjetet e peshimit (e matjes).

2. Mënyrë veprimi a udha që ndiqet për t'ia arritur një qëllimi; rrugë. Mjet i fuqishëm (i rëndësishëm). Mjet i sigurt. I vetmi mjet shpëtimi. Teatri është një mjet edukimi dhe çlodhjeje. Përdori gjithfarë mjeteve për t'ia dalë mbanë. E gjeti mjetin për ta zgjidhur çështjen. Me të gjitha mjetet me çdo kusht, me çdo mënyrë. S'ka mjet tjetër.

3. Kryes. Sende (para, ushqime etj.) të nevojshme për të jetuar; fin. fonde, para. Mjetet financiare (buxhetore, monetare, xhiruese). Mjetet e lira. Mjetet e jetesës. Mjetet e pagesave.

4. Pjesë përbërëse e diçkaje, element që hyn në përbërjen e një tërësie ose që kryen një funksion të caktuar. Mjetet letrare (artistike). Mjete gramatikore (sintaksore, leksikore, fjalëformuese). Mjet stilistik (shprehës). Mjetet e

kompozimit. Mjetet e prodhimit ek. tërësia e veglave dhe e objekteve të punës që përdorin njerëzit në procesin e punës për të përvetësuar lëndët natyrore dhe për të prodhuar të mirat materiale.¹

Pra, mjeti është instrument apo shkak që të shpie drejt qëllimit ose të ndihmon për të arritur këtë qëllim. Fetarisht mjet quhen instrumentet, shkaqet ose rrugët, të cilat përdoren për të komunikuar thirrjen islame (dave). Mjetet ndahen në dy lloje: Materiale, si makina, hekuri, letra, altoparlanti, minberi, ku hipet për të mbajtur hytben, kasetat, CD-të, e mjetet e tjera. Vepruese, që janë mënyrat që ndiqen në veçanti për të formën e ligjërit, mësimdhënies dhe komunikimit, siç janë: mësimet, bashkëbisedimet, debatet, sesionet shkencore, simpoziumet, konferencat etj. Mjeti me këtë rast shëmbëllen me stilin dhe mënyrën, sipas këtij kuptimi, por shembujt që përmendëm e qartësojnë se stili është diçka tjetër. Vetë mjeti në shumicën e rasteve nuk ka ndikim në realizimin e pikësnyimit, as në përmbajtjen e predikimit që paraqitet, as në mënyrën e adhurimit dhe as në thelbin e thirrjes. Ndikimi i tij është te zhvillimi, procesi që ndodh, në shtimin e qartësisë, në memorizimin e informacionit, në zgjerimin e hapësirës së thirrjes, në lehtësimin e kryerjes së tij etj.²



Ato mund të paraqiten si në vijim:

1. Mjetet audio, siç janë: radio, seminare, hytbe, debate, ligjërata etj.;
2. Mjetet e leximit, siç janë: gazetat, revistat, librat, fletushkat etj.;
3. Mjetet vizive, siç janë: televizioni, kinemaja, teatri, video etj.;
4. Mjetet individuale, siç janë: intervistat, thirrja individuale, bisedat, komplimentet etj.

Qëllimet ndahen në: esenciale konstante (të pandryshueshme) dhe qëllime sekondare të përkohshme. Kurse metodat duhet të jenë të përziera, të ndryshueshme dhe zhvilluese. Metodot doemos të pësojnë ndryshim, llojlloshmëri dhe zhvillim në vazhdimësi, huazim të përvojave të myslimanëve dhe jomyslimanëve, sepse urtësia është gjë e munguar e besimtarëve. Kudo që e gjen atë, e merr. Secila metodë e punës dëftore vlerësohet sipas dy kritereve, e para do të vlerësohet pas nevojës reale për atë, kurse e dyta që dobitë e saj të jenë më shumë se dëmet, përndryshe nuk do të merrej parasysh.³

Influenca - ndikimi

Secili individ i cili ka hyrë në fushën e predikimit islam duhet ta dijë se e ka rolin e dërguesit, kurse në anën tjetër ka dëgjues (pranues) të mesazhit. Sigurisht që mesazhi i tij duhet të jetë me ndikim mbi mendjen e atyre që ndjekin ligjëratën, ngase nëse ideja që arrin në mendjen e pranuesit (xhematit) do ta ketë fuqinë e ndikimit sipas fuqisë së dërguesit, kualitetit dhe ndikimit, varësisht gjendjes së pranuesit.

a. Kurani ka marrë në konsideratë psikologjinë e masave

Shoqëritë e ndryshme, si dhe individët, kanë identitete tipologjike dhe psikologjike specifike. Në lidhje me këtë Allahu xh. sh. thotë: “Përqendrohu në vetveten tënde sinjerisht në fenë, i liruar prej çdo të kote, (e ajo fe), feja e Allahut në të cilën i krijoi njerëzit, s’ka ndryshim (mos ndryshoni) të asaj natyrshmërie të krijuar nga Allahu, ajo është feja e drejtë por shumica e njerëzve nuk e dinë.” (Err-Rrum, 30)

b. Kurani po ashtu ka marrë në konsideratë zakonet/traditën shoqërore.

Ajetet e mëposhtme tregojnë se Kurani u ka kushtuar rëndësi identiteteve

psikologjike të shoqërive të ndryshme dhe prej besimtarëve ka kërkuar që ata të sillen në kontekst të traditave të vendit ku jetojnë, madje, disa herë janë përdorur edhe trajta urdhëruese, obligative për ndjekjen e tyre: “Nga ju le të jetë grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit.” (Ali Imran, 104); “I besojnë Allahut dhe së ditës, këshillojnë për të mirë dhe largojnë nga të dobishme, edhe ata janë prej të mirëve.” (Ali Imran, 114); “(Të Xhenetit janë) Edhe ata që pendohen, ata që sinjerisht adhurojnë, ata që falënderojnë, ata që agjërojnë, ata që bëjnë ruku, që bëjnë sexhde, që urdhërojnë për të mira e ndalojnë nga të këqijat, edhe përmbushin dispozitat e Allahut. Pra, përgëzoj besimtarët.” (Et -Tevbe, 112).

Në këto ajete, Kurani i pranon si të mira, madje disa edhe si obligime fetare, çështjet e traditës dhe ato që janë pozitive, duke i kategorizuar si ma’ruf (vepra të mira të bukura, që janë të pranuar për shoqërinë dhe fenë). Zakonet ndryshojnë prej popullit në popull. Andaj mund të themi se ndihmat sociale, komplimentet, manifestimet, bamirësitë etj., të cilat janë të veçanta për popuj të caktuar, ka mundësi të konsiderohet nën termin e ma’rufit të lartcekur në Kuran, dhe konkludojmë se mësimet kuranore kanë pasur në konsideratë psikologjinë shoqërore në lidhje me përcaktimin e normave të sjelljes. Andaj edhe thirrësi në islam (imami) duhet të ndjek modelin e Kuranit sa i përket respektimit të veçorive të secilës shoqëri që mos të bie ndesh dhe të has në vështirësi e pengesa në misionin e tij. Ai vazhdimisht kujton tregimin e Kuranit për kodet e traditës së popujve dhe për identitetin tipologjik të tyre, dhe kjo ka ndikuar që juristët myslimanë të thonë: “Ajo që është e thukët me traditë është edhe me tekst.” Dhe së këtijmi të ndërtojnë qëndrim juridik në lidhje me konsideratën ndaj traditës. Mos marrja në konsideratë e zakoneve që e përbëjnë identitetin dhe tipologjinë e karakterit të një shoqërie, sipas Gustav Le Bon-it, është injorim i shoqërisë. Meqë edhe psikologët çdo shoqëri e analizojnë si organizëm të krijuar gjatë historisë, nuk e shohin të

mundshëm asnjë qytetërim pa traditë dhe pa shpirt kombëtar. Sipas tyre, nuk ka qytetërim pa traditë të rrënjësor.⁴

Natyra e shoqërive

Bazuar në konfirmimet kuranore, si bazë duhet të merret psikologjia, tradita, zakonet dhe botëkuptimi për estetikën i çdo shoqërie dhe në korrelacion me të, aplikohen mendimet e ndryshme fetare. Vetëm me këtë mendësi, në botën e konstruktuar nga Kurani ka mundësi që duke marrë në konsideratë gjendjet shpirtërore të njerëzve dhe mozaikët kulturore të ndryshme, të jetohej bashkë dhe pa kundërshtime. Kurani assesi nuk është për krijimin e një tipi individi ose të një shoqërie të shabllonizuar, ku nuk do të merren parasysh animet e përgjithshme, dukuritë shpirtërore dhe realitetet psikologjike. Disa mendimtarë (muxhtehidë) të ndritur e kanë perceptuar mirë shpirtin kuranor dhe duke pasur elementin njeri dhe gjendjen socio-kulturore dhe shpirtërore të njeriut kanë dhënë mendime adekuate për jetësimin e Islamit në shoqëritë e ndryshme, por pa i dhunuar kufijtë e shpalljes dhe duke qenë të ndjeshëm për mënyrën e jetesës së shoqërisë gjegjëse, të estetikës, zakoneve dhe mentalitetit të saj. Madje, disa herë udhëheqësit myslimanë për shkak të ndryshimit të kushteve kohore dhe hapësirave kanë vepruar ndryshe nga mënyra e veprimt në kohën e Pejgamberit a.s.

Predikuesi i mësimave fetare (dave) po ashtu i kushton kujdes të veçantë edhe gjuhës si mjet thirrjeje, e cila ka rëndësi të madhe për unitetin dhe afrimin mes njerëzve. Kurani përpiqet që në ligjërimin e tij t’i drejtohet dhe t’i bindë njerëzit duke marrë në konsideratë gradën kulturore, mjedisin shoqërore dhe faktorët e tjerë pozitivë ose negativë të asaj shoqërie. Kjo ngase Kurani dhe Muhamedi i kanë kushtuar kujdes psikologjisë së individëve dhe shoqërive që më pas ka bërë që një numër tepër i madh i njerëzve të përqafojnë vlerat islame.⁵

Këtu duam të shkoqisim pesë çështje:

Predikuesi patjetër që duhet të di mjedisin që e rrethon pranuesin apo dëgjuesin, ngase secili individ apo shoqëri ka specifiktat e saj.

Duhet njohur veçantitë, mendimin dhe aspiratat e traditat e targetit (xhematit) të synuar. Këtu është me rëndësi të theksohet se te disa popuj apo individë më shumë kanë ndikim çështjet emocionale se sa ato të mendimit, që rrjedhimisht pastaj i dërgojnë apo fitojnë kulturë sjelljeje apo të kuptuar. Në këtë ambient social ekziston mundësia t'i pranojë këto mesazhe apo edhe t'i refuzojë.

Çdo popull ka besimin e tij, fraksionet dhe shijet e veçanta. Kjo mund të gjendet në kuadër të thirrjes për jomyslimanët apo edhe shkëputja e gjatë nga jeta dhe frymini islam, që si pasojë kanë qenë në ndikimin e sistemeve si ateiste, komuniste socialiste, etj.

Po ashtu çdo popull ka kulturën, arsimin dhe trashëgiminë e tij, dhe çdo botëkuptim e ndërton mbi këto bazamente, pa mos hyrë në thellësinë e gjykitimit se çfarë niveli apo ndikimi kanë ato qoftë në rrafshin kombëtar apo ndërkombëtar.

Çdo komunitet ka synimet, qëllimet dhe shpresat, qofshin ato të natyrës materialiste apo metafizike. Në këtë rast thirrësi në islam duhet të ketë para vetës këtë pikë dhe t'i kushtojë rëndësi dhe të ketë një ide të përgjithshme për këta individë, familje, kabile, popuj e assesi nuk guxon të rrezojë, të bëhet i verbër në këtë fushë, sepse do të ndeshet me realitetin e hidhur që do t'i kushtojë shumë atij personalisht, por edhe vetë misionit, konkretisht mesazhit islam.

Kurani në këtë aspekt i ka ligjëruar natyrës së shëndosh dhe ka ofruar shtegdalje duke e konsideruar si premtim fitimin e Xhenetit, sikurse po ashtu i ka folur edhe natyrës jo të shëndoshë duke e paralajmëruar për vështirësitë, ndëshkimet që e presin qoftë në rrafshin e kësaj bote, ligjore si dhe ndëshkimi në botën tjetër.

Ftesa e Kuranit, reflektim drejt arsyes dhe besimit të drejtë

Ligjërata e Kuranit është e drejtuar edhe për hebrejtë dhe të krishterët duke polemizuar me ta dhe duke ua treguar gabimet si dhe ftesën për të reflektuar drejt arsyes dhe besimit të drejtë.

Kështu tejet qenësore është fakti se sa

ka rëndësi vetë thirrja, po aq me rëndësi është edhe metoda, mjeti e stili që do ta ndjekin gjatë thirrjes. Gabimet në stil të sjellin në nivel të pamundësisë për të zgjedhur të vërtetën. Për këtë arsye, duhet të jemi në gjendje që fjalimet t'i zhvillojmë duke i zgjedhur, duke i matur mirë dhe duke i mbajtur llogari për ato që i themi. Ngel që çdo fjalë është duke u regjistruar. Duhet zgjedhur mjediset e tolerancës dhe të përmirësimit. Koha e përplasjes, e tensionimit dhe e kaosit është momenti më i vështirë për të shtrirë zërin dhe për ta bërë të kuptueshme fjalën që duhet thënë.⁶

Mësimet kuranore po ashtu iu janë drejtuar edhe pasuesve apo adhuruesve të yjeve, planetëve dhe idhujve të tjerë që të drejtohen kah Krijuesi i këtyre krijesave.

Në këtë vazhde gjejmë që ajete të Kuranit iu flasin natyrës së frikësuar të qenies njerëzore të Beni Israilve, siç thotë ajeti kuranor: "Ata (populli i Musait) thanë: "O Musa, aty është një popull i fuqishëm (dhunues), prandaj ne nuk do të hyjmë aty kurrë derisa ata të mos dalin nga ajo (të na e lirojnë pa luftë), nëse dalin ata nga ajo, ne nuk hyjmë." (El Maide, 22).

Ndërsa, duke ju folur të frikësuarve dhe të ngjashmëve sikur ata të cilët mendojnë vetëm për këtë ajet thuhet: "Thuaj: "Edhe sikur të ishit në shtëpitë tuaja, atyre që është caktuar mbytja (vdekja), do të dilnin në vendin e flijimit të tyre." Në mënyrë që Allahu të provojë atë që është në zemrat e tuaja (sinqeritetin ose hipokrizinë) dhe që të pastrojë atë që është në zemrat tuaja. Allahu i di shumë mirë të fshehtat në zemrat." (Ali Imran, 154).

Kurse në një vend tjetër po ashtu thotë: "O besimtarë, mos u bëni si ata që nuk besuan dhe për vëllezërit e tyre që kishin dalë në udhëtim (tregtie e gjallërimi) ose që kishin shkuar në luftë thoshin: "Sikur të kishin qëndruar pranë nesh (e të mos dilnin), atë (bindje), Allahu ua bëri një dëshpërim në zemrat e tyre. Pse Allahu është Ai që jep jetë dhe jep vdekje dhe Allahu sheh atë që ju punoni. E sikur të ishit mbytur në rrugën e Allahut, ose t'u kishte zënë vdekja, do të gëzonit falje e mëshirë prej Allahut që është shumë më e dobishme se ajo çka ata grumbullojnë." (Ali Imran, 156-157).

Kurani me këtë rast i ka kushtuar theks të veçantë trajtimit të materializmit despotik, sikurse po ashtu ka ndaluar teprimin në spiritualitet dhe vetë izolim

duke hequr dorë nga kjo botë dhe duke paralajmëruar për sëmundje që mund të rrjedhin nga këto ekstreme, dhe njëkohësisht ka ofruar edhe recetën e shërimit nga këto sëmundje. Kjo çështje po ashtu ka gjetur trajtim teorik dhe praktik në vetë jetën e Muhamedit a.s., e më vonë edhe te generatat vijuese.

Gjykimi për mjetet e thirrjes ndërmjet njerëzve është i skajshëm dhe i mesëm. Një pjesë thonë se çdo mjet në origjinë është i lejuar në mënyrë absolute. Kështu që për këtë grup lejohet përdorimi i çdo lloj mjeti që ka mundësi të përdoret, pa marrë parasysh kriteret apo dëmet fetare që sjell. Ndërsa një pjesë tjetër e shtrëngon çështjen duke e konsideruar që në origjinë dhe të pandryshueshme. Ky grup nuk i lejon mjetet e thirrjes veçse për ato që ka tekste fetare, ajet apo hadith. Që të dyja këto skaje duket qartë se e kanë gabim. Ata që lejojnë çdo gjë, bien edhe në ndalesat e Zotit, ndërsa ata që ndalojnë dhe shtrëngojnë, privojnë përfitimet e dobive që vijnë nga këto mjete dhe bëhen pengesë për ecurinë e thirrjes islame. Është e ditur se thirrja për tek Allahu xh.sh., nuk mund të bëhet me gjëra të ndaluara, ndryshe do të ishim makiavelistë dhe jo ndjekës të fesë së Zotit, ashtu siç edhe në fe nuk ka çdo gjë fikse, sidomos nga ato me të cilat i vihet në ndihmë diçkaje të ligjëruar nga feja. Ata që i ndalojnë, praktikisht janë nga të parët që praktikojnë të kundërtën e kësaj në aktivitetin e tyre thirrës. E mesmja e drejtë është se mjetet – të dyja llojet – në origjinë janë të lejuara, përveç atyre që ka argument se janë të ndaluara. Mjetet e thirrjes i përkasin fushës së opinionit dhe mendimit individual. Përdorimi i tyre u nënshtrohet rregullave të dëmeve dhe dobive. Xhamia mund të ndërtohet prej muri balte, guri, hekuri, betoni, si dhe t'i përshtatet kohës, vendit dhe njerëzve.⁷

1. Jani Thomai, Miço Samara, Pavli Haxhillazi, Hajri Shehu, Thanasi Feka, Valter Memisha, Artan Goga, Fjalori i Gjuhës shqipe, Akademia e shkencave e Shqipërisë, Instituti i gjuhësisë dhe letërsisë, Tiranë 2006, f. 639. 2. Adnan al-Araur, Menhexhu eddavefi fi dav'il kitab ve essune, f.156. 3. Hisham Talib, Besëlidhja e thirrjes islame, Logos-A, Shkup, 2017, f. 32-33. 4. Guštave Le Bone, Psikologjia e popujve dhe e turmave, Fan Noli, Tiranë, pa vit botimi, f. 74. 5. Hayati Haydin, Metodët kuranore të bindjes psikologjike, Logos-A, Shkup, 2013, f. 48. 6. Ramazan Kayan, Thirrja islame akt profetik, Fleta, Prizren, 2017, f. 102. 7. Adnan al-Araur, Menhexhu eddavefi fi dav'il kitab ve essune, f. 232.

Nuridin Ahmeti

Roli i krerëve fetarë myslimanë në unifikimin e alfabetit të gjuhës shqipe më 1908 (2)

Hoxhë Ismail Hakiu dhe hoxhë Vildan Dibra

Dy personalitet nga radhët e krerëve fetarë myslimanë, që me veprimet e tyre luajtën rol me rëndësi në unifikimin e alfabetit të gjuhës shqipe në Kongresin e Manastirit ishin edhe hoxhë Ismail Hakiu¹ dhe hoxhë Vildan Dibra.

Derisa, për hoxhë Vildan Dibrën u përmend edhe në shkrimet e Mit'hat Frashërit, Gj. Qiriazit dhe raportin bullgarë të cilat trajtuan si më sipër, për hoxhë Ismail Hakiun nuk u apostrofua shumë në këto ngjarje, edhe pse kontributi i tij në këtë kongres ishte i theksueshëm, po aq sa edhe i hoxhë Vildan Dibrës. Ishin dy personalitet të shquara me origjinë nga Maqedonia, anëtarë të Komitetit të Stambollit, të cilët u dërguan nga Stambolli për ta përkrahur iniciativën e rilindësve në Kongresin e Manastirit më 1908.

Në raportet austro-hungareze, potencohet roli i hoxhë Vildan Dibrës dhe i hoxhë Ismail Hakiut në vazhdimësi. Ata morën mision që t'i vizitonin të gjitha trevat shqiptare, duke mbajtur ligjëratë se alfabeti i gjuhës shqipe me shkronja latine nuk bie ndesh me normat kuranore dhe fokusi tjetër i ligjëratës së tyre ishte ai i unifikimit të shqiptarëve pa dallime fetare.

Studiuesi Stavro Skendi, vë në dukje se nga mesi i vitit 1908 ishte krijuar Lidhja Kombëtare për Mbarësinë e Shkollave Shqipe, e cila lidhje bisedonte edhe për çështjen e shkollave. Nga disa burime shihet se kjo lidhje ishte e interesuar që sa më

Në raportet austro-hungareze, potencohet roli i hoxhë Vildan Dibrës dhe i hoxhë Ismail Hakiut në vazhdimësi. Ata morën mision që t'i vizitonin të gjitha trevat shqiptare, duke mbajtur ligjëratë se alfabeti i gjuhës shqipe me shkronja latine nuk bie ndesh me normat kuranore...

shumë të përhapej në trevat shqiptare. Përhapja e kësaj organizate pothuajse i ishte besuar hoxhallarëve.

Sipas një shënimi, Komiteti i Stambollit u kishte caktuar rregullore të veprimit hoxhë Vildan Dibrës, hoxhë Ismail Hakiut dhe përkrahësve të tyre. Kjo rregullore përbehej prej dymbëdhjetë pikave, ndërsa pika një dhe dymbëdhjetë, siç vë në dukje edhe shënimi i vitit 1908 i konsullatës austro-hungareze në Manastir ishin këto: "Në të gjitha viset e Shqipërisë do të dërgohen hoxhallarë për të bërë propagandë nacionale shqiptare dhe hoxhallarët e dërguar ndër fshatra do të zgjedhin me kujdes personat e përshtatshëm duke u njohur mandateve të tyre emrat dhe pastaj dega e komitetit ka për të dërguar një person të përshtatshëm dhe do të

krijojë një degë të re të komitetit".²

Konsullata austro-hungareze në Manastir, për rolin e dy krerëve fetarë të kësaj ane, dërgon këto dy shënime, të cilat ne i kemi marrë në shqyrtim në këtë punim. Shënimi i parë titullohet: "Misioni i hoxhë Ismail Hakiut në Manastir, anëtar i Komitetit të Fshehtë të Stambollit. Synim për themelimin e komiteteve të fshehta". Shënimi dërgohet në muajin dhjetor të vitit 1908 nga Manastiri dhe në mes tjerash shkruan: "Hoxhë Ismail Hakiu Beu, shqiptar me prejardhje nga Manastiri, i njohur si kortizan i xhonturqeve, ka arritur këtu para disa ditëve prej një udhëtimi që kishte bërë me tre shokë, që kishin misionin e njajhtë në Vilajetin e Kosovës për një qëndrim të shkurtër këtu, si ai për të cilin ishte qenë dërguar haxhi Vildani nga Manastiri në Shkodër (relacioni, dt., 23 Nëntor 1908). Ai mbajti para shumë mijëra ndiguesave në pjesë të madhe muhamedan në Xhaminë e Madhe një fjalim të gjatë, i cili ka bërë një përshtypje të thellë....Siç kam marrë vesh në mënyrë tepër konfidenciale Ismail Hakiu ishte një antar i shquar i Komitetit të fshehtë të shqiptarëve të Istambullit, qendra e të cilit mbas të gjitha gjasave duket se është në Istambull dhe ai është ngarkuar po me atë detyrë sekrete si ajo e mikut të tij të Presidentit të Klubit të këtushëm "Bashkimi" Rexhep Hoxhës"³ - theksohet në këtë shënim.

Ndërsa, në shënimin e parë bëhet fjalë për hoxhë Ismail Hakiun nga Manastiri, në shënimin tjetër të cilin

ne e kemi marrë në shqyrtim bëhet fjalë hoxhë Vildan Dibrën. Ky shënim titullohet: “Delegatët e Klubit të Stambollit, hoxhë Vildan Efendiu, kolonel Ali Riza dhe avokat Abdyl bej Ypi. 31 dhjetor 1908.

Pra, ky shënim siç edhe mund të kuptohet nga titulli, i kushtohet në tërësi veprimtarisë së hoxhë Vildan Dibrës. Në këtë shënim në mes tjerash thuhet: “Pjesëtarët e Kongresit të alfabetit në Manastir, ishin në fillim të mendimit se Vildan Efendiu me shokë vinin për t’i bindur që t’i praninin për alfabet shqiptar shkronjat turqishte, por nga fjalimet e mbajtura prej tyre në Manastir, u duk menjëherë se ishte e kundërta. Hoxha theksoj atje dhe në vendet e tjera se shqiptarët duhet të sqarohen mbi propagandën e përhapur nga disa fanatik turk se Kurani e ndaluaka që shqipja të shkruhet ndryshe veç se me shkronja arabe. Prandaj, një gjuhë mund ta shkruajmë si ta duam si t’i përshtatemi më mirë asaj. Shkronjat rrjedhin prej dorës së njeriut dhe nuk rrjedhin prej Zotit. Nuk mund të thuhet se arabishtja qenka e vetmja gjuhë që e ka pëlqyer Zoti, sepse ekzistojnë shumë libra fetare dhe në gjuhën turqishte. Prandaj, nuk ekziston as edhe një pengim që shqipja të shkruhet me shkronja latine. Delegatët kishin pastaj për detyrë të zgjonin ndjenjat kombëtare, të formonin klube shqiptare të zgjonin dëshirën për leximin e shkrimeve shqipe etj., detyrë që ata e kryenin vetëm me nuanca të ndryshme dhe sipas gjendjes së lëvizjes kombëtare nëpër krahinat e veçanta. Ata folën edhe mbi paqen e nevojshme ndërmjet secilës fe,⁴ - theksohet në mes tjerash në shënim.

Përfundim

Nga shënimet e prezantuara si më sipër, mund të konstatojë se krerët fetarë myslimanë, të kësaj anë, në këtë ngjarje, një pjesë e tyre dhanë kontribute të çmuara, së bashku më krerët tjerë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Shënimet bullgare, austro-hungareze, por edhe shënimet e tjera të lartcekura, kur flasin për krerët fetarë myslimanë të kësaj ane, personalitet e tyre i shkruajnë me epitete të larta si “anëtar i shquar” etj. Këto shënime nxjerrin në pah kontributin e krerëve fetarë të kësaj ane jo vetëm në

Kongresin e Manastirit, por edhe në veprimtari të tjera më frymë kombëtare.

Ndër me të apostrofuat në trajtimet e lartcekura, shihet se janë hoxhë Ismail Hakiu dhe hoxhë Vildan Dibra, por duhet potencuar se raporti bullgarë, e ndoshta nga të vetmit shënim që kemi potencuar si më sipër, vë në dukje edhe rolin e myftiut të Manastirit, i cili sipas raportit bullgarë ishte me origjinë nga Tetova dhe quhej Rexhep Efendi, fjalimi i të cilit kishte lënë përshtypje të mira te të pranishmit, po aq sa kishte lënë përshtypje edhe gjesti i Hafiz Ibrahim Shkupit me rastin e përshëndetjes së Gjergj Fishtës në këtë kongres. Duhet theksuar se studiuesit Stavro Skendi⁵ edhe Peter Bratl,⁶ ky i fundit i referohet Stavro Skendin, potencojnë se krerët fetarë myslimanë përdorimin e alfabetit latin e konsideronin si diçka jashtë normave kuranore. Pa dyshim se ka pasur edhe nga ata të cilët kanë menduar kështu. Por, burimet e gjertanishme, disa prej të cilëve i kemi trajtuar si më sipër, e kanë vërtetuar katërcipërisht se kishte edhe nga autoritet e njohura të krerëve fetarë myslimanë si Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu, e personalitet fetare myslimane nga Maqedonia, disa prej të cilëve i cekëm më lart, që e përkrahen nismën e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për një alfabet të unisuar të gjuhës shqipe me shkronja latine.

Për sa më sipër, ne mendojmë, se fjalët e thëna nga hoxhë Vildan Efendiu të cilat potencohen edhe në raportet e konsullatës austro-hungareze se “një gjuhë mund ta shkruajmë si ta duam si t’i përshtatemi më mirë asaj. Shkronjat rrjedhin prej dorës së njeriut dhe nuk rrjedhin prej Zotit. Nuk mund të thuhet se arabishtja qenka e vetmja gjuhë që e ka pëlqyer Zoti, sepse ekzistojnë shumë libra fetare dhe në gjuhën turqishte. Prandaj, nuk ekziston as edhe një



Vendimi për alfabetin e gjuhës shqipe

pengim që shqipja të shkruhet me shkronja latine”⁷ - janë më tepër se përkrahje për këtë nismë; këto fjalë paraqesin njëkohësisht edhe fetvanë e krerëve tanë fetarë myslimanë të kohës për shkronjat me të cilat sot shkruhet gjuha jonë shqipe.

1. Ismail Haki ef. Manastiri (1846-1912). Dijetar i shquar, profesor universitar, publicist, autor i shumë veprave. Lindi në Manastir, prandaj dhe u bë i njohur sipas vendlindjes. Botoi shumë shkrime në gazetën “Sirat-i müstakim”, të cilën e drejtonte vetë ai, si dhe në gazetën “Sebil’ur-reşad” me kryeredaktor Mehmet Akif Pejani. Ishte autor i dhjetëra veprave nga fusha e shkencave islame. Vdiq më 21 nëntor 1912 dhe u varros në oborrin e xhamisë “Fatih” në Stamboll. Shih: Süleymen Baki, Manastırlı İsmail Hakkı ve Telhisü'l-Kelâm Eseri, Logos-A, Shkup, 2006. 2. Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien (më tej: HHSt.A.PA.A), në Arkivi i Institutit të Historisë - Tiranë, (më tej: AIHT), AIHT, Vj. 18-7-751. Raport i Posfajt nga Manastiri dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, më 7 dhjetor 1908. 3. AIHT, Vj. 18-7-751. Raport i Posfajt nga Manastiri dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, më 7 dhjetor 1908. 4. HHSt.A.PA.A në AIHT, Vj. 18-2-245. Raport i Kral dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, më 31 dhjetor 1908. 5. Stavro Skendi, Zgjidimi kombëtar shqiptarë, (Përkthyer nga Skënder Luarasi-Nestor Neprevishta), Phoenix & Shtëpia e Librit, Tiranë, 2000, f. 347. 6. Peter Bratl, Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësinë kombëtare (1878-1912), (Përkthyer nga Nestor Neprevishta), ShB, Dituria, Tiranë, 2006, f. 203. 7. HHSt.A.PA.A në AIHT, Vj. 18-2-245.

Vaxhide Bunjaku

Roli i gruas në BLK për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm

Gratë në përgjithësi kanë një forcë dhe mundësi për të arritur ndryshimin në shoqëri. Ato, përgjatë historisë kanë luajtur një rol të rëndësishëm dhe ende vazhdojnë të kenë një rol, përmes së cilit kanë demonstruar aftësitë e tyre për të ndryshuar pozitivisht në shoqëri.

Qartësia në caktimin e rolit të gruas në jetë, sigurisht që të orientojnë për arsimimin e saj, ndaj edhe këtu theksojmë se arsimimi dhe prania e saj në aspektet dhe fushat e ndryshme të jetës, na bënë të kuptojmë dhe na jep dëshmi se janë ndër elementet kryesore në sjelljen e procesit të ndryshimit të mirëfilltë.

Për të ndryshuar gjendjen në shoqëri, gjendje kjo e cila ka bërë që të gjithë të jemi të preokupuar për secilin nga ne për shkak të dukurive negative që janë prezent në mesin tonë, përfshirë këtu edhe ekstremizmin dhe radikalizmin që shfaqet nga personat dhe grupet e targetuara, shpeshherë ky ndryshim varet nga gratë dhe nga angazhimi i tyre, pasi që ato luajnë një rol themelor në ndërtimin e familjes, e cila është baza dhe trungu i shoqërisë.

Në të kaluarën është diskutuar për rolin e gruas në luftën kundër terrorizmit dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, për atë se si gratë mund të kenë përfshirje dhe perspektivë në fushën e sigurisë në përgjithësi, por në bazë të studimeve që janë bërë është miratuar se pjesëmarrja e grave në sektorin e sigurisë llogaritet një nga shtyllat që

Përfshirja e grave, e sidomos vetëdijesimi i tyre në identifikimin dhe raportimin e elementeve ekstreme brenda familjeve të tyre mbetet ndër faktorët qenësorë në parandalimin e ekstremizmit.

çon në efektivitetin më të madh në uljen e dhunës dhe parandalimin e konflikteve.¹

Mos të harrojmë se për nga shifrat numerike, gratë janë gjysma e shoqërisë, kurse sa i përket formimit dhe ndikimit, ato janë e tërë shoqëria.

Themi se nënat në familje shpeshherë janë në gjendje të shohin shenjat e hershme të ekstremizmit, andaj, ato janë të etuara të ushtrojnë rolin e tyre për t'iu dalë në ndihmë fëmijëve të tyre për të mos e marrë këtë rrugë. Ato vetëdijesohen përmes mësimave të mirëfillta të fesë nga mualimet tona, të cilat bëjnë vetëdijesimin e tyre nga keqinterpretimet e fesë për ta parandaluar ekstremizmin e dhunshëm dhe rreziqet e mundshme që mund të dalin nga njerëzit ekstrem dhe radikal.

Kur bëhet fjalë për procesin e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, proces ky i lidhur ngushtë me identifikimin e hershëm të faktorëve, shkaqeve dhe personave – grupeve të targetuara, vlen të theksohet se gratë që punojnë në Bashkësinë Islame, duke e ditur rolin dhe pozitën e tyre në shoqëri, jo vetëm që synojnë parandalimin e





ekstremizmit dhe të radikalizmit në vend, por ato janë edhe pjesëmarrëse në luftimin e kësaj dukurie.

Përfshirja e grave, e sidomos vetëdijesimi i tyre në identifikimin dhe raportimin e elementeve ekstreme brenda familjeve të tyre mbetet ndër faktorët qenësorë në parandalimin e ekstremizmit. E për t'u zbuluar kjo, nevojitet një kontribut i madh, kontribut ky i cili nuk mungon nga mualimet e BIK-ut në terren, të cilat përmes ligjëratave të tyre arrijnë fuqizimin e grave me mësimet e mirëfillta të Islamit të vërtetë. Njohuritë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm janë rritur përmes këtyre aktiviteteve dhe angazhimeve që bëjnë gratë e BIK-ut.

Roli i gruas duhet të jetë në fokus të veçantë, për shkak se gratë shumë lehtë mund të ndikojnë te gratë dhe se ato mund ta menaxhojnë situatën në familje. Nga ky këndvështrim, themi se vetëdijesimi i një gruaje paraqet një shoqëri të vetëdijesuar, po ashtu edhe te të rinjtë, nëse ata vetëdijesohen dhe edukohen në moshën e hershme, shumë më lehtë do të dinë të menaxhojnë problemin e ekstremizmit të dhunshëm, nëse veç ata përballen me të.

Departamenti i Gruas pranë

Nëna ka një pozitë të lartë dhe një respekt të madh në jetën e fëmijëve të saj, e kjo më së shumti ndikon që ajo të shpenzojë energjinë e saj maksimale në ruajtjen dhe kujdesin për familje.

BIK-ut, përmes bashkëpunimit që ka me Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe me OSBE-në, kanë mbajtur shumë takime dhe trajnime lidhur me këtë fushë, me të cilat është synuar që njohuritë e marra nga këto trajnime të paraqiten edhe në komunitet, te gratë dhe te të rinjtë.

Në vendin tonë, roli i gruas në parandalimin e ekstremizmit ka një vend të rëndësishëm, nëna ka një pozitë të lartë dhe një respekt të madh në jetën e fëmijëve të saj, e kjo

më së shumti ndikon që ajo të shpenzojë energjinë e saj maksimale në ruajtjen dhe kujdesin për familje.

Megjithatë, shteti ynë duhet të fuqizojë edhe më shumë rolin e grave në përgjithësi, përfshirë këtu edhe gratë e religjionit, mos të ketë diskriminim tek ato, në veçanti te vajzat dhe gratë me mbulesë, pasi që kjo mund të ndikojë në mos socializimin e grave dhe vajzave tona që bartin mbulesë.

Nëse duam të arrijmë sukses, atëherë kjo arrihet përmes aktiviteteve të ndryshme, duke pasur parasysh bashkëpunimin me gratë e institucioneve të vendit dhe të atyre të OJQ-ve të ndryshme, me qëllim të përmirësimit dhe të tejkalimit të sfidave dhe problemeve që na kanosen çdo ditë.

Bashkësia Islame e Kosovës ka ofruar hapësira të mjaftueshme për gratë që duan të jenë aktive në kuadër të këtij institucioni, duke e bërë të mundur punësimin e teologeve nëpër këshillat e BIK-ut, ku ato çdo ditë zhvillojnë aktivitetet e tyre.

(1) <https://sbunker.net/>

siguria-blllogje-tematike/88746/gruaja-si-parandaluese-te-ekstremizmit-te-dhunshem/

Elez Osmani

Kujtime dhe të dhëna për haxhi Osmanin nga Morina (1)

Nga jeta historike e Kosovës nuk mund të përjashtohet jeta e familjes, pavarësisht se në cilën pjesë të Kosovës jetonte, pa marrë parasysh se cila ka qenë e kaluara e secilës familje, si dhe varësisht prej asaj se kush sa kishte dhënë për të mirën e vendit.

Rrjedhimisht, në Kosovë ka pasur breza dhe individë të merituar, të cilët në momentet më kritike i dolën krah vendit të vet, besimit të vet, pa llogaritur rehatinë dhe ambiciet e tyre personale. Në këtë rrjedhë, në çdo kohë, por edhe në çdo cep të atdheut gjejmë edhe alimë të shumtë, krahë për krahë me popullin apo edhe në ballë të tyre.

Subjekti i këtij shkrimi, haxhi Osman Bekë Osmani, vuri një tullë në binanë e madhe të përpjekjeve të popullit të tij për pavarësi. Haxhi

**Haxhi Osman
Bekë Osmani, vuri
një tullë në binanë
e madhe të
përpjekjeve të
popullit të tij për
pavarësi.**

Osman Morina si individ, por edhe familja e tij, ishin të nderuar nga fisi i tyre, por edhe nga rrethina e gjerë, me të cilët ata kishin kontakte të përhershme. Vendlindja e tij Morina, ishte një fshat malor, kishte strukturën e saj shoqërore të organizimit të kohës. Kjo shtëpi,

shtëpia e Osmanëve-Hoxhajve, llogarites si shtëpia e parë, ose siç thuhej ishte paria e vendit, ngase veç të tjerash ishin edhe kreu i fisit. Andaj, anëtarët e familjes Osmani (Hoxhaj) ishin punëtorë të vyeshtëm dhe merreshin me punët e përditshme, duke punuar tokën, duke ruajtur bagëtinë, si dhe duke u kujdesur për mbarëvajtjen e jetës së familjes. Ata ishin të zgjuar dhe të shkathët, të mençur e bujarë, por në anën tjetër, ata gjithashtu kishin karakter të fortë, sa që asnjë pushtues nuk kishte arritur t'i zhvendoste nga vendlindja e tyre për të cilën luftuan disa herë.

Sipas të dhënave të familjarëve të familjes Osmani, brezat e familjes mund t'i numërojmë nga Osmani i parë, për të cilin nuk ka të dhëna të datëlindjes apo ditës së vdekjes.



Pamje nga fshati Morinë, Gjakovë



Xhamia e rrënuar e Prilepit

Osmani (Moni) i parë kishte tre djem: Bekën, Arifin dhe Ibishin. Djali i parë i Osmanit të parë, Beka, kishte pesë djem: Osmanin, Ahmetin, Bajramin, Hamzën dhe Mustafën. Osmani i dytë i cili ishte doktor i parë i shkencave fetare nga kjo anë, në atë kohë kur shkolla ishte nën mbikëqyrjen e pushtetit të Perandorisë Osmane, ishte më shumë se një lajm, ishte një kremte, festë, jo vetëm për familjen dhe fisin, por për të gjithë ne. Djali i dytë, Ibishi (gjyshi i dr. Abdylosmanit, ishte profesor i biokimisë në Fakultetin e Mjekësisë), i kishte tre djem: At'hemin, Dautin dhe Brahimin. Djali i tretë i Osmanit të parë, Arifi, i kishte tre djem: Tahirin, Nimonin dhe Arifin, pra, hoxhë Arifin, i njohur si hoxha i çafave (babai i Osman Osmanit, fqinj i Bill Klintonit në Nju Jork). Shkruan dr. Emin Kabashi në librin “Vëllezërit Osmani dhe çështja shqiptare në SHBA”, fq. 335, botim i Institutit Albanologjik në Prishtinë, 2020.

Në këtë shkrim do të hedhim sadopak dritë mbi këtë figurë, gjithnjë mbi bazën e disa burimeve. Jusuf Vatovci, në librin e tij “Leksikon i magjistrave dhe i doktorëve të shkencave dhe arteve në trojet shqiptare në Ballkan dhe jashtë tij

1430-2000”, në fq. 748, në mes tjerash shkruan: “...Mësimet fillestare dhe të mesme i mori në Medresenë e Madhe të Gjakovës, kurse studimet i bëri në Universitetin Fatih të Stambollit, ku edhe doktoroi. Dr. Osman Morina për një kohë punoi në Stamboll, e pas kthimit nga atje, u caktua profesor në Medresenë e Madhe të Gjakovës, ku punoi një kohë të gjatë dhe përcolli disa breza të kësaj medreseje. Në pleqërinë e tij u emërua imam në Prilep të Gjakovës, ku si imam i këtij fshati, vdiq në vitin 1916.”

**Djaloshit të ri
nga Morina, i
lindi dëshira për
studime të larta,
andaj edhe me
përkrahjen e
familjes dhe të
mësimdhënësve të
Medresesë së
Gjakovës, ai shkoi
në Stamboll.**

Këto të dhëna dëshmojnë dëshirën e tij për të kërkuar dije, për të qenë i aftë për veten dhe për të tjerët, për të mësuar që të punohet më mirë dhe për të qenë i vlefshëm për të tjerët.

Familja Osmani e cila i ka rrënjët në Morinë të Gjakovës, kishte jetuar në bashkësi familjare sipas traditës dhe kohës dhe numëronin mbi 55 anëtarë të familjes në një shtëpi. Rastet e tilla në atë kohë ishin të shpeshta në familjet shqiptare. Më 1960 u ndanë dhe u bënë tri shtëpi-hise, hisja e Bekajve, hisja e Ibishajve dhe hisja e Arifajve.

Anëtarët e familjes Osmani ishin punëtorë të vyeshëm dhe merreshin me bujqësi, blegtori dhe punë të tjera që i duheshin familjes. Kjo do të thotë se ata bënë jetë si të gjithë fshatarët e tjerë. Së bashku me të tjerët, ata kishin detyrime të veçanta ndaj fshatit dhe ndaj fisit, sipas rrëfimit të plakut 94 vjeçar, Beqë Mustafës, dhënë në vitin 1995. Duke e parë zgjuarsinë e djalit të madh të Bekës, Osmanit (II), familja e kishte dërguar për shkollim në mejtep. Në fillim kishte shkuar për të mësuar te Hoxhajt e Brovinës. Në atë kohë nuk kishte shkollë shqipe. Pastaj nga aty vazhdoi në Medresenë e Gjakovës. Në procesin e mësimi tregohet i zgjuar, i zellshëm, si dhe shumë i

përgatitur për lëndët mësimore.

Nga këtu, djaloshtit të ri nga Morina, i lindi dëshira për studime të larta, andaj edhe me përkrahjen e familjes dhe të mësimdhënësve të Medresesë së Gjakovës, ai shkoi në Stamboll.

Por, siç dihej, të ardhurat e familjes mezi ia mbulonin shpenzimet në qytetin e Gjakovës, e të mos flasim për shpenzimet që i duheshin në Stamboll. Por, ai e kishte vendosur, andaj edhe bënte çmos që t'i siguronte vetë mjetet që i duheshin për shkollim.

“Mund të thuhet se haxhi Osman Morina, që në atë kohë, kur nuk kishte e as nuk ishte e mundur që të kishte shkollë shqipe, e kishte kërkuar dijen brenda asaj që quhej mundësi e kohës, por edhe përtej mundësive të familjes dhe të mjedisit ku ishte rritur, sepse arriti të shkollohej në njërin nga Universitetet më të njohura të Stambollit, duke bërë përpjekje që me angazhimin e tij edhe në punë të tjera të siguronte mjetet për shkollimin e tij. Ato mundësi që ia kishte ofruar koha e tij, ai i kishte shfrytëzuar, jo duke harruar çdo gjë të përkatësisë së tij, duke filluar që nga vendlindja e deri te përkatësia etnike, ngase nga Morina e Gjakovës kishte arritur të shkonte deri në Stamboll për të nxënë dije, për të thelluar njohuritë, qoftë për jetën, qoftë për segmentet e mjekësisë, apo qoftë edhe për fenë të cilës i besonte”, thekson dr. Emin Kabashi, libri i cituar, fq. 336.

Deri tani janë disa burime që e përmendin haxhi Osman Morinën, por kujtesa popullore ka ruajtur shumë gjëra në imtësi për të. Në një intervistë që e kam bërë me plakun më të moshuar (për kohën) nga Morina, Beqë Mustafën, ai na tha dhe na rrëfeu shumë gjëra interesante.

Për ta siguruar shkollimin, Osmani si i ri kishte mësuar një zeje të zakonshme për kohën, që ishte me leverdi ekonomike. Në fakt, ai në Stamboll, natën qepte sumbulla, pra ngjiste sumbulla në jelekë te terzinjtë (rrobaqepësit) e ndryshëm, kurse ditën i vazhdonte mësimet. Plaku i Morinës tregon se nuk e di sa vjeçar

ishte kur ai shkoi në Stamboll, por e di që kishte qenë i fejuar me një vajzë nga Malësia. Mandej, nga Stambolli e kishte dërguar një haber, në mënyrë që familja e tij të merrej vesh me familjen e vajzës, pra me miqtë, që t'ia përcillnin nusen atje. Por, familja e miqve nuk ishte pajtuar që ta “humbte” vajzën në dhe të largët, ndaj edhe shkurorezohet. Kanë thënë se në studime kishte qëndruar 18 vjet. Pastaj ishte kthyer dhe në ndërkohë ishte martuar me vajzën e Emin Hoxhës nga Ptyçi (Bytyçi). Me atë vajzë kishte pasur tre fëmijë: Durrijen, Zekijen dhe djalin të cilin e kishte pagëzuar Mon, për ta përtërirë babagyshin, siç ishte zakoni (te Moni i parë, gjenealogjikisht takohemi familjet më të mëdha të Morinës: Ne–Osmanajt, Bajraktarët, Ukshinët dhe kushërinjtë nga Loxha).

Djali i tij i vetëm, Moni, kishte vdekur shumë i ri, siç kishte vdekur edhe vajza e madhe, Durrija. Ndërsa vajza tjetër, Zekija, ishte martuar me Vehbi Luzhën, te Luzhajt në Gjakovë. Me djalin e saj, Masarin (vdiq gjatë luftës, redaksia) edhe sot e kësaj dite kemi kontakte, thotë plaku, Beqë Mustafa. Duhet përmendur se në një intervistë të botuar në “Dituria islame”, Hasan ef. Nahi, ndër të tjera thekson: “...ka shumë njerëz të kësaj ane (të Gjakovës me rrethinë), të cilët meritojnë vëmendje dhe respekt të veçantë. Po i përmendi disa prej tyre: Ali Efendi, që në literaturë njihet me emrin El-Jakovi, i cili ishte nga Cerrabregu, një fshat afër Gjakovës. Tërë jetën ai ia kishte kushtuar dijes. Mësimet e ulëta i kreu në Gjakovë, ndërsa mësimet e mesme dhe të larta i kishte vazhduar dhe i kishte përfunduar në Stamboll. Ai e kishte marrë edhe titullin “Ryus”, që tanimë krahasohet me gradën shkencore të doktoratës. Por, ai kishte arritur deri në rangun e akademikut. Ishte shumë inteligjent. Sami Frashëri, duke bërë fjalë për intelektin e shqiptarëve dhe dëshirën e tyre për dituri, në Enciklopedinë e tij (Kamus ul-alam), si shembull e ka përmendur Ali Efendiun e Gjakovës, i cili përveç të tjerash kishte përgatitur edhe dy

gjenerata alimësh (dijetarësh) në Universitetin e Stambollit. Por, ka pasur edhe të tjerë, të cilët po veçoj si mjaft të njohur edhe në popull, haxhi Osman Morinën dhe Hafiz Sadriun.

Haxhi Osman Morina ishte prej një familje me tradita të mëdha fetare, intelektuale dhe patriotike, nga Morina, rrethi i Gjakovës. Edhe ky i kishte kryer studimet në Universitetin “Fatih” në Stamboll. Pas diplomimit, ia kishin ofruar qëndrimin dhe punën në Stamboll, por nuk kishte pranuar që të mbetej përgjithnjë atje, andaj edhe ishte kthyer në vendlindje. Këtu ishte përfshirë në lëvizjet përparimtare-patriotike të kohës dhe kishte bërë shumë për shpjegimin e drejtë të Islamit.” (Dituria islame, nr. 18, Prishtinë, 1990).

Kujtesa popullore ka ruajtur shumë të dhëna për të. Po veçojmë këtu se si dinte të “shkruante” dhe ta shartonte lirinë. Në atë kohë ajo bënte kërde në popull. Dijetari i shquar, Osman Beka Morina, kishte qenë dy herë në haxh, pra në atë kohë kur udhëtohej edhe nga tetë muaj, ai e kishte vizituar Qabenë. Një herë kishte shkuar për vete, kurse herën tjetër për Rustem Sadriun, Bajraktarin e Morinës.

Dëshirën, dashurinë dhe përpjekjen për ta përcjellë te njerëzit të vërtetën fetare e kombëtare, duke qenë përherë në mesin e popullit, do ta tregonte qysh në fillim kur kishte ardhur në atdhe, ngase shkoi si imam në fshatin Prilep të Deçanit, atëherë fshat i Nahijes së Gjakovës. Për muajin e shenjtë Ramazan, ai shkonte në Shkodër. Atje kishte shumë shokë dhe pritej me nderime të veçanta, si një dijetar dhe si një patriot. Tani për tani nuk e dimë saktë se kur i ka përfunduar studimet, si dhe kur është kthyer në vendlindje, por ka gjasë se duhet të jetë diku rreth viteve 1901, ngase në këto vite shqiptarët kishte shtuar përpjekjet për mëvetësi, duke filluar që nga angazhimi i atdhetarëve në Stamboll dhe më gjerë.

Isra Hyseni

Diskursi anti-emigrant si veçori e së djathtës populiste dhe ndikimi i tij politik në Evropë (1)

Në pjesën më të madhe të shekullit XX, emigrimi paraqiste një temë të veçantë brenda Bashkimit Evropian dhe trajtohej si rezultat i zbatimit të tregut të brendshëm në rrafshin regional. Kështu, eliminimi i kontroleve kufitare i paraparë me Marrëveshjen e Shengenit hapi rrugën e harmonizimit ndërmjet politikave të emigracionit dhe vetëdijes qytetare.

Megjithatë, në fundin e shekullit të kaluar, sidomos pas rënies së komunizmit dhe shpërbërjes së Jugosllavisë, kjo dukuri zgjerohet në hapësirë, duke përfshirë edhe fluksin e emigrantëve nga Evropa Lindore. Kjo çështje bëhet edhe më serioze në vitet e fundit, kur shtetet e Bashkimit Evropian kanë hasur në sfidën më të madhe emigruese që nga Lufta e Dytë Botërore. Paqëndrueshmëria politike, ekonomike e sociale në

vende si Siria, Afganistani, Eritrea etj., kanë bërë që në vitet 2015-2016, Bashkimi Evropian të shënojë numrin më të madh të emigrantëve ndonjëherë, me më shumë se 1.000.000 persona që kanë arritur në kufijtë evropianë përmes rrugëve detare.¹ Në vitin 2019, prej 272 milionë njerëzish që janë regjistruar të jetojnë jashtë vendeve të tyre të prejardhjes, 35 milionë jetojnë brenda Bashkimit Evropian; prej të cilëve 22 milionë vijnë nga jashtë.²

Kjo valë emigruese ka rënduar shumë institucionet evropiane, të cilat kanë ndërmarrë shpeshherë hapa të rreptë në kontrollimin e kufijve, duke e rregulluar çështjen e emigrimit edhe me dokumente të rëndësishme, si ai i Dublinit. Në anën tjetër, numri i madh i emigrantëve në Evropë ka sjellë për pasojë edhe ndryshime të mëdha në rrafshin shoqëror, duke ngjallur

sentimentin anti-emigrant, nacionalist dhe ksenofob ndër vendasit evropianë.³ Rrjedhimisht, këto qëndrime janë reflektuar dhe vazhdojnë të reflektohen edhe në aspektin politik, duke krijuar një dinamikë të paprecedent.

Në kreun e parë të këtij artikulli shpjegohet perceptimi negativ i shoqërisë evropiane ndaj emigrantëve në kohët e fundit, për të vazhduar me fenomenin anti-emigrant në kontekstin politik në kreun e dytë, ku flitet më hollësisht për partitë e djathta populiste dhe karakteristikat e përbashkëta ideologjike të tyre, për suksesin elektoral që ky lloj i partive korri në dy palë zgjedhjet e fundit të Parlamentit Evropian dhe për ndikimin që këto parti kanë në ndryshimin e diskursit politik të partive me profil të përgjithshëm politik.



Fenomeni anti-emigrant në Evropë

Perceptimet e përgjithshme të evropianëve ndaj emigrantëve

Kur emigrantët arrijnë në një vend të ri, integrimi i tyre në shoqëri mund të jetë procesi më sfidues dhe kompleks. Kështu, perceptimet e vendasve ndaj tyre fitojnë rëndësi. Sipas Eurobarometrit Special 469 “Integrimi i emigrantëve në Bashkimin Evropian” të realizuar në vitin 2017, ku ndër të tjera të anketuarit pyeten edhe përreth asaj se a e cilësojnë fenomenin e emigrimit si mundësi apo problem për shtetet e tyre, 4 në 10 evropianë (38%) përgjigjen se emigrimi paraqet problem, kurse 20% të tyre besojnë se paraqet mundësi, 31% e të anketuarve mendojnë se procesi i emigrimit paraqet edhe problem, edhe mundësi; 8% prej tyre thonë se nuk paraqet as problem e as mundësi; kurse 3% nuk kanë përgjigje. Këto të dhëna paraqiten në mesatare të

BE-së, edhe pse rezultatet ndryshojnë varësisht prej shteteve anëtare. Nuk është i çuditshëm fakti që në Suedi - shtet i njohur për qëndrimet e tij pro-emigrante – ekziston bindja më e lartë (45%) se emigrimi paraqet mundësi për shtetin; ndërkohë që hungarezët, maltezët e grekët – të njohur për qëndrimet anti-emigrante – mendojnë se emigrimi paraqet problem për shtetin (me nga 63%).⁴ Marrë në tërësi, perceptimet negative ndaj emigrantëve mbizotërojnë në një pjesë të madhe të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Nxitësit kryesorë të qëndrimeve anti-emigrante në Evropë

Një ndër nxitësit kryesor të qëndrimeve anti-emigrante në Evropë, është ndjesia e evropianëve se emigrantët përbëjnë pozicion kërcënues. Këtë ndjesi, sociologët e përshkruajnë më së miri me “teorinë e kërcënimit grupor”.⁵ Sipas kësaj teorie, hyrja e grupit të jashtëm (në këtë rast emigrantët) në territorin që i përket grupit të brendshëm (në këtë rast vendasit evropianë) perceptohet negativisht nga ky i fundit, ngase ekziston rreziku që të dy grupet të garojnë për burimet e pamjaftueshme. Kjo teori gjithashtu aludon se sa më i madh të jetë grupi minoritar, aq më i madh është kërcënimi i perceptuar dhe, rrjedhimisht, aq më e madhe është edhe antipatia që ndihet ndaj tij.

Kërcënimi për resurse mund të zhvillohet në dy rrjedha: kërcënimi realistik dhe ai simbolik.⁶ Kërcënimi realistik nënkupton se vendasit do të ndihen të kërcënuar në aspektin ekonomik e financiar, por gjithashtu edhe në aspektin e sigurisë fizike. Sipas të dhënave të marra nga Eurobarometri 469, pyetur nëse emigrantët paraqesin barrë financiare në sistemin shtetëror, 56% e të anketuarve janë përgjigjur pozitivisht. Më tutje, pyetur nëse ka ndërlidhje mes numrit të emigrantëve dhe rritjes së numrit të veprimeve kriminale, 55% të tyre përgjigjen se po. Në prapavijë të kësaj përgjigje

padyshim se qëndron fakti që shumë emigrantë vijnë nga Lindja e Mesme, ku e ka qendrën ISIS dhe simotrat e saj. Çështja e sigurisë nxjerr në pah edhe problemet në menaxhimin e kontrollit kufitar. Për këtë arsye, konsensusi i vetëm në Paktin e Ri për Emigrim dhe Azil (2020) është arritur në çështjen e sigurimit kufitar dhe zmbarsjes së emigrantëve.⁷

Në anën tjetër, kërcënimi simbolik përfshin frikën ndaj elementeve të identitetit kombëtar e kulturor të grupeve të jashtme. Në rastin e emigrimit në Evropë, gjatë procesit të bashkëveprimit të evropianëve me emigrantët, shfaqen paragjykime që shpeshherë kanë të bëjnë me racën, fenë dhe vlerat e ndryshme kombëtare të identitetit emigrant.⁸

Qasja e publikut evropian ndaj burimeve të ndryshme mediatike, që ndër të tjera flasin edhe për emigrimin, padyshim se zhvillon edhe më tej bindjet anti-emigrante. Për ilustrim, përgjatë vitit 2017 raportimet mediatike italiane kanë ngritur çështjen e fluksit të emigrantëve në 44% të lajmeve. Si rezultat, qëndrimet e përgjithshme anti-emigrante kanë zënë vend ndër italianët. Kjo vërehet duke pasur parasysh faktin se 75% të italianëve janë përgjigjur pozitivisht në pyetjen se a ka ndërlidhje mes numrit të emigrantëve dhe shtimit të veprimeve kriminale në vend.⁹

Partitë e djathta populiste dhe partitë me profil të përgjithshëm në raport dihotomik

Sipas profesoreshës së shkencave politike në Universitetin “Rochester” në Nju Jork, Bonnie Meguid, partitë në tërësi dallojnë në diskutet me të cilat e prezantojnë agjendën e tyre politike. Një parti mund të fokusohet në ekonomi, tjetra në ambient, e treta në emigrim. Shpesh, disa parti

Hyrja e grupit të jashtëm (në këtë rast emigrantët) në territorin që i përket grupit të brendshëm (në këtë rast vendasit evropianë) perceptohet negativisht nga ky i fundit, ngase ekziston rreziku që të dy grupet të garojnë për burimet e pamjaftueshme.

Lëvizjet e djathta refuzojnë fenomenin e bashkëjetesës ndërmjet grupeve të ndryshme kulturore e religjioze, duke e ngushtuar identitetin kombëtar e evropian si një të vetëm dhe jo të përzier.

fokusohen në elemente që partitë e tjera nuk i kushtojnë mjaft vëmendje. Kështu, mund të thuhet se ekzistojnë parti me profile më specifike në një anë, dhe parti të tjera me profil më të përgjithshëm në anën tjetër.¹⁰ Ky shabllon përdoret në mënyrë edhe më specifike në këtë artikull, për të treguar ndryshimet ndërmjet së djathtës populiste dhe partive me profil të përgjithshëm politik.¹¹

Megjithatë mund të flasim përreth së paku pesë periudhave të ideologjisë së djathtë në Evropë duke e marrë në konsideratë historinë prej fundit të shekullit XIX, edhe e djathta populiste e kohëve aktuale ndërtohet mbi elementin nacional, duke huazuar nga grupet e majta elementin revolucionar dhe duke kundërshtuar vlerat liberale nga njëra anë, dhe ato komuniste nga ana tjetër.¹² Kjo ideologji u paraqitë si trajtë moderne në sferën politike në sinkronizim me pasiguritë që shkaktoi kriza globale ekonomike dhe sulmi i kullave binjake në vitin 2001.¹³ Duke i marrë parasysh qëndrimet e ndryshme ndërmjet shteteve anëtare ndaj këtij fenomeni, një përkufizim i vetëm i djathtëzimit populist në kontekstin e Bashkimit Evropian nuk është lehtë i arritshëm.



Megjithatë, studiuesit e çështjeve politike kanë numëruar disa karakteristika të përbashkëta ideologjike të partive të djathta populiste evropiane, të cilat i ndërlidhin ato me diskursin anti-emigrant. Ndër këto karakteristika, mund të përmendim:

Ultra-nacionalizmi - Lëvizjet e djathta populiste identifkohen me elementin ultra-nacional, duke kundërshtuar fenomenet moderne të multikulturalizmit, kosmopolitanizmit dhe iniciativave mbi kombëtare. Kjo karakteristikë ideologjike përfshin tendencat etnocentrike dhe paragjy-kuese bazuar në bindje raciste. Kështu, këto lëvizje përjashtojnë elementet e huaja, duke mbajtur pozicion të kundërt ndaj identitetit të tyre kombëtar, kulturor, racor e religjioz.

Pabarazia njerëzore - Kjo pikë-pamje diskriminuese ndaj të huajve përbën një tjetër veçori të lëvizjeve të djathta. Këto lëvizje janë ithtarë të perceptimit racist se të drejtat e vendasve nuk janë të barabarta me ato të të huajve, meqenëse sipas tyre, hierarkia e të drejtave njerëzore i privilegjon anëtarët e grupit vendas.

Etno-pluralizmi - Sipas kësaj karakteristike, edhe nëse retorikisht të gjithë njerëzit janë të barabartë, ata konsiderohen të tillë brenda kufijve të caktuar gjeografikë e historikë. Rrjedhimisht, lëvizjet e djathta refuzojnë fenomenin e bashkëjetesës ndërmjet grupeve të ndryshme kulturore e religjioze, duke e ngushtuar identitetin kombëtar e evropian si një të vetëm dhe jo të përzier.

Qëndrimi kritik ndaj vlerave liberale demokratike - Edhe pse shumë parti të djathta e pranojnë teorikisht demokracinë liberale, ata e kufizojnë hapësirën që ajo përfshin, duke përjashtuar disa përbërës të rëndësishëm të saj, siç janë multikulturalizmi e diversiteti.

Populizmi - Kjo veçori është përdorur për t'i përfaqësuar interesat e përbashkëta të një populli të vetëm, pa përzier kombet e ndryshme. Nga kjo që thamë, shohim se partitë e djathta populiste i polarizojnë qëndrimet e tyre në dy blloqe: 'ne' dhe 'të tjerët'.¹⁴

1. "Europe's migration crisis", përditësuar më 20. 10. 2020, <https://www.europarl.europa.eu/news/en/headlines/society/20170629STO78631/europe-s-migration-crisis> (Data e fundit e aksesimit 20. 12. 2020). 2. Po aty. 3. Ben Anderson-Nathe & Kiaras Gharabaghi, "Trending rightward: Nationalism, xenophobia, and the 2016 politics of fear", *Child & Youth Services*, Vol. 38, No. 1, 2017, f. 3. 4. Shih: *Special Eurobarometer 469, "Integration of Immigrants in the European Union"*, Report, European Commission, 2017, f. 57-60. 5. Mikael Hjerm, "Do Numbers Really Count? Group Threat Theory Revisited", *Journal of Ethnic and Migration Studies*, Vol. 33, No. 8, 2007, f. 1255. 6. "Explaining the main drivers of anti-immigration attitudes in Europe", 30. 11. 2020, <https://www.eyes-on-europe.eu/explaining-the-main-drivers-of-anti-immigration-attitudes-in-europe/> (Data e fundit e aksesimit 05.01.2021). 7. Po aty. 8. Po aty. 9. Po aty. 10. Për konceptin 'Mainstream and Niche Parties' shih: Bonnie M. Meguid, "Competition Between Unequals: The Role of Mainstream Party Strategy in Niche Party Success", *The American Political Science Review*, Vol. 99, No. 3, 2005, f. 347-350. 11. Megë po flasim rreth një shablloni konceptual ndërmjet partive të djathta populiste dhe partive me profil të përgjithshëm politik, në vazhdim do të përdoret shkurtimisht fraza 'partitë e tjera' për të treguar partitë me diskurs të përgjithshëm. 12. Alexandra Cole, "Old Right or New Right? The Ideological Positioning of Parties on the Far Right", *European Journal of Political Research*, Vol. 44, No. 2, 2005, f. 205-209. 13. Aristotile Kallis, "The radical right in contemporary Europe", *SETA*, No. 13, 2014, f. 8-9. 14. Aristotile Kallis, vep. e cit., f. 13-15.

Drita e kulturës islame ka ndriçuar civilizimet botërore

“Derisa në Londër, madje edhe 700 vjet pas nuk mund të gjendet asnjë ndriçuese e vetme e rrugës... Derisa parisianët edhe shekuj më pas binin deri te kyçet e këmbëve nëpër lloç po si ta kalonin pragun e shtëpisë gjatë ditëve kur binte shi, qytetet e Andaluzisë me rrugët e tyre të ndriçuara dhe të pastra arritën shkallën e lartë të zhvillimit.” (John W. Drapers)

Popujt e varfër të Evropës mesjetare, të cilët akoma nuk i kishin të njohura rrjedhat e civilizimit islam, i shpëtuan territ dhe errësirës në të cilat kishin jetuar atëherë kur mbretërit dhe shtetet myslimane (Spanja dhe mbretëria Osmane) e pushtuan një pjesë mjaft të rëndësishme të territorit Evropian. Myslimanët me caktimin e Allahut arritën deri te rezultatet e mëdha në fushën e artit, mjekësisë dhe astronomisë të cilat i bartën nëpër vendet e reja të pushtuara evropiane.

Civilizimi evropian dhe islam janë zhvilluar nën ndikimin e ndërsjellët. Për së pari herë evropianët me civilizimin islam u ndeshën në Gadishullin Iberian, pastaj me rastin e ekspeditave kryqtare, të cilat si cak i kishin zonat islame në Lindjen e Afërt, e më pas edhe përmes pushtimeve osmane të Ballkanit. Pasuria e kulturës islame, si dhe në atë kohë,

zhvillimet e larta teknologjikë, hapën shikime të reja në botë për evropianët mesjetar të cilët kishin pikëpamje shumë të ngushta për botën. Në këtë mënyrë evropianët prej myslimanëve mësuan shumë gjëra nga ndërtimtaria, arti, mjekësia, astronomia dhe matematika.

Zhvillimi i ndërtimtarisë dhe i kulturës

Njëra prej karakteristikave që myslimanëve ua kishte mbjellë ahlakun e mirë islam ishte ndjenja e zhvillimit të lartë për art dhe estetik. Në Kuran jepen përshkrimet që shprehin bukurinë më të madhe të mundur dhe luksin e cila i verbëron sytë. Myslimanët të cilët në zemrat e

tyre kanë mbjellë aso ndjenja për estetik, prapa vetes kanë lënë vepra me vlera dhe kualitet jashtëzakonisht të çmuar, ndërsa shtetet të cilat ata i udhëhoqën u bënë vendet më moderne dhe më prestigjioze në tokë.

Njëra nga qendrat më bujare të botës islame ishte Spanja. Shteti islam i formuar në Spanjën e sotëm, u zhvillua në shtetin më të mirë dhe më modern në Evropë. Në burimet e historisë përmenden arkitektura e shkëlqyer e kryeqyteti të Kordobës, pastaj bibliotekat e saja, ndriçimi dhe rrugët e pastra, spitalet dhe oborret që me bukuritë e tyre thjesht magjepsnin.

Qendrat e mëdha evropiane, sikurse Londra dhe Parisi në atë kohë përshkruhen si vende të ndyra, të errëta dhe të braktisura. Historiani anglez John W. Drapers e përshkruan civilizimin të cilin në Gadishullin Iberik e themeluan myslimanët: “Derisa në Londër madje edhe 700 vjet pas nuk mund të gjendet asnjë e vetme ndriçuese e rrugës... Derisa parisianët edhe shekuj më pas binin deri te kyçet e këmbëve nëpër lloç po si ta kalonin pragun e shtëpisë gjatë ditëve kur binte shi, qytetet e Andaluzisë me rrugët e tyre të ndriçuara dhe të pastra arritën shkallën e lartë të zhvillimit.”

Evropianët me rastin e vizitës së Kordobës mbetnin të habitur pranë shkëlqimit, kulturës dhe artit të cilat i shihnin aty. Do ta japim edhe një përshkrim të krijuar nën përshtypjen e bukurisë dhe luksit të Kordobës:

Kordoba gjatë shekujve IX dhe X ka qenë njëra prej qyteteve më të



mëdha të Evropës dhe sigurisht edhe më tërheqësja. Posedojmë përshkrimet e Kordobës prej njerëzve që asokohe e kishin vizituar atë. Të gjitha këto lulishte, këto rrugë të gjëra, i gjithë ky ndriçim mahnitës, qytete veriore gjendeshin në errësirë. Vetëm në Kordobë kishte ujë të pijshëm. Njerëzit jetonin nëpër shtëpi të mëdha, përderisa në Paris jetohej nëpër kasolle pranë lumenjve.

Njëra prej ndërtimeve të rralla, e cila ka mbetur edhe sot dhe që dëshmon për luksin e dikurshëm të Kordobës, gjithsesi është kisha katolike në qendrën e qytetit. Në të vërtetë ajo është xhamia e cila më vonë u shndërrua në kishë. Enterieri i xhamisë i jep një rafinim shumë të dukshëm estetikës dhe artit. Turistët e krishterë mbetnin të habitur pranë atyre skemave të jashtëzakonshme të cilat kishin pas rast me i pa.

Horotzvitheri, një klerik me prejardhje Saksonë, në shekullin X, Kordobën e përshkruante si “dekorim i botës” dhe qytet i cili tek ai kishte lënë ndikim shumë të madh.

Njëra prej ndërtimeve madhështore të Spanjës islame dhe mirëkuptimit të estetikës është oborri Alhambra (Al-Hamra). Në çdo detaj të saj shihet një ndjenjë e rafinuar për bukurinë, të cilën myslimanët e kanë arritur me moralin islam. Kopshtet përreth Alhambrës janë zbukuruar me kompleksin e burimeve. Përshkrimet e bukurive të xhenetit që i përshkruan Kurani, tërësisht kanë qenë frymëzimi dhe ideja udhëzuese e myslimanëve gjatë ndërtimit të Alhambrës.

Pranë stilit të lartë të ndërtimit, civilizimi islam ishte njëri prej më të përparuarit në botë edhe kur ishte në pyetje mënyra e stilit dhe e veshjes. Myslimanët posedonin punëtorë të tekstilit në të cilat në atë kohë prodhohin kanavacat më të bukura dhe më kualitative. Të krahasohej stili dhe mënyra e veshjes së evropianëve në atë kohë, me ato islame, ishte jashtëzakonisht e pamundur. Për atë arsye, veshja dhe materialet në botën islame në Evropë

Allahu i Madhërishëm, në Librin e Tij, njerëzit i urdhëron që të mendojnë rreth krijimit të qiellit, tokës dhe njeriut. Këtë urdhër të Allahut myslimanët e futën në praktikë që rezultoi me studimet dhe hulumtimet e mëdha, veçanërisht në fushën e matematikës, astronomisë dhe mjekësisë.

u bënë simbol i luksit suprem dhe i statusit të pranuar në shoqëri. Atëherë myslimanët ishin ata që e caktonin modën botërore.

Pranë gjithë kësaj, evropianët prej myslimanëve mësuan përdorimin e banjave dhe të sapunit, trashëgimi kjo që te myslimanët nënkuptohej si themel i principit fetar.

Zhvillimi në fushën shkencore

Është fakt i njohur se myslimanëve ju takojnë meritat për shumë zbulime shkencore gjatë historisë. Edhe para Islamit, arabët dhe popujt e tjerë të Lindjes së Mesme ishin të interesuar për disa çështje sikurse që ishin ato në lidhje me origjinën dhe funksionimin e kozmosit. Për këtë dhe çështje të tjera në mënyrë intensive filluan të mendojnë dhe në mënyrë konkrete të përgjigjen pasi që kishin filluar ta lexojnë Kuranin. Sepse Allahu i Madhërishëm, në Librin e Tij, njerëzit i urdhëron që të

mendojnë rreth krijimit të qiellit, tokës dhe njeriut. Këtë urdhër të Allahut myslimanët e futën në praktikë që rezultoi me studimet dhe hulumtimet e mëdha, veçanërisht në fushën e matematikës, astronomisë dhe mjekësisë. Kështu në civilizimin islam filloi diçka që deri atëherë ishte e paraparë, zhvillimi shkencor në bazat e së cilës vendosej arsyeja dhe vetëdija me të cilat Allahu i Gjithëdijshëm e kishte dhuruar gjininë njerëzore.

Ahlaku islam, i cili propagandon mendimet përparimtare, myslimanët i shtyri që të mësojnë dhe t'i përsosin rrjedhat përparimtare shkencore të civilizimeve të tjera pa kurrfarë paragjykimesh. Drejtori i Institutit të Historisë për Shkencat Arabe-Islame pranë Universiteti “Goethe” në Gjermani, prof. dr. Fuad Sezgin, adresoi çështje shumë të rëndësishme në zhvillimet shkencore të civilizimit islam. Prof. dr. Sezgin në veçanti thekson se themelet e “shkencës moderne” mbështeten te studiuesit myslimanë të cilët kanë jetuar mes shek. IX dhe XVI. Në vazhdim Sezgin thekson se si penda e këtyre njerëzve në Evropë u bë e njohur përmes përkthimeve të punuara në Spanjë dhe Sicili, dhe duke marrë si shembull marinarët modern të Portugalisë, sqaron: “Te marinarët si dituri ekzistojnë dy principe themelore. E para është periudha e gjatë në detin e hapur, kurse tjetra caktimi i pikës në të cilin gjendeni. Myslimanët këto dy principe themelore i kanë ngritur në shek. XV. Kanë bërë matjen e largësisë mes Afrikës dhe të ishullit indonezian Sumatrës dhe kanë gabuar vetëm për 20 apo 30 km. Pranë kësaj myslimanët janë të parët në botë që vizatuan hartën gjeografike e cila tregon gjerësinë dhe largësinë e gjeografisë në shkallë. Sot është provuar se kjo hartë, pranë disa përmirësimeve të imta, është e saktë. Ata madje arritën që ta tërheqin një paralele me ekuatorin që është shumë vështirë. Evropianët mësuan nga myslimanët të gjitha të përmendurat, por pasi që nuk kishin njohuri të mjaftueshme në trigonometri, asesi

nuk mundnin të depërtonin në mënyrën që të vinin deri te rezultatet.”

Pranë këtyre hulumtimeve që civilizimit islam i siguruan përparim, lindën edhe shumë observime, eksperimente dhe llogaritje. Në këtë mënyrë, për shembull, janë numrat e sistemit dhjetë shifror, të cilat sot përdoren, e që janë zhvilluar nga matematikanët myslimanë. Shkencëtarët e botës islame i kanë dhënë rëndësi të madhe edhe observimeve të astronomisë. Astronomia bashkëkohore është themeluar prej principeve të formuara nga ata. Shkencëtarët myslimanë përmes formulave matematikore kanë dëshmuar për sjelljen e Hënës rreth Tokës.

Algjebra dhe trigonometria janë themeluar nga matematikanët myslimanë. Veprat madhështore të arkitekturës islame në tërë botën kah do që kanë sunduar myslimanët, ekzistimin e tyre e kanë duke iu falënderuar kësaj baze të fortë shkencore.

Zhvillimi në fushën e mjekësisë

Zhvillimet shkencore në botën islame, veçanërisht mes shekujve VIII dhe XII, u pasqyruan edhe në shkencën e medicinës. Në Evropë ndikimi i këtij zhvillimi filloi të ndjehej në shekullin IX.

Si shembull, në atë kohë, Evropa i shikonte sëmundjet si një mallkim i drejt. Në fjalorët evropian të asaj kohe nuk gjendej fjala “shërim”. Derisa në anën tjetër shkencëtarët myslimanë, si rezultat të hulumtimeve, pohonin se si sëmundjet barten përmes organizmave të vogla që nuk shihen me sy. Kështu që kishin ardhur në përfundim që të sëmurit t'i mbajnë të izoluar nga njerëzit e shëndosh derisa ata t'i shërojnë. Me këtë rast u formuan spitale të para në botë. Në ato spitale myslimane u formuan edhe reparte të veçanta për sëmundje të ndryshme ku zbatoheshin metodat shkencore të shërimit. Madje edhe



sëmundjet psikike përpiqeshin t'i shëronin me ndihmën e terapisë dhe muzikës. Në Evropë në të njëjtën kohë të sëmurit mental konsideroheshin si shërbëtorë të djajve dhe ashtu të gjallë i digjnin.

Mjekët myslimanë kishin asi suksesi në hulumtimet e anatomisë njerëzore sa që veprat e tyre në Evropë u shfrytëzuan madje gjashtë shekuj si bazë themelore nëpër fakultetet e mjekësisë.

Mjekët myslimanë shekuj me radhë para evropianëve kishin zbuluar qarkullimin e gjakut dhe kanë shëruar sëmundje të caktuara përmes matjes së pulsit. Në atë kohë lindjet bëheshin në mënyrat e shëndosha nga më të mundshmet. Pajisjet të cilat mjekët myslimanë i përdornin për operime në të vërtetë tregojnë se në çfarë shkalle të lartë kishte qenë mjekësia e përparuar te myslimanët në atë kohë.

Pranë kësaj, shkencëtarët myslimanë nënshkruan edhe shumë zbulime të tjera në fushën e optikës. I pari i cili e bëri analizën detale të strukturës së syrit ishte optiku mysliman Ibën al Hajthemi. Studimet e jashtëzakonshme të syve që i bëri optiku i njëjtë, hapën rrugën e cila solli deri te shpikja e kamerës. Mjekët myslimanë, që zbuluan shkaqet e dobësimit të shikimit, përafërsisht 1000 vjet para kolegëve të tyre evropian, bënë operime të suksesshme katarakte. Trashëgimia e

pasur e shkencës islame do të jetë baza më e rëndësishme e ngritjes së shkencës evropiane, duke filluar nga shekulli XV, e cila deri atëherë kishte qenë nën ndikimin e shkencëtarëve myslimanë dhe veprave të tyre. Shkencëtarët e krishterë filluan t'i vendosin themelet për shkencën evropiane me diturit dhe metodat të cilat i kishin mësuar nga myslimanët.

Ndikimet islame në Evropë vazhduan përmes Perandorisë Osmane

Perandoria Osmane, si rrallë ndonjë perandori tjetër në historinë botërore, përfshinte një hapësirë të madhe gjeografike dhe pranë kësaj ajo ishte njëra prej perandorive më të gjata. (Vetëm Perandoria Romake në kulmin e fuqisë së saj përfshinte territor më të madh se ajo Osmane, por ata nuk mundën ta mbajnë aq gjatë sikurse osmanlinjtë). Në historinë e Evropës, Afrikës së Veriut, Azisë së Afërme, Mesopotamisë dhe Arabisë trashëgimia osmane zë një vend të rëndësishëm. Sot shumë qytete të hapësirave të cekura janë të zbuluara me arkitekturën osmane. Në shumë qytete evropiane (si në Sofje, Beograd dhe Sarajevë) edhe sot mund të shihen përmendoret e kulturës osmane.

Organizimi i shtetit osman, që mbështetej në principet e moralit islam, sot nga shumë shkencëtarë të fushës politike vlerësohet si ideale. Gjithashtu konsiderohet se principet e diplomacisë bashkëkohore i kanë rrënjët në diplomacinë e asokohshme osmane.

Disa nga shembujt e ndikimit të osmanlinjve tek evropianët shihet te faktet se osmanlinjtë kishin filluar në Hungari kultivimin e orizit, dhe se vendet e Beneluksit gjatë shekullit XVI përmes ambasadorit Busbek të Habsburgut u njohën me kultivimin e tulipanit dhe që italianët prej osmanlinjve kishin mësuar teknikën e ngjyrosjes së pëlhurave.

Të gjitha këto fakte historike tregojnë se sistemi islam dhe moral duhet marrë rolin udhëheqës në ndërtimin e botës moderne. Nga ai moment kur Muhamedit a.s. i zbriti shpallja, Kurani u bë dritë e qartë e cila njerëzimin e shpiu kah e vërteta, bukuria dhe rruga e drejtë. Derisa Evropa mërmëritej në fanatizëm dhe barbarizëm, civilizimi islam u bë civilizimi më i zhvilluar në botë. Të inspiruar me moralin e Kuranit, myslimanët në çdo pjesë të botës kudo që kishin arrit, e merrnin rolin kryesor në udhëheqjen e fushës shkencore dhe artistike. Historiani Eugen Meyers, për ndikimin osman në Perëndim, shkruan kështu: “Ndikimi i islamit në shkencën dhe kulturën e perëndimit ishte i madh, duke filluar që nga fundi i shekullit

IX e deri në shekullin XII. Assesi nuk bënë të nënçmohet rëndësia e shkencëtarëve dhe përkthyesve myslimanë në zhvillimin e kulturës dhe diturisë së njerëzimit...”

Nuk ka dyshim që ky zhvillim i cili ndodhi në botën islame, e që e përfshiu edhe Evropën, rridhte vetëm nga një burim, Kurani i shenjtë, i cili nxiste në meditim dhe hapje për të shikuar e parë. Kurani është udhëzuesi më i madh i cili njerëzimin që endeshin nëpër errësirë e nxori në dritë. Allahu i Madhërishëm, zotëruesi i botëve, kështu flet në Librin e Tij: “Elif, Lamë, Ra. (ky është) Libër; Ne ta shpallëm ty që me urdhrin e Zotit t’i nxjerrësh njerëzit prej errësirave në dritë; në rrugë të Fuqiplotit, të Falënderuarit. (Ibrahim, 1).

Perfundim

Myslimanët sot duhet të jenë mirë të udhëzuar në rrjedhat e civilizimeve të veta, dhe me atë të mburren, por edhe ta marinë përgjegjësin që janë trashëgimtarë të një civilizimi të tillë. Besimtarët e religjioneve dhe civilizimeve të tjera, shekuj me radhë me admirim dhe varësi i kanë shikuar myslimanët. Eksperti i njohur për Lindjen e Mesme, Daniel Pipes, në një shkrim të tij, pasi që shkruan për vetëbesimin e myslimanëve, ja se çfarë komentimi sjell: “Një prej faktorëve që i ka kontribuar këtij vetëbesimi është edhe kujtimi për sukseset e jashtëzakonshme gjatë VI-të shekujt e parë të Islamit, por edhe më vonë. Në atë kohë, bota islame e kishte kulturën më të përparuar, standardet më të forta shëndetësore, mesatarja e jetëgjatësisë ishte më e madhja, dhe përqindjen më të madhe të shkrim-leximit. Shumica e hulumtimeve teknologjike dhe shkencore zhvilloheshin nën mbikëqyrjen e tyre dhe thënë thjesht ushtria e tyre ishte ajo që sillte fitore. Lakorja e këtyre fitoreve ishte evidente qysh nga koha e fillimeve të veta. Do me thënë, Muhamedi a.s. në vitin 622 u shpërngul nga Meka në Medinë e që pas tetë vjetëve u kthye si fitues në qytetin e vet. Në vitin 715 perandoria

myslimane nga Spanja në perëndim u shtri deri tek India në lindje. Asokohe të ishte mysliman donë të thoshte se i takon civilizimit superior.”

Sot myslimanët duhet ta përjetojnë kënaqësinë e ngjashme si të asaj kohe dhe të jenë udhëheqës në proceset të cilat sërish do ta shndritnin botën me përparimin kulturor dhe civilizues. Më me rëndësi do të ishte që myslimanët, para se çfarëdo qoftë aksioni tjetër, të rreshtohen në një kompaktësi që do të dëshmohej me bashkim dhe unitet. Nëse myslimanët i lënë interesat e veta personale në një anë, nëse në dallueshmëri shikojnë me plot tolerancë, nëse fuqinë dhe energjinë e tyre e harxhojnë vetëm në përhapjen e moralit fetar dhe në të mirë të të gjithë myslimanëve, por edhe tërë gjinisë njerëzore, nëse ndërmjet myslimanëve do të sundojë kultura e kompromisit dhe paqes, bota islame do ta krijonte civilizimin më të madh të shekullit XXI. Duke iu falënderuar paqes dhe tolerancës, vlerave që janë themeli i Islamit, nëpër shumë vende islame do të shfuqizohej regjimi sundues despotik, do të shfaqej zhvillimi kulturor dhe ekonomik, kurse myslimanët që iu kanë ekspozuar dhunës dhe presioneve të ndryshme, përfundimisht do ta arrinin paqen dhe sigurinë. Nën kujdesin e unitetit islam, me lejen e Allahut, shekulli XXI do të shfaqej me Asr-i Saadet, epoka e lumturisë.

Populli turk duhet ta marrë rolin udhëheqës në krijimin e unionit islam e cila do t’i forconte lidhjet vëllazërore dhe dashurinë mes myslimanëve, dhe pranë saj të bëhet promotori kryesor i moralit islam në botë, dhe atë territor të madh që e sundon ta plotësoj me drejtësi dhe paqe, mu ashtu siç diktojnë principet e moralit islam. Për shumë shkaqe, sikur që është roli historik, pozita gjeopolitike, një përvojë të madhe nga e kaluara që e posedon dhe për shumë cilësi tjera pozitive, populli është i obliguar të marrë përsipër zbatimin e këtij lloji misioni.

Marrë nga “Ogledalo”, revistë shkencore publicistike e pavarur, nr. 2005, 8-7 Sarajevë.

Përktheu nga gjuha boshnjake: Shefki Sh. Voca.

Sot myslimanët duhet ta përjetojnë kënaqësinë e ngjashme si të asaj kohe dhe të jenë udhëheqës në proceset të cilat sërish do ta shndritnin botën me përparimin kulturor dhe civilizues.

Jeton Neziri

Mësimi i fikhut në medresetë e Kosovës gjatë periudhës Osmane (1)

Medreseja e parë në trojet shqiptare, në bazë të burimeve, është Medreseja e Is'hak Beut në Shkup, e ndërtuar para vitit 1411. Kjo medrese ka qenë institucioni arsimor më prestigjioz në Ballkan (Rumeli), ku kanë dhënë mësim dijetarë të njohur të kohës, ndër ta ka pasur edhe vendas si, Shuxhaudin Iljazi, Ibnu'l Muidi etj.

Periudha Osmane¹ shënon një kthesë zhvillimore në historinë e edukimit dhe të arsimit shqiptar, në krahasim me periudhat historike të më hershme. Kjo kthesë shihet në cilësinë e kurrikulës që ofronte sistemi edukativo-arsimor osman dhe në përmasat e shtrirjes së institucioneve edukative arsimore në tokat etnike shqiptare.

Burimet kryesore të kësaj kthese kanë qenë qëndrimi i Islamit ndaj edukimit, arsimit dhe shkencës, si dhe organizimi dhe funksionimi i sistemit edukativo-arsimor në shtetin osman. Gjithashtu ndër faktorët e tjerë që ka ndihmuar funksionalizimin

dhe zhvillimin e sistemit edukativ arsimor ndër myslimanët, pjesë e të cilit komunitet është edhe populli shqiptar, në periudhën osmane ka qenë institucioni i vakëfit.² Veprimtaria edukative-arsimore në trojet shqiptare së pari ka filluar të zhvillohet në xhami ose pranë xhamisë, pra qysh nga periudha e parë e krijimit të komunitetit shqiptar mysliman. Andaj historia e arsimit në trojet shqiptare ndërlidhet me historinë e ndërtimit të xhamive të para në këto troje, që ka filluar në vitet e para të vendosjes së pushtetit osman. Sipas të dhënave të shkruara, xhamitë e para në tokat shqiptare

janë ndërtuar në Manastir, nga fundi i shek. XIV dhe fillimi i shek. XV.³

Në shtetin osman sistemi arsimor-edukativ zhvillohej në tri nivele shkollimi. Niveli i ultë realizohej në mejtepe, kurse niveli i mesëm dhe i lartë i arsimit realizohej në medrese. Përveç këtyre shkollave, në qendrën e Perandorisë Osmane, në Stamboll funksiononte edhe mejtepi Enderun.⁴

Niveli i dytë i arsimimit dhe edukimit në shtetin osman ishte medreseja, që ka qenë boshti i arsimit dhe edukimit. Medreseja e parë në shtetin osman është ndërtuar në Iznik në vitin 1331, nga Orhan Gazi,



Gjatë periudhës osmane pothuajse në të gjitha qytetet e Kosovës ka pasur medrese, madje brenda një qyteti janë hapur më shumë se një medrese, siç e kemi rastin me Prishtinën, Prizrenin, Pejën, Gjakovën, etj.

i biri i Osmanit. Ndërsa medreseja e parë në trojet shqiptare, në bazë të burimeve, është Medreseja e Is'hak Beut në Shkup, e ndërtuar para vitit 1411. Kjo medrese ka qenë institucioni arsimor më prestigjioz në Ballkan (Rumeli), ku kanë dhënë mësim dijetarë të njohur të kohës, ndër ta ka pasur edhe vendas si, Shuxhaudin Iljazi, Ibnu'l Muidi etj.

Medresetë e para në Kosovën e sotme janë ndërtuar rreth mesit të shek. XV. Medreseja më e vjetër në Kosovë është ajo e Gazi Ali Beut në Vushtrri, e ndërtuar ndërmjet viteve 1444-1455. Në Pejë kanë funksionuar dy medrese; Medreseja e Vjetër (Medrese-i Atik) e cila bashkë me bibliotekën e saj, imaretin (kuzhinën publike pa pagesë për të varfër dhe mysafirë), teqenë etj., është ndërtuar nga Mehmet Beu para vitit 1516, ndërsa Medresja e Re (Medrese-i cedid) dhe mejtepi janë ndërtuar nga Kahraman Pasha, i biri i Ibrahim Pashë Begollit, pasi që rinovoi xhaminë e Sinan Agës (Xhamia e Kuqe), në vitin 1759. Medreseja e Mehmet Pashës në Prizren është ndërtuar nga Gazi Mehmed Pasha në vitin 1537, e cila ka qenë njëra ndër institucionet edukative arsimore më prestigjioze në trojet shqiptare. Medreseja e Besharet Begut në Prishtinë është ndërtuar

nga Besharet Begu para vitit 1566.

Në bazë të sallnameve të Vilajetit të Kosovës dhe të Sallnames së Arsimit të vitit 1900, në Prishtinë ka funksionuar Medreseja e Sulltan Selimit e cila është ndërtuar nga Sulltan Selimi III ndërmjet viteve 1879-1883 dhe Medreseja e Pirinazit, e cila është hapur me kontributin e popullatës vendase pas vitit 1885; në Prizren në vitin 1900 ka funksionuar Medreseja Mehmet Pasha, Medreseja Sinan Pasha, Medreseja Saraçhane dhe Medreseja e Lagjes Terzi; në Gjakovë në vitin 1893 kanë funksionuar dy medrese që kanë pasur gjithsej 47 talebe; në Pejë ka funksionuar Medreseja Bollazade e cila kishte 16 talebe dhe Medreseja Osman Çavush që kishte 25 talebe; në Gjilan në vitin 1900 ka funksionuar Medreseja e Xhamisë Atik dhe Medreseja e Dobërçanit, në të cilat myderriz kanë qenë Adem efendiu, Selim efendiu dhe Halid efendiu nga Dobërçani; në Vushtrri nga viti në vit ka ndryshuar numri i medreseve, ndërsa ndërmjet viteve 1896-1900 kanë funksionuar dy medrese të cilat kanë pasur 42 talebe, dhe në Mitrovicë ndërmjet viteve 1893-1900 ka funksionuar

Në medresetë e Kosovës janë mësuar ato lëndë që janë mësuar edhe në medresetë e tjera në Perandorinë Osmane. Në medresetë e Kosovës jepnin mësim myderrizët e arsimuar në qendra të ndryshme të arsimit dhe kulturës islame.

Medreseja Gazi Isa Bej, e cila ka pasur 32 talebe.⁵ Pra, siç po shihet, gjatë periudhës osmane pothuajse në të gjitha qytetet e Kosovës ka pasur medrese, madje brenda një qyteti janë hapur më shumë se një medrese, siç e kemi rastin me Prishtinën, Prizrenin, Pejën, Gjakovën, etj. Kjo tregon nivelin e arsimit dhe edukimit të shqiptarëve myslimanë, i cili ka qenë i kënaqshëm për rrethanat e atëhershme, sidomos në shekullin XVIII. Krejt kjo është arritur falë kontributit të fisnikërisë shqiptare për ndërtimin e institucioneve edukative arsimore e kulturore.

Hapja e këtyre medreseve ndikoi edhe në përgatitjen dhe nxjerrjen e kuadrove dhe intelektualëve të shumtë, të cilët me sukseset e tyre arritën që të shërbejnë edhe në institucionet më të larta të shtetit osman.

Plan-programi mësimor në medresetë e Kosovës

Në sistemin e medreseve osmane, mësimi nuk është zhvilluar brenda një programi mësimor të caktuar, domethënë nuk kishte një kurrikulë që mund të ndiqej. Plan-programet përcaktoheshin drejtpërdrejt nga myderrizët. Myderrizët, në cilëndo lami në të cilën ishin të specializuar, në atë lami e merrnin për bazë librin më të njohur për t'ia mësuar studentëve dhe ata studentë që ishin të suksesshëm, atyre u jepnin ixhazetname.⁶

Në medresetë e Kosovës janë mësuar ato lëndë që janë mësuar edhe në medresetë e tjera në Perandorinë Osmane. Në medresetë e Kosovës jepnin mësim myderrizët e arsimuar në qendra të ndryshme të arsimit dhe kulturës islame. Shumë studentë nga Kosova që kryenin medresenë shkollimin e vazhdonin edhe në qendra të tjera, si në Stamboll, Kajro etj.⁷

Medresetë në Kosovë, ashtu si në vendet e tjera të Perandorisë Osmane, nuk kanë qenë të nivelit të njëjtë. Disa kanë qenë të nivelit më të mirë, e disa të nivelit më të dobët. Disa prej tyre, si Medreseja e Mehmet Pashës në Prizren dhe Medreseja e Madhe në Gjakovë etj., me myderrizët që kishin dhe me lëndët të cilat mësoheshin në to, krahasoheshin me Medresetë Fatih të Stambollit që kanë qenë të rangut ma të lartë.⁸ Një pasqyre të përgjithshme të lëndëve që janë mësuar në medresetë e Kosovës mund të nxirret duke u bazuar në biografitë e ulemave dhe të myderrizëve, në diplomat e tyre (ixhâzetnâmetë), vakëfnametë etj. Në bazë të shahadetnamesë së Fahri Iljas efendiut, në Medresenë “Mehmet Pasha” në Prizren janë mësuar këto lëndë:⁹ Kurani Kerimi, Texhvidi, Fikhu, Usuli fikh, Ilmi Kelâm, Shkencat natyrore-fizikë (Hikmeti Tabi’iyye), Teologji (Hikmeti ilâhiyye), Logjika (mantiku), Tefsiri, Hadithi, E drejta trashëgimore, Matematika, Histori e profetëve (Tarih-i enbiya), Metafora (Ilmi beyan), Retorik (Ilmi bedî’), Kaligrafi (Hüsn-i hatt), Bukurshkrim (Imla), Gramatika (Ilmi sarf), Sintaksa (Ilmi nahv).

Mësimi i shkencës së fikhut në medresetë e Kosovës

Qëllimi kryesor i themelimit të medreseve ka qenë mësimi i shkencës së fikhut. Në medrese, përveç lëndës së fikhut janë mësuar edhe shkencat të tjera islame dhe shoqërore që i kemi cekur më lartë, si Kurani, Tefsiri, Hadithi, Kelami, Ahlaku, Logjika (Mantiku), Mjekësia, Filozofia, Gjuhësia, Gramatika (Ilmi sarf), Sintaksa (Ilmi nahv), Matematika, etj.¹⁰ Ekzistojnë informacione të sigurta se në të gjithat medresetë osmane, pjesë e të



cilave kanë qenë edhe medresetë në trojet etnike shqiptare, është mësuar shkenca e fikhut.

Me “Rregulloren për Reformimin e Medreseve” të datës 1 tetor 1914, të gjitha medresetë osmane u numëruan si një medrese e vetme dhe u quajtën “Medreseja e Qendrës së Hilafetit” (Dârü'l-hilâfeti'l-aliyye Medresesi). Në bazë të kësaj rregulloreje, mësimi në medresetë do të përbëhej prej tri fazave, ku secila prej të tyre do të zgjaste katër vjet. Faza e parë quhej faza e parë e arsimit të kategorisë së dytë (Tâli Kısım-ı Evvel), faza e dytë quhej faza e dytë e arsimit të kategorisë së dytë (Tâli Kısım-ı Sâni) dhe faza e tretë quhej faza e arsimit të lartë (Kısım-ı Âli). Në vitin e tretë dhe të katër të fazës së parë të arsimit të kategorisë së dytë mësohej lënda e fikhut, në dy vitet e para të fazës së dytë të arsimit të kategorisë së dytë mësohej lënda e fikuht, kurse në dy

vitet e fundit mësohej edhe lënda e fikhut edhe lënda e usuli fikhut, ndërsa në fazën e arsimit të lartë gjatë katër viteve mësohej lënda e fikhut dhe usuli fikhut.¹¹

1. Ky punim është përmbledhje e temës së diplomës që e kam përgatitur në FSI. 2. Nehat Krasniqi, “Medresetë në Kosovë nga fillimi deri në rrënimin e pashallëqeve shqiptare”, Medreseja “Alaudin” e Prishtinës: 65 vjet në shërbim të arsimit fetar dhe kombëtar, Prishtinë, 2018, fq. 31. 3. Po aty, 4. Po aty, fq. 32. 5. Nefize Güler, Salnamelere Göre Kosova Vilayetinde Eğitim-Öğretim, (Temë Masleri), Bursa Uludağ Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü İslam Tarihi ve Sanatları Anabilim Dalı İslam Tarihi Bilim Dalı, Bursa, 2019, fq. 47, 127-128, 158, 156, 57-58, 50, 52. 6. İsmail Hakkı Uzunçarşılı, Osmanlı Devleti'nin İlmiye Teşkilatı, Ankara, 1965, fq. 75-77. 7. Mehmeti, Shkollat dhe arsini në Kosovë....., fq. 244. 8. Po aty, fq. 244-245. 9. Po aty, fq. 278. 10. Mustafa Şanal, “Osmanlı Devleti'nde Medreselerde Ders Programları, Öğretim Metodu, Ölçme Ve Değerlendirme, Öğretimde İhtisaslaşma Bakımından Genel Bir Bakış”, Erciyes Üniversitesi Sosyal Bilimler Enstitüsü Dergisi, S. 14 (2003), s. 150-151. 11. Mübahat S. Kütükoğlu, “Dârü'l-hilâfeti'l-aliyye Medresesi”, Türkiye Diyanet Vakfı İslam Ansiklopedisi (DİA), İstanbul: Türkiye Diyanet Vakfı İslam Araştırmaları Merkezi (ISAM), 1993, C. 8, s. 508-507; Çelik, po aty, fq. 736.

Klodiana Xhaferaj

Historia e gjuhës arabe në Egjipt

Përhapja e gjuhës arabe në fillimet e saj në Egjipt eci shumë ngadalë, për shkak se myslimanët që vajtën atje, nuk i detyruan vendasit ta përqafonin Islamin dhe as të flisnin gjuhën e tyre arabe.

Prezenca e gjuhës arabe në Egjipt, daton qysh para ardhjes së Islamit në këto treva, madje edhe para ardhjes së krishterimit. Shkaqet e prezencës së gjuhës arabe janë të lidhura me:

1. Tregtinë – e cila është pika ku takohen dy popujt, ai i gadishullit arabik si dhe ai i atij egjiptian. Që në kohërat e vjetra ekzistonte një lidhje tregtare ndërmjet këtyre dy trevave, ku qyteti i Gazës shërbente si një pikë lidhje, shkëmbimesh tregtare, për shkak se kishte një ndër portet më të rëndësishme të rajonit.

2. Emigrimi i fiseve – historia ka shënuar emigrime të shumta të fiseve arabe të Gadishullit Arabik drejt tokave të Egjiptit, në verilindje apo në El-Kusejr (shtrihet në brigjet e Detit të Kuq) etj., zona në të cilat u përqendruan fiset e

ardhura, gjë e cila solli ndikimin e gjuhës arabe në gjuhën vendase (kopte). Kjo ndodhi me anë të futjes së fjalëve të ndryshme në leksikun e gjuhës vendase si dhe anasjelltas. Me kalimin e kohës, kjo solli përafrim të gjuhëve, detaj të cilin e vuri në dukje edhe dijetari Sujuti në shënimet e tij.

Kjo është shkurtimisht prezenca e gjuhës arabe në Egjipt para Islamit. Por, si është prezenca e saj pasi që Islami filloi të hyjë, të depërtojë në këtë vend?

Këtu kemi fillimin e një përplasjeje gjuhësore ndërmjet dy gjuhëve, e cila vinte për shkaqe të ndryshme, si ato politike, fetare, tregtare etj., të cilat u gërshetuan ndërmjet vete dhe luajtën një rol të rëndësishëm në favor të gjuhës arabe. Faktorët politikë dhe tregtarë patën një ndikim qartazi të

dukshëm. Ne mësojmë përpjekjen që luajtën brezat e parë, myslimanët e parë, për ta arabizuar jetën islame ngado që shkonin, apo edhe për ta arabizuar vendin ku shkonin:

1. Duke zënë arabishtja vendin e gjuhës kopte në të gjitha shkrimet zyrtare dhe divanet që organizoheshin;

2. Emigrimi i shumë prej fiseve arabe, të cilat përfundimisht zinin vende në këto zona;

3. Duke i emëruar arabët në poste në ndryshme, në vend të koptëve;

4. Vendosja e xhizjes për koptët.

Faktori fetar ka ndikim të qartë dhe me rëndësi nga ana gjuhësore, duke qenë kështu përhapja e arabishtes e lidhur me zonat ku vendosej feja islame. Ishte e dukshme që në zonat ku ende nuk ishte vendosur Islami, gjuha kopte



luante rolin kyç, dominues, të gjallë e të fortë. Por, ndërkohë që përqafonin Islamin, ata menjëherë i hynin mësimi të arabishtes. Faktorët e tjerë që ndikuan në përhapjen e arabishtes ishin edhe:

1. Përhapja e gjuhës arabe në shumë rajone të tjera, duke përfaqësues kulturën dhe qytetërimin në lindje dhe perëndim të saj;

2. Lëvizja e përkthimit të dijes në gjuhën kopte.

Rrallë mund të gjeje ndonjë material të veçantë për ta përkthyer prej një gjuhe drejt asaj kopte. Po ashtu, nuk ekzistonte ndonjë aktivitet i përkthimit të literaturës kopte në atë arabe (me përjashtime shumë të rralla).

Përhapja e gjuhës arabe në fillimet e saj në Egjipt eci shumë ngadalë, për shkak se myslimanët e parë që vajtën atje, nuk i detyruan vendasit ta përqafonin Islamin dhe as të flisnin gjuhën e tyre arabe. Gjithashtu, pasi që Egjipti ra në duart e myslimanëve, koptët zunë vendin e rumëve në administratën qendrore dhe në atë lokale. Për këtë, kemi një barazi (nëse mund të themi) të të dy gjuhëve, derisa në vitin 88 hixhri, për Egjiptin caktohet vali, Abdullah ibën Abdulmelik ibën Mervani, i cili e bëri gjuhën arabe si gjuhë zyrtare, në vend të asaj kopte.

Faktor tjetër i cili ndikoi në mos përhapjen e menjëhershme të gjuhës arabe, ishte edhe numri i paktë i myslimanëve, krahasuar me atë vendase, kopte, si dhe vendosja e myslimanëve të cilët vinin në kryeqytetin e re islamik të themeluar prej Amër ibën el-Asit, në një hapësirë larg nga zonat ku banonin krisianët.

Por, pasi që mbaroi shekulli i parë hixhri, kemi edhe një lëvizje për arabizimin dhe zëvendësimin e koptëve me arabë, në pozicionet e ndryshme qeverisëse, në të gjitha nivelet. Kjo i shtyri shumë prej koptëve që të nxitonin në mësimin e gjuhës arabe, për t'i ruajtur

Pas vendosjes së gjuhës arabe si gjuhë zyrtare, kemi edhe një lëvizje e cila çoi drejt një zhvillimi të gjuhës arabe në të gjitha fushat e dijes dhe të kulturës, si në lexim Kurani, shkrimin e librave, hadith, letërsi, studime gjuhësore etj.

pozicionet e tyre të punës ose t'u hapeshin shanse të reja punësimi.

Në të njëjtën kohë, në shekullin e dytë hixhri, shtohen prurjen e fiseve të tjera arabe prej Gadishullit Arabik. Sipas dokumenteve, flitet se janë rreth 30 fise arabe, të cilat u shpërngulën prej gadishullit drejt Egjiptit.

Pas vendosjes së gjuhës arabe si gjuhë zyrtare, kemi edhe një lëvizje e cila çoi drejt një zhvillimi të gjuhës arabe në të gjitha fushat e dijes dhe të kulturës, si në lexim Kurani, shkrimin e librave, hadith, letërsi, studime gjuhësore etj.

Kemi aktivizimin e sahabëve për të hedhur bazat e diturisë islame në



gjuhën arabe, të cilët erdhën së bashku me ushtrinë çliruese në Egjipt ose pak më mbra, qysh në kohën e Amër ibën el-Asit, siç janë Ebu Hurejre, Abdullah ibën Abasi, i cili ndikoi në fushën e hadithit, Abdullah ibën Amër, në fushën e leximit të Kuranit, zyrtarisht i pari ka ardhur sabahiu Ubejd ibën Omeri, Ebu Dher el-Gafari, Sad ibën ebi Vekasi, Abdullah ibën Amru ibën el-Asi, e të tjerë sahabi (Allahu qoftë i kënaqur me të gjithë!). Këta hodhën bazat e themelimit të shtetit të parë islam në të gjitha fushat. Sa u përket studimeve gjuhësore, ato filluan në fund të shekullit të tretë dhe në fillim të shekullit të katërt.

Përhapja e gjuhës, kulturës dhe dijes arabe u krye në qendrat e shumta të cilat ishin të përhapura kudo që ishin përhapur myslimanët, si dhe ishin prej formave të ndryshme, si:

1. Xhamitë, të cilat ishin qendrat e para që luajtën këtë rol. Ndër xhamitë më të rëndësishme ishin xhamia e Amër ibën el-Asit, xhamia e Ahmed ibën Tulunit, Az'hari etj.

2. Sallonet, ku qeveritarët dhe drejtuesit e ndryshëm organizonin sallone diturie në vilat e tyre. Këto dituri ishin të fushave të ndryshme, jo vetëm fetare, por edhe shkencore.

3. Roli i librave, ishte kaq i rëndësishëm sa që u caktua Ibën Halikani si drejtues për ta menaxhuar këtë fushë në kohën e tij. ai njihet si i pari që e pati këtë post.

4. Vendet e shitjes së letrave dhe të librave. Pavarësisht se ishin vende ku shiteshin letra e libra, ato shikoheshin si klube, ku studiuesit dhe studentët përdornin si vende ku diskutohej për çështje të ndryshme.

Të gjithë këta faktorë, si dhe të tjerë të cilët nuk janë përmendur, kanë luajtur rol të rëndësishëm për arritjen e përhapjes dhe bërjes zyrtare të gjuhës arabe në të gjithë Egjiptin, duke e zëvendësuar atë ekzistuese, gjuhën kopte.

M.sc. Artan S. Mehmeti

Kontributi i Tusit (1201 – 1274) në gjeografi

Ebu Xhafar Muhamed ibën Muhamed ibën el Hassan Nasiruddin Et-Tusi, lindi në rajonin persian të quajtur Khurusan, përkatësisht në qytetin Tus. Në këtë kohë ky rajon i takonte Iranit. Ai njihet si një nga shkencëtarët, matematicienët, astronomët, filozofet, teologët dhe fizikanët më të mëdhenj të kohës së tij, i cili po ashtu me studimet e tij dha një kontribut jashtëzakonisht të madh në gjeografi.

Et Tusi u rrëmbye nga agjentët e Isma'ili Hasan bin Sabahut dhe u dërgua në Alamut, ku qëndroi deri në kapjen e tij prej sundimtarit mongolit Ilkanid Halagu Kan në vitin 1256. Halagu Kan besonte se shumë nga sukseset e tij ushtarake janë të lidhura drejtpërdrejt nga këshillat që ai i kishte marrë nga astronomët të cilët gjithashtu ishin astrologë. I befasuar nga aftësitë e veçanta dhe kompetencat që i dispononte Et Tusi në fushën e astrologjisë, Ilkanid Halagu Kan e caktoi Et Tusin si një nga ministrat e tij. Më vonë Et Tusi shërbeu si administrator i Aukaftit.

Në vitin 1262, Et Tusi ndërtoi një observatorium në qytetin Meraga. Ai po ashtu ishte edhe udhëheqës i aktiviteteve shkencore që zhvilloheshin në këtë observatorium. Ky observatorium ishte i pajisur me pajisjet më të mira të sjella prej Bagdadit, si dhe prej disa qendrave të tjera islame të njohura për përhapjen e diturisë. Ky observatorium mes të tjerash përmbante një mur 10 këmbë të lartë, i cili ishte bërë prej bakri, dhe një azimuth në formë katrore, të krijuara prej vetë Et Tusit. Për këtë observator, ai ndërtoi edhe disa instrumente tjera që do t'i shërbenin për vëzhgimet e tij dhe ekipit të tij. Po ashtu, në këtë observator ndodheshin edhe disa instrumente të tjera siç ishin: astrolabët, prezantimet



Et Tusi në pullë postare të Iranit

e sistemit të yjeve dhe forma sferash. Në këtë observator së bashku me Et Tusin, punuan edhe një numër i madh astronomësh të njohur të kohës duke përfshirë Muhji el Din el Maghribi, Kutb el Din el Shirazi, Muejeddin el Urdu nga Damasku, si dhe astronomi kinez Hulago Fao Munji. Njohurit kineze të cilat Et Tusi i kishte fituar, i ndihmuan atij që të bëjë përmirësime në sistemin e Ptolomeut. Ajo që vihet re në këtë observator që është shumë i rëndësishëm nga këndvështrimi historisë së gjeografisë matematikore, është se dy astronomët e mëdhenj Et Tusi nga pjesa lindore e botës islame dhe El Magribi nga pjesa perëndimore

**“El-Zixh Ilkani”
përmban tabela
shumë të sakta të
lëvizjeve
planetare, një
katalog që
përmbante
emërtime yjesh
dhe modelin e tij
për sistemin
planetarë**

e botës islame, duke bashkëpunuar ngushtë me njëri-tjetrin, kanë arritur me sukses të bashkojnë në një të tërë shkallët e gjerësisë gjeografike të lindjes, të cilat u përllogaritën duke u nisur nga meridiani zero që kalon nga Bagdadi si dhe shkallët gjeografike të perëndimit që u përllogaritën, duke u nisur nga meridiani zero i spostuar më 280 30' në perëndim të Toledos.


Hulumtimet të cilat i kreu së bashku me ekipin e tij të astronomëve në observatorin Maragha, Et Tusi i publikoi në një libër me titull “El-Zixh Ilkani”. Libri në fillim është shkruar në gjuhën perse dhe më vonë është përkthyer edhe në gjuhën arabe. Gjurmët e sistemit kinez mund të shihen në këtë libër. Nga

vetë emërtimi i librit, kuptojmë se libri i është kushtuar sundimtarit mongol Ilkanid Halagu Kan.

“El-Zixh Ilkani” përmban tabela shumë të sakta të lëvizjeve planetare, një katalog që përmbante emërtime yjesh dhe modelin e tij për sistemin planetarë. Tabelat ishin ndërtuar duke u bazuar në vërtetimet e bëra prej një periudhe kohore për më se 12 vjetësh. Në këtë libër, Et Tusi llogariti vlerën për precesionin vjetor të ekuinokseve në $51'$, që është shumë afër vlerave moderne prej $50'$ e 2 sekonda, si dhe kontribuoi në ndërtimin dhe përdorimin e disa instrumenteve astronomike, përfshirë theastrolabin. Libri po ashtu përshkruan një metodë interpolimi midis pozicioneve të vëzhguara, të cilat në terma moderne mund të përshkruhen si një skemë e interpolimit të rendit të dytë. Në këtë punim janë regjistruar jo vetëm rezultatet e vëzhgimit që njiheshin në atë kohë, por në të njëjtë kohë edhe shkallët e korrigjuara të gjatësisë dhe gjerësisë gjeografike përreth Meragës. “El-Zixh Ilkani” ishte libri më i famshëm midis astronomëve deri në shekullin e XV-të.

Në librin kryesor astronomik të titulluar “El-Tedhkire fi’ilm el-Hej’e”, Et Tusi përfshin projektin e tij gjenial për gjenerimin rektilinear përgjatë diametrit të rrethit të jashtëm prej dy lëvizjeve rrethore. Për esencën e vërtetë të Rugës së Qumështit, Et Tusi në këtë libër shkruan: “Ruga e Qumështit, gjegjësisht galaktika, përbëhet nga një numër shumë i vogël yjesh të forta dhe të grumbulluara, të cilat, për shkak të përqendrimit dhe numrit të vogël të tyre, duket se ka njolla të turbullta, për shkak të kësaj, u krahasua me qumështin me ngjyrë.” Tre shekuj më vonë, prova e Rugës së Qumështit që përbëhej nga shumë yje erdhi në vitin 1610, kur Galileo Galilei përdori një teleskop për të studiuar Rugën e Qumështit dhe zbuloi se ajo është me të vërtetë e përbërë nga një numër i madh yjesh të zbehta.

Et Tusi ishte në mesin e astronomëve të parë mysliman që i dalluan disa të meta në modelin e Ptolemeut bazuar në principet mekanike, duke i përmirësuar këto të meta. Në “El-Tedhkire fi’ilm el-Hej’e”, ai kritikoi përdorimin e provave vëzhguese të Ptolemeut për të



Një Traktat mbi Astrolabin nga Tusi, Isfahan 1505

treguar se Toka ishte në pushim, duke vënë në dukje se provat e tilla nuk ishin vendimtare. Në këtë libër, ai shpiku një model të ri të lëvizjes hënore, para se gjithash e ndryshme nga Ptolemeu. Duke shfuqizuar ekscentrikun dhe qendrën e prognozës (prosneusis), Et Tusi e themeloi atë ekskluzivisht në parimin e tetë sferave rrotulluese në mënyrë të njëtrajtshme, dhe në këtë mënyrë arriti të shfaq parregullsitë e lëvizjes hënore me të njëjtën saktësi si “Almagest”. Pretendimi i tij se diferenca maksimale në gjatësi midis dy teorive arrin në 10 rezulton të jetë plotësisht e vërtetë.

Në modelin e tij, Et Tusi, për herë të parë në historinë e astronomisë, përdori një teoremë të shpikur nga ai vetë, e cila teoremë rreth 250 vjet më vonë, është përsëri prezentë në librin e Kopernikut të titulluar “De Revolutionibus”

Për të formuar nga e para parimin e lëvizjeve të barabarta rrethore që u dëmtua me futjen e “punctum Aequans-it” (rrethe që kufizojnë trajektorët dhe që qendrat e tyre konsiderohen të ndara nga ato të Tokës dhe të barabarta me trajektorët e tyre) nga ana e Ptolemeut në modelin e vet mbi planetë. Në modelin e vet, ai duke e ruajtur pikën e qendrës së modelit aequans, gjatësinë eksantrike (diferenca e gjatësisë që mendohet se ekziston midis qendrës së Tokës dhe qendrave të trajektorëve të planetëve) që paraqet pikën e përbashkët të trajektorës së planetëve (referentit), e lë të barabartë me diametrin e epiciklit. Epiciklet e planetëve, pikat e përbashkëta të të cilave lëvizin mbi deferent nga lindja në perëndim, kanë po ashtu pika të përbashkëta që përshkojnë (drejt lindjes) të njëjtat distanca njëkohësisht. Këtë keqfunksionim të shfaqur në modelin e Ptolemeut, që është dhe shkaku i njëtrajtshmërisë së lëvizjeve, Et Tusi e eliminon më anë të epicikleve dyshe. Në këtë model, një rreth i vogël (rrezja e tij përputhet me gjysmën e rrezes së rrethit të madh dhe në këtë mënyrë ajo përputhet me gjysmën e gjatësisë eksantrike), brenda një rrethi të madh (pra midis vizës së rrethit dhe pikës së mesit të rrethit të madh), lëviz në drejtim të kundërt nga përendimi në lindje. Et Tusi e ka konceptuar vetë këtë model duke u bazuar në teoremën ndihmëse që

ai ka përmendur në këtë mënyrë: “kur brenda një rrethi, rrotullohet një rreth tjetër më i vogël, nëse rrezja e rrethit të madh është sa dyfishi i rrezes së vogël, gjatë rrotullimit çdo pikë e rrethit të vogël përcakton diametrin e rrethit të madh.” Teorema e përmendur në këtë citat ka të bëjë me teknikën e famshme gjeometrike të quajtur “Çifti Tusi” (Tusi-couple), i cili gjeneron lëvizjet lineare nga shuma e dy mocioneve rrethore. Qëllimi i Et Tusit me këtë rezultat ishte që të hiqeshin të gjitha pjesët e “Sistemit të Ptolemeut” që nuk ishin të bazuara në parimin e lëvizjes së njëtrajtshme rrethore, por nuk ishte në gjendje të gjejë një zgjidhje për Merkurin, e cila u zgjidh më vonë nga Ibën el Shatir si dhe Ali Kushji. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se Et Tusi ishte një mbështetës i lëvizjes së tokës, ashtu si ai, edhe komentatori i shekullit të XVI-të, El Bixhrandi, pohuan se paqëndrueshmëria e tokës mund të demonstrohej vetëm me parimet fizike të gjetura në filozofinë natyrore. Kritikën e Et Tusit për Ptolemeun ishin të ngjashme me argumentet e përdorura më vonë nga Koperniku (Nikolaus Kopernikut) në vitin 1543, për të mbrojtur teorinë e rrotullimit të Tokës.

Në modelin e tij, Et Tusi, për herë të parë në historinë e astronomisë, përdori një teoremë të shpikur nga ai vetë, e cila teoremë rreth 250 vjet më vonë, është përsëri prezentë në librin e Kopernikut të titulluar “De Revolutionibus”, III. Përpos Kopernikut, ky sugjerim më pas rishfaqet edhe te Ludoviko Ferrari dhe të Phiiippe de La Hire.

Modeli i tij për sistemin planetar i cili bazohet në teknikën “Çifti Tusi”, besohet të jetë më i avancuari i kohës së tij dhe u përdor shumë deri në zhvillimin e modelit heliocentrik të Kopernikut. Nëse bëjmë një krahasim të Ptolemeut, Kopernikut dhe të Et Tusit, Et Tusi konsiderohet nga shumë studiues si një nga astronomët më të shquar të kohës së tij. Studenti i tij i famshëm Shamsadin el Bukhari ishte mësuesi i dijetarit bizantin Gregory Chioniadis, i cili e kishte trajnuar astronomin Manuel Bryennios rreth vitit 1300 në Kostandinopojë. “Çifti Tusi” më vonë u përdor në modelin gjeocentrik të Ibën el

Shatirit dhe në modelin heliocentrik të Kopernikut. Kritika e tij për teoritë e Ptolemeut, i bindi astronomët e ardhshëm për nevojën e zhvillimit të një modeli tjetër që mbaroi në veprën e famshme të Kopernikut.

Shumë historianë pretendojnë se rezultati i “Çiftit Tusi”, ishte përdorur nga Koperniku, pasi ai e zbuloi atë në punën e Et Tusit, por jo të gjithë pajtohen. Këta historianë që nuk pajtohen, bazohen në argumentin se Koperniku mori rezultatin nga Komentari i Proklusit në librin e parë të Euklidit dhe jo nga Et Tusi.

Et Tusi ka kontribuar edhe në përcaktimin e një vlere të përmirësuar, për të matur në mënyrë të saktë pikën e barazisë së natës dhe të ditës që përparon në orbitën e planetëve. Ndërsa, kjo vlerë përparimi te Ptolomeu dhe te Hipparchosi është 10 në 100 vjet apo 36” në vit, sipas Et Tusit është 10 në çdo 100 vjet ose 55” në vit; këtu vihet re se, që në atë periudhë ky zbulim ishte afruar shumë vlerës 10 në 72 vjet, e cila pranohet si e vlefshme në epokën moderne.

Në një dorëshkrim që sot nuk ekziston i veprës së Et Tusit me titull “Tedhkire fi el-Hej’e”, ka mundësi që ajo të jetë kopje e autorit që përfshinte një hartë bote. Kopja e realizuar nga Joseph Nedham duke u bazuar në origjinalin e saj, e cila u botua në vitin 1959, pavarësisht se është krijuar në mënyrë jo serioze, na paraqet një nivel të përparuar për përshkrimin bazë të Tokës së banuar dhe të rrethuar nga oqeani, shumë më tepër se gjeografët e El Mem’unit dhe hartat e botës së El Idrisit.

Sipas një informacioni që paraqitet në një libër historie, i shfaqur gjatë periudhës nga shekulli XIII-të e deri në shekullin XIV-të dhe që nuk është marrë në konsideratë deri më tani në historinë e hartografisë, në vitin 1265 në Observatorin e Bagdadit, nën drejtimin e Et Tusit, është ndërtuar një hartë bote mbi një sferë e prodhuar nga burimi i një letre të veçantë. Në këtë hartë ndarja klimatike paraqitet vetëm për hemisferën veriore, pjesa më jugore e Kontinentit Afrikan është e kthyer nga lindja dhe jo nga jugu siç është në të vërtetë dhe Gadishulli i Indisë është shumë pak i

dallueshëm duke mos u paraqitur me karakteristikat e tij. Ashtu si hartat e tjera arabe-myslimane edhe harta e Et Tusit paraqet pjesën e traditës hartografike myslimane me paraqitjen e qytetit të shenjtë të Mekës në qendër të hartës dhe jo qytetet e tjera p.sh. Jerusalemi, Mt. Meru, etj., siç ishte bërë në hartografinë e civilizimeve të tjera.

“El-Risalah el-Asturlabijah”, është një libër tjetër i punuar nga Et Tusi, që flet rreth instrumentit astronomik të quajtur astrolabe.

Et Tusi, veprat e tij i ka shkruar në gjuhën arabe persiane. Sipas studiuesit Xhorxh Sarton, rreth 64 vepra të Et Tusit kanë mbijetuar deri në këtë kohë. Në kohën e mesjetës, këto vepra u përkthyen në disa gjuhë latine, si dhe në disa gjuhë evropiane. Disa nga studentët e njohur të Et Tusit janë Nizam el Araj, Kutbeddin esh Shirazi. Kontributet e Et Tusit u vlerësuan për shumë shekuj me radhë.

Burimet Prof. dr. Fuat Sezgin, Epoka e madhe e panjohur: Nga historia e shkencës dhe e teknologjisë islame, përktheu nga turqishtja: Altin Qefalio, Logos-A, Shkup 2015, Halima Al-Ghrari, Arkitektët E Mendimit Shkencor Në Qytetërimin Islam. Vula nga biografi e dijetarëve mysliamë në periudha të ndryshme, Nga arabishtja në anglisht e përktheu: Abdulaziz Hauaria, Përktheu nga gjuha angleze: Ermal BEGA, Botoi: Qendra Shqiptare për Studime Orientale – A.C.F.O.S. BOOKS, (botimi i dytë) Tiranë 2020, Xhorxh Sarton, Historia e Shkencës Islame, Përktheu, plotësoi me shtojcë dhe përgatiti për botim: Ermal Bega, Botoi: Qendra Shqiptare për Studime Orientale – A.C.F.O.S. BOOKS, (botimi i dytë) Tiranë 2020, Kontributet muslimane në qytetërimin botëror, përgatitën për botim: M. Basheer Ahmed, Md; Ambassador Syed A. Ahsani; Dilnawaz A. Siddiqui, Phd, përktheu: Festime Mehdiu Gashi, Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimin Islam (AIITC), Tiranë 2019, Sami Frashëri, Qytetërimi Islam, Logos-A, Shkup 2009, Dr W. Hazmy C.H. Dr Zainurashid Z. Dr Hussaini R., Biography Muslim Scholars and Scientists, Published by: Islamic Medical Association of Malaysia N. Sembilan, (<https://docs.google.com/file/d/0B-e6qHPbxSdNd1oxMUVCVG82a0E/edit>), Title: Nasir al-Din Tusi's Ethics: Between Philosophy, Shi'ism and Sufism Author: Wilferd Madelung Source: Ethics in Islam in 1985 edited Publication: Undena Publications (<https://iis.ac.uk/sites/default/files/Nasir%20al-Din%20Tusi%27s%20Ethics%20-%20final-886228271.pdf>) <http://www.myoldmaps.com/late-medieval-maps-1300/229-nasir-al-tusi-world-map/229-al-tusi2.pdf>, https://www-history.mcs.st-andrews.ac.uk/Biographies/Al-Tusi_Nasir.html, https://en.wikipedia.org/wiki/Nasir_al-Din_al-Tusi, <https://muslimheritage.com/nasir-al-din-al-tusi/>, Et Tusi Paraqitja skematike e teknikës trigonometrike të quajtur “Çifti Tusi” (Tusi-couple) Harta e Botës, e punuar nga Et Tusi

Dr. Ardian Muhaj

Rreth kontributit dhe rolit të myslimanëve shqiptarë në mbajtjen dhe mbarëvajtjen e Kuvendit të Arbnit (1703)

Dokumentet e mëposhtme japin një panoramë të qartë të qëndrimit dashamirës të myslimanëve shqiptarë ndaj përpjekjeve të autoriteteve të Kishës Katolike për forcimin e besimit mes anëtarëve të bashkësisë së tyre. Rëndësia e prezantimit të këtyre dokumenteve bëhet më e madhe po të kemi parasysh se edhe pse janë dokumente të njohura nga specialistët e kësaj periudhe dhe tematike, kanë mbetur të mënjanuara dhe të pakontekstualizuara.

Nga dokumentet kuptohet se shqiptarët myslimanë që ushtronin autoritetin e shtetit osman në trojet stërgjyshore, në rastin konkret Hydaverdi Pasha, pinjoll i shquar i Mahmutbegollëve të Pejës, qeveritar i përgjithshëm i sanxhaqeve të Shkodrës dhe Dukagjinit, shprehnin në mënyrën më të qartë bashkëjetesën fetare që ka farkëtuar shoqërinë shqiptare për shekuj me radhë. Në këtë rast, myslimanët shqiptarë gërshetojnë dy gurra nga të cilat buronte qëndrimi i tyre mbështetës e dashamirës ndaj bashkatdhetarëve të tyre të krishterë, në rastin konkret të atyre katolikë: qëndrimet doktrinale dhe burimore islame dhe traditën më të mirë të bashkëjetesës shqiptare.

Të tri dokumentet janë përzgjedhur nga korrespondenca e arqipeshkvit të Tivarit, Vincenc Zmajevič me Selinë e Shenjtë, të hartuara në formën e relacioneve me karakter informues e përditësues që ishin praktikë e zakonshme e administrimit kishtar të Kishës Katolike. Interesi për njohjen me këto marrëdhënie të shkëlqyera dhe bashkëjetesë shembullore bëhet

**Shqiptari
Hydaverdi Pasha
bënte kujdes dhe
porosiste vartësit e
vet që klerikët dhe
misionarët katolikë
të lejoheshin të
shëtisnin kudo për
të vizituar të
krishterët në
dioqezat e tyre**

edhe më i madh për faktin se në shqyrtimet mbi Kuvendin e Arbnit të vitit 1703 autorët e ndryshëm nuk kanë shprehur interes për të vënë në dukje këtë aspekt thelbësor të shoqërisë shqiptare të kësaj periudhe. Nga ana tjetër, sjellja në vëmendjen e opinionit të sotëm e këtyre dëshmive të dorës së parë, nuk duhet lënë pa u shoqëruar me përmendjen e faktit se këto dëshmi të bashkëjetesës ndërfaqetare që theksojnë rolin thelbësor dhe të patjetërsueshëm të myslimanëve shqiptarë, vijnë nga një periudhë e mbushur me akte intolerance e ekstremizmi të skajshëm fetar, që arrin deri në akte gjenocidale nga ana e ushtrive pushtuese austriake, të ndihmuara nga elementë të radikalizuar fetarisht, që vepronin në trojet shqiptare, duke përfshirë edhe klerikë të rangut të lartë, deri në peshkopë joshqiptarë.

Këto dokumente japin një

panoramë krejt tjetër nga shprehjet e intolerancës dhe ekstremizmit fetar në fushatën e vetëm pak viteve më përpara të forcave austriake dhe forcave të tyre mbështetëse, të cilat kryen mizori të padëgjueshëm kudo ku shkelën, duke e kurorëzuar këtë sjellje me holokaustin e qytetit të Shkupit në vitin 1689, ku iu vu flaka qytetit dhe banorëve që gjendeshin në qytet. Urdhëresat e Hydaverdi Pashë Begollit për mëkëmbësit e vet në sanxhaqet e Shkodrës dhe Dukagjinit që të mos trazonin peshkopët, priftërinjtë ose misionarët katolikë në punën e tyre dhe t'u siguronin liri të plotë në mësimin e të krishterëve katolikë, pa asnjë kundërshtim nga kushdo qoftë, pasqyrohen besnikërisht nga ipeshkvi Zmajevič dhe i transmetohen Romës zyrtare dhe vetë Papës. Shqiptari Hydaverdi Pasha bënte kujdes dhe porosiste vartësit e vet që klerikët dhe misionarët katolikë të lejoheshin të shëtisnin kudo për të vizituar të krishterët në dioqezat e tyre e të vepronin sipas asaj që ua kërkonte rregulli i tyre fetar.

Këto dokumente janë të ruajtura në Arkivin e Propaganda Fides, në Vatikan. Faksimile të tyre gjenden në Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë dhe janë botuar pa përkthim nga Peter Bartl.¹ Në botimin e tyre, P. Bartl i është përmbajtur origjinalitet, madje nuk i ka dhënë as shkurtesat e shumta të dokumenteve në formën e tyre të plotë. Në paraqitjen tonë i jemi referuar botimit të P. Bartl, duke e konsultuar me faksimilet e dokumenteve të ruajtura në Arkivin e Institutit të Historisë.

Dok. 1

Pasi mbaroi lumturisht vizita në Serbi, po ndërmarr tani këtë të Shqipërisë, e shtypur nga abuzime të panumërta të thelbësishme, për të cilat më duket e mbara që të mund të bëjmë një mbledhje të Sinodit Provincial, nëse i madhi Zot do më japë kënaqësinë që të më jepet mundësia nga qeveritarët turq, që ta mbajmë solemnisht, pasi e vlerësoj si shpërblimin e vetëm ndaj gjendjes së rrënuar të Provincës. Në Pejë, rezidenca e Pashait Suprem të Shqipërisë gjeta at Pjetrin nga Vukovari dhe at Antonin nga S. Felice, misionarë apostolikë të mbështetur e mbrojtur nga komandanti në atë mënyrë që nuk kanë as pengesën më të vogël në ushtrimin e shërbesës së tyre. Megjithatë, jetojnë mjerisht në një shtëpi të vobektë, pasi nuk kanë marrë ende furnizimet e caktuara nga Bamirësia e Shkëlqesisë së tij Zv. Mbreti, dhe nuk e dinë se i kujt është faji për këtë. Ankesave të tyre të drejta iu bashkohem me lutjet e mia në mënyrë që Mëshira Juaj e pashoqe të denjojë t'u dërgojë furnizimet e duhura fetarëve të përmendur, të rënë në një mjerim të tillë për shkak se nuk kanë marrë tash sa vite asnjë ndihmë. Gati e kishin ndarë mendjen për ta braktisur misionin, por unë iu dhashë kurajë që ta vazhdonin dhe me ca ndihma që më kushtuan, kanë mbetur në atë vend me shpresën që të ndihmohen sa më parë të jetë e mundur nga Shkëlqesia Juaj dhe ky mision t'ia dalë të japë frytet e veta për besimtarët e atyre zonave pothuajse të braktisura nga ndihmesat fetare e të jetë zbulurim për fenë pasi është e vetmja në mesin e shumë të feve të tjera në qytetin osman, rezidencë e Komandantit Suprem të krejt Shqipërisë. Kaq për momentin, i falemnderës mbështetjes suaj bujare, duke u rezervuar që në një kohë më të përshtatshme t'u dërgoj lajme të tjera lidhur me vetë misionin dhe ju shpreh nderimet e mia të përlulta. Juban të Shkodrës, 1 nëntor, 1702. Arkivi i Vatikanit. Propaganda Fide, SC (Albania) Vol. 5, f. 531.

Terminata felicem.te la uisita di Seruia, intraprendo hora quella d'Albania, oppressa da infiniti abusi essentialis.mi, p(er) li quail mi conuerrà deuenire all'unione d'un Sinodo Prouinciale, se Iddio Sig.re mi donarà il content d'ottenere la facoltà di celebrarlo sollemem.te dalli Turchi commandant, colli quail non ometterò alcun mezzo, p(er) effettuarlo, stimandolo unico compenso al stato deplorabile della Prouincia, A Pechia, Residenza del Supremo Bassà d'Albania trouai il P. Pietro da Vicouaro, e P. Antonio di s. Felice Missionarij Ap(osto)lici, assistiti, e protetti dal commandante in maniera, che non trouano minimo contrasto nell'esercizio del loro Ministero; uiuono p(er)ò miseram.te in una casa à pigione, senz'hauer sin hora hauuto le prouisioni assegnateli dalla Charità dell'EEm.ze V.re, non potendo sapere di chi sia il difetto. Alle loro giuste doglianze unisco io le mie deuote supplication, p(er)che la loro esemplaris.ma Pietà si degni prouedere all'indigenze de suddetti religiosi, costituiti in total miseria p(er) no(n) hauer hauuto in tanti anni alcun soccorso. Erano quasi rissoluti d'abbandonare la Missione, ma animandoli io alla permanenza con qualche aiuto di costa, sono restati nel med.mo posto con speranza d'essere opportunam.te soccorsi dall'EE.ze VV.e. questa Missione riesce è di frutto dell'anime circonuicine quasi abbandonate dall'assistenze religiose, e di decoro alla Religione p(er) essere sola tra tutte l'altre nella Città Ottomana, Residenza del Supremo

Commandante di tutt'Albania. Tanto p(er) hora humilio alla loro generosa prouidenza, riseruandomi à tempo più proprio rassegnarle alter notitie, spettante la Missione stessa, e le faccio hum.ma riuerenza. Jubani di Scutari p.mo Nou.re 1702.

Dok. 2

Ka bekuar Zoti i Madh degët e shenjtëruara të sundimit të Shenjtërisë Suaj dhe shënimet e përshtatshme për Shkëlqesinë Tuaj përgjatë krejt udhëtimit tim apostolik nëpër Shqipëri, deri edhe me njëfarë mbështetje të jashtëzakonshme dhe me privilegjet e padëgjua komandantëve turq. I privilegjuar nga Hyda Pasha me dashamirësi bujare, deri aty sa më ka trajtuar me respekt të ndërsjellë përmes rikthimit të vizitave, dhe duke më vendosur në krye të vendit në Divanin [Këshillin] e tij. Kam përfutur nga ky rast i çmuar duke e bërë vizitën time me të gjitha solemnitetet e mundshme në mënyrë të tillë që nuk do të kisha mundur të veproj më me lehtësi as në mes të një vendi të krishterë. I ndihmuar nga njeriu më i rëndësishëm i oborrit të tij kam pasur liri të plotë për të ushtruar detyrat e mia dhe haptas, saqë më dukej sikur të isha në mes të vendeve të krishtera. Kjo veprimtari publike më ka dhënë mundësinë që të njoh krejt gjendjen shpirtërore të Shqipërisë, dhe duke e gjetur të shtypur nga abuzime të panumërta e të kahershme më ka dhënë shtysë që të thirr një Sinod Provincial për argumentim më të mirë të fesë dhe për të zhdukur



zakonet e dëmshme të konstatuara. Përpyjekja ishte shumë e madhe në një Provincë të mbushur me inate dhe e ndodhur në kufi. E i nxitur nga nevoja e madhe kam pasur ndihmën e veçantë të Zotit lëvdur qoftë duke e realizuar fatmirësisht pa kurrfarë pengesë, përkundrazi me mbrojtjen e posaçme të akorduar nga vetë turqit. Tani po e përkthej në gjuhën shqipe për ta kuptuar më qartë klerikët pak të arsimuar dhe duke iu nënshtruar gjykimit të vetë Shkëlqesisë Suaj shoqëruar me relacionin e plotë të vizitës sime. Perast, më 25 shkurt 1703. Drejtuar Kongregatës së Shenjtë të Propagandimit të Fesë, Romë. Arkivi i Vatikanit, Propaganda Fide, SC (Albania) Vol.5, f. 665.

Hà benedetto Iddio Sig.re le Santis. me brame di Sua San.tà Regna(n)te, e li noti pietosi del'E Enze VV.e nel corso intiero della mia apostolic peregrinatione p(er) l'Albania sino con certa sraord.ria assistenza, e fauore insolito de Turchi commandant. Fauorito dall'Odda Bassà con generose cortesie, sino à tartar meco di pari colla restitutione delle uisite, e cedermi il primo luogo nel suo Diuano, hò colto la più pretiosa congiuntura facendo la uisita con tutte le solennità possibili in maniera, che più no(n) l'hauerebbe potuto operare in mezzo della Christianità. Assistito del primo huomo della sua corte hò hauuto libero esercizio delle mie incombenze à segno, che mi pareua essere, in mezzo della Christianità. Tale publica procedura m'hà apportato tutta la cognition dello stato spiritual d'Albania, che trouandola oppressa da infiniti abusi anche inueterati hò stimolo debito indispensabile conuocare un Sinodo Prouinciale p(er) maggior augumento della Fede, et estirpatione delle proue dannose consuetudini. L'impegno era considerabile in una Prouincia piena di gelosie posta nelli confine, pure mosso dall'estrema necessita hò prouato particolare assistenza di Dio benedetto nel terminarlo felicem.te senza ombra, anzi con particolare protetione de Turchi stessi. Hora lò uado traducendo nella lingua

Albanese p(er) più chiara intelligenza degl'Eccl(esiast)ici poco intelligenti, p(er) humiliarlo poi al supremo giuditio dell'EE.e VV.e colla relatione intiera della mia uisita. Perasto li 25 Feb.o 1703. Alla S. Cong.e de Prop. Fide-Roma. APF, SC (Albania) Vol.5, f. 665.

Dok. 3

Detyra e vështirë e vizitorit apostolik të Shqipërisë dhe Serbisë, i shoqëruar me udhëzime të qarta e të respektuara nga Selia e Shenjtë dhe nga Kongregata e Shenjtë, duke më shkëputur nga çdo angazhim tjetër, më ka mbajtur të përqendruar tërësisht në rëndësinë e misionit. Nuk kam provuar të turqit egërsi barbare, por mirësjellje bujare, dhe as që do të kisha pasur trajtim më njerëzor nga shpirtat e të krishterëve më të devotshëm. Merni me mend, reverenca Juaj e Shenjtë vetëm mirësjelljen zyrtare që ka shprehur në takimin tonë të parë Pasha Suprem i Shqipërisë. Ky, kur ishte me ushtrinë e tij në fushim, gjysmë dite rrugë larg, dërgoi të birin në moshë të njomë, 14 vjeç për të më uruar mirëseardhjen. Dy milje larg nga kampi dërgoi 80 krierët kryesorë të ushtrisë të gjithë me kuaj për të më takuar dhe vetë ai erdhi pasi zbriti prej tendës së tij i shoqëruar nga buçimat e trumbetave, pipëzave, e tambureve, me goditjen e dy topave luftarakë, me ushtrinë të rreshtuar. Më priti me një kortezi të admirueshme me përqaftime të ndjera, dhe me dashamirësi prej mikut, ose më saktë prej vëllait. Mbeti i shtangur prej shprehjes së një respekti kaq të lartë, që më pas e konfirmova edhe në takimin e dytë pas katër muajsh me shumë mirësi të mrekullueshme, duke më lëshuar gjithnjë kreun e vendit në Divanin e tij, duke më vendosur jo vetëm mbi hoxhallarët, klerikët e tyre, por edhe mbi Myftiun, ose peshkopin e tyre, duke më shoqëruar në Turqi gjithmonë edhe me milje të tëra larg.

Si ju duket zotëri Pastritio shumë i respektuari im. A nuk janë këto mrekulli tek turqit? Por dëgjo më tej!


Edhe pse kishte marrë bashkë me të birin pak më shumë se 800 skude dhurata që i kam dërguar, megjithatë asgjë nuk ka shijuar prej tyre sepse mi ka kthyer të gjitha me dhurata. Më dha si këmbim tributin e një viti për qytezën e Grudës, Telikut, Briskës, e Luarzës që ishin gati për të lëshuar fenë ngaqë nuk kishin me se të paguanin. Liroi klerin e Tivarit dhe Sapës nga pagesa vjetore e satarakit, që është një zekin për kokë në vit për çdo prift, dhe vetëm ky tribut i satarakit mbliidhte të paktën 350 zekinë venediks.

Por dëgjo edhe këtë! Një i krishterë i mjerë i kapur në flagrancë duke vepruar kundër politikës së qeverisë ishte dënua me vdekje. Askush nuk guxonte të kërkonte nga Pashai ta falte, pasi ishte shumë i zemëruar me të. Unë iu luta që t'ia ndryshonte dënimin me vdekje bash në kohën që xhelati kishte nxjerrë shpatën për t'i prerë kokën dhe priste vetëm shenjë e zotërisë. E mu dha falja edhe më e madhe se sa kërkoja sepse jo vetëm që ia fali jetën për të cilën iu luta, por edhe e liroi. Vetë turqit habiteshin nga mirësitë kaq të shumta që më bënte Pashai. Madje për keqardhjen time dhe për rrezik të të dyve, thoshin haptas "Arcibiscopie Pascù po kauurio" ose "Arqipeshkvi e paska ba pashanë të krishterë".

Me një fjalë pasi më ka trajtuar me respektin më të madh për dy ditë në tendat e fushimit gjithmonë i mirësjellshëm, përherë bujar me një dashamirësi të mrekullueshme e të natyrshme, më privilegjoi duke caktuar si shoqërues timin gjatë udhëtimit tim Pashain e shatorreve dhe i pari në oborrin e tij dhe po aq dashamirës ndaj meje sa edhe eprori i tij, duke u dhënë urdhra të prera komandantëve të Provincave nën varësinë e tij se duhet të krijonin mundësinë që në udhëtimin tim të më prinin një skuadër të krishterësh të armatosur. Kështu e kam vazhduar udhëtimin tim gjatë gjithë kohës në mënyrë të hapur dhe ceremoniale dhe me këtë ngushëllim për ata të krishterë të varfër ia lë në dorë të më vlerësojë virtytshmëria Juaj, pasi të ngratët nuk ishin mësuar të shihnin

peshkopët të shëtisnin në atë mënyrë, por gjithnjë me dyshime, gjithnjë me rreziqe. Kishin një përshtirshmëri të shenjtë dhe i luteshin Zotit të Madh dhe Mëshirës atërore të Shenjtërisë Suaj sunduese me fjalë shumë të buta. Prandaj e pashë si detyrim që të kërkoj për zgjidhjen e duhur, dhe thirra Koncilin Provincial ose më saktë Nacional, përderisa u mbajt me mbështetjen dhe ndërhyrjen e tre arqipeshkëve. E kam mbajtur pa kurrfarë kundërshtie në mes të Shqipërisë me shfaqjen dashamirëse të forcave turke të gatshme për të ndëshkuar keqbërësit. Marrin kohën më të çmuar të udhëtimeve duke shpalosur lejet përkatëse me ndihmën e veçantë të Zotit lëvdur qoftë, se përndryshe nuk do të kisha mundur t'i bëj ballë një lodhjeje kaq të madhe. Por padijenja e madhe që ekziston në Shqipëri e bën të nevojshëm një udhëzim të tillë. Madje për këtë qëllim kam përkthyer tërësisht vetë Koncilin [vendimet e Kuvendit] në gjuhën shqipe, në mënyrë që të kuptohet më mirë nga priftërinjtë, të cilët nuk e njohin gjuhën latine. Perast, më 10 korrik 1703. BAV, Borg. Lat. 731, f. 70-71v.

L'arduo Ministero di Visitatore Apostolico d'Albania, e seruia, ingiontomi con espresso riuertiti commandi della S. Sede, e della S. Cong.e si come m'hà frastornato da ogni altra application, cosi m'hà tenuto immobilm.te fisso all'importanze dell'ufficio. Non hò prouato nelli Turchi Barbara fierrezza, ma generosa cortesia, ne più umani trattamenti hauerei sperimentato nell'animo de più deuoti Christiani. Consideri VSReu.a solam.te le maniere obliganti, ch'm'hà usato nel primo congress il Supremo Bassà d'Alb(ani) a. Era questo coll'esercito in campagna, mezza giornata lontano spedi il figliolo in età tenera di 14 anni p(er) compiere meco, due miglia distante dal campo spedi 80 principali capi dell'esercito tutti à cauallu p(er) incontrarmi, et egli stesso uscito fuori del proprio padiglione à sono di trombe, pifari, e tamburi, à sbarro di due canonici di campagna, coll'esercito in ordinanza m'accorse con mirabile cortesia trà affettuosi abbracciamenti,



e con tenerezza d'amico anzi fr(at)ello. Restai estatico à tanti eccessi di cortesia, confermati poi nel second incontro doppo 4 mesi con partita di finezze mirabilis, cedendomi sempre il primo posto nel suo Du=iuano, facendomi precedere no(n) solo alli Hoggia loro Sacerdoti, ma anche al Mufti loro Ves.o, accompagnandomi sempre Turchia anche con incommode di più miglia. Che le pare S.r Pastritio mio riuierend.mo? No(n) sono questi miracoli nelli Turchi? Ma senta d'auantaggio; Hauerà egli riceuuto col figliolo poco più di ottocento scudi de regali, ch'io gl'hò portato, ma niente meno hauerà consumato p(er) corrispondere alli miei doni.

Donò à ia intercession il tribute p(er) un anno alla Villa di Gruda, Telichi, Brisca, e Liuari, che stauano p(er) appostatare no(n) hauendo con che pagarli; Liberò li due Cleri d'Antiuari, e di Sappa dall'annuale agrauio di Sataraccio, ch'importa un zec.no p(er) testa all'anno p(er) ogni Ecclesiastico, e tanto il tribute sud.o, come il Sataraccio importerà almeno 350 zec.ni Venetiani. Ma senta anche questa. Un pouero Christiano colto nel fatto contrario alle massime politiche del gouerno fù condanato à morte; nisuno ardiua supplicare p(er) la gratia il Bassà, ch'era molto adirato, lò pregai io che gli commutasse la pena di morte in tempo ch'il carnefice staua colla spade nuda à tagliarli la testa, et aspettaua solam.te il cenno del Prone; hebbi la gratia molto più abbondante,

p(er)che gli condonò e la uita p(er) la quale sola pregauo, e la libertà ancora. Li Turchi stessi si stupiuano di tante gratie, ch'il Bassà mi compartiu, anzi con mio dispiacere, e pericolo di tutti due, diceuano publicam.te, Arcibiscupie Pascù pokauurio, l'Arciues.o hà fatto il Bassà Christiano.

In somma doppo hauermi trattato lautissimamen)te due giorni sotto li padiglioni sempre cortese, sempre generoso con una simpatia mirabile di genio, mi fauori colla compagnia durante il tempo della peregrinatione, del suo Sciator Bassà primo corte, soggetto niente inferior al Prone nella cortesia, a con ordini espresso alli commandant subaltern delle Prouincie, che douessero far precedere la mia marchia da villa da una squadra di Christiani armati. Così io hò continuato la uisita tutto il tempo in forma publica, e trionfante, e con quel consolation de'poueri Christiani lò lascio considerare alla Sua Virtù, no(n) essendo soliti li pouerelli uedere li Vescoui marciare in q(ue)lla forma, ma sempre con sospetti, sempre con pericoli; Hauenuano una Santa Ambitione, e benediceuano Iddio S.re, e la paterna Charità di Sua Santità Regnante con uoci di molta tenerezza. M'impegnai p(er) debito al douuto remedio, intimaie il Concilio Prouinciale, ò Nazionale che sia, p(er) essere stato celebrato con assistenza, et interuento di tre Arciues.ui, lò celebrai senza contrasto in mezzo d'Albania con positua esibitione delle forze de Turchi p(er) castigare li contumacy. Rubbano li più pretiosi moment alli miei uaggi p(er) stendere li decreti con special aiuto di Dio benedetto, p(er)che altrim.te no(n) hauerebbe potuto reistere à tante fatiche la mia complessione. Ma la grande ignoranza che regna in Albania ricerca tale instrutione, hauendo anche à tal fine tradotto intieram.te il Concilio stesso in lingua Albanese, p(er)che sia meglio inteso dalli Parochi, i quail no(n) hanno cognition della lingua Latina. Perasto li 10 Luglio 1703. BAV, Borg. Lat. 731, f. 70-71v.

1. Quellen und Materialien zur Albanischen Geschichte im 17. und 18. Jahrhundert: Aus dem Briefwechsel des Erzbischofs Vinzenz Zmajevic, herausgegeben und bearbeitet von Peter Bartl, Wiesbaden: Otto Harrassowitz, 1975.

Agron M. Rexhepi

Kontrolli mjekësor i sportistëve

Mjekësia sportive është një degë e medicinës antropologjike që ka detyrat, metodat, teorinë dhe problemet e veta të kërkimeve shkencore. Mjekësia sportive është pjesë e pandarë e sistemit organizativ sportiv dhe të kulturës fizike të njeriut.

Shkrimet e para mbi mjekësinë sportive, respektivisht mbi angazhimin e mjekëve me probleme të sportit, datojnë qysh 2800 vjet para erës sonë.

Mjekësia sportive i ka detyrat e veta të punës, realizimi i të cilave është direkt i lidhur me mirëqenien bio-psiko-sociale të të gjithë atyre që merren me sport, kulturë fizike apo me aktivitete rekreative.

Detyrë parësore e mjekësisë sportive është organizimi dhe realizimi i kujdesit të rregullt mjekësor për shëndetin e të gjithë atyre që merren me sport, kulturë fizike dhe rekreacion. Kontrolli mjekësor, gjithsesi, është mënyra kryesore e realizimit të kësaj detyre të mjekësisë sportive.

Mjekësia sportive është një lëmi shkencore, praktike, me detyrat, metodat, teorinë dhe problemet e veta të kërkimeve shkencore. Si pjesë e antropologjisë mjekësore dhe si lëmi interdisiplinore, mjekësia sportive qëllimet e veta, në formë të kujdesit shëndetësor, hulumtimeve shkencore dhe edukimit, i realizon duke u shërbyer me metodat e një sërë disiplinave të tjera. Mjekësia sportive është pjesë përbërëse e mbrojtjes shëndetësore, si dhe pjesë e pandarë e sistemit organizativ sportiv dhe të kulturës fizike të njeriut, që ka për detyrë organizimin dhe realizimin e kujdesit mjekësor të rregullt mbi shëndetin e të gjithë atyre që merren me sport, kulturë fizike dhe me rekreacion.

Arritjet e mjekësisë sportive shfrytëzohen për ruajtjen dhe avancimin e shëndetit të sportistëve dhe rekreativëve, si dhe ndihmojnë në përcjelljen dhe përmirësimin e rezultateve në sport.

Rezultatet e mira të një sportisti në sportin përkatës janë të kushtëzuara nga:

Shëndeti i mirë i sportistit, që është detyrë e mjekësisë sportive dhe realizohet duke bërë kontrollet e rregullta mjekësore;

Predispozitat gjenetike – (edhe pse talenti së bashku me disa karakteristika morfometrike dhe funksionale janë mbi 90% nën ndikimin e faktorit gjenetikë, nëse në kohën e caktuar kur rritja dhe zhvillimi janë në vrullin më të madh, veprohet me stimulusin e jashtëm të nivelit optimal, do të mundet dukshëm të ndikohet në këta parametra);

Stërvitjet e qëlluara së bashku me motivin (detyrë e trajnerit, e cila po ashtu mund të kontrollohet me realizimin e kontrolleve mjekësore me qëllim të caktuar).

Sikurse çdo lëmi tjetër shkencore, edhe mjekësia sportive i ka detyrat e veta të punës, realizimi i të cilave është direkt i lidhur me mirëqenien bio-psiko-sociale të të gjithë atyre që merren me sport, kulturë fizike apo me aktivitete rekreative.

Detyrat e mjekësisë sportive janë:

Organizimi dhe realizimi i kujdesit të rregullt mjekësor mbi shëndetin e të gjithë atyre që merren me sport, kulturë fizike dhe me rekreacion:

Vizita sistematike (anamneza personale – mjekësore – familjare – sociale – sportive, palpacioni, perkusioni, auskultacioni, EKG dhe stres EKG, parametrat vitalë para, gjatë dhe pas ngarkesave fizike, analiza e lëngeve trupore);

Vizita me qëllim të caktuar (vlerësimi i aftësive funksionale në cikle të ndryshme



të jetës fizikisht aktive, përcjellja e ndikimit të sportit dhe aktiviteteve fizike në shëndetin e sportistit, diagnostikimi, shërimi, rehabilitimi dhe riaftësimi për aktivitete fizike pas sëmundjeve apo lëndimeve trupore);

Me hulumtime shkencore të bëhen verifikimi dhe arsyetimi i metodave të tanishme të ekzaminimit të sportistëve, të hulumtohen metodat e reja më të përsosura për testime funksionale, për ekzaminim, diagnostikim, parandalim, shërim të sëmundjeve dhe lëndimeve të sportistëve, si dhe për riaftësimin e suksesshëm të tyre;

Ndihma teorike dhe praktike në perfeksionimin sportiv, si dhe ndikimi në realizimin e detyrës kryesore të kulturës fizike dhe sportit – ruajtja e shëndetit të njerëzit e moshës dhe gjinisë së ndryshme;

Funksionimi i trekëndëshit mjek i sportit – trajner – sportist (mjeku informatën e fituar nga sportisti e diskuton me trajnerin, ndërkohë trajneri informatën e përpunuar ia kthen sportistit);

Këshillat mjekësore – sportive për trajnerë, sportistë dhe mësimdhënës të kulturës fizike;

Promovimi i një jete të shëndoshë, fizikisht aktive, për të gjithë popullatën;

Vlerësimi i kushteve higjienike të ambientit ku manifestohet aktiviteti fizik, respektivisht ku sportistët kanë qasje të shpeshtë, si dhe ndërmarrja e masave për mënjanimin e faktorëve me veprim të dëmshëm në njeriun gjatë aktivitetit të tij në sport, kulturë fizike apo rekreacion (kontrolli sanitar-higjienik).

Për punë më të suksesshme, mjekësia sportive funksionon me tri pjesët e saj:

Preventiva:

- Kontrolli mjekësor i sportistëve dhe të tjerëve që merren me kulturë fizike dhe me rekreacion;
- Vlerësimi i zhvillimit fizik (morfometria dhe aftësitë funksionale);
- Triazhimi i sportistëve (sipas aftësive të tyre);

- Preventiva e lëndimeve;
- Zbulimi, eliminimi apo të paktën minimizimi i faktorëve latentë rrezikues të shëndetit të sportistit, siç janë: mos përgatitja e mjaftueshme fizike, ngarkesa psiko-fizike e sportistit, pakujdesia ndaj shëndetit të vet, bartësit dhe vatrë latente të infeksioneve;
- Ushqimi i sportistëve;
- Anti-doping etj.
- Pjesa e testimeve fiziologjike (ngarkesat fizike);
- Vlerësimi i përgatitjes fizike dhe i gatishmërisë së sportistëve dhe të tjerëve për aktivitete sportive, kulturë fizike dhe rekreacion, si dhe vlerësimi i ndikimit të aktiviteteve fizike në gjendjen e përgjithshme shëndetësore (përcjellja e parametrave kardiorespiratorë para, gjatë dhe pas testimeve submaksimale dhe maksimale).

Shërimi – rehabilitimi:

- Diagnoza e sëmundjes – lëndimit;
- Përcaktimi i procedurave trajtuese;
- Përcjellja e shërimit – rehabilitimit;
- Vlerësimi i shërimit – rehabilitimit.
- Pse duhet të bëhet kontrolli mjekësor i sportistëve?
- Përcaktimi i statusit shëndetësor për sportistët fillestar, respektivisht që për herë të parë e bëjnë kontrollin mjekësor;
- Kontrollimi i ndikimit të aktiviteteve fizike në shëndetin e sportistëve;
- Vlerësimi i përgatitjes fizike – kondicionale të sportistëve në gjendjen e tyre initiale;
- Vlerësimi i ndikimit të stërvitjeve të aplikuara në aftësitë fizike – kondicionale të sportistëve nga sezoni në sezon, apo gjatë gjendjeve tranzitive;
- Rangimi i sportistit brenda klubit të tij në bazë të aftësive funksionale që ka;
- Përcjellja e formës së sportistëve në mënyrë individuale, dhe e klubit në tërësi nga sezoni në sezon;
- Vlerësimi i nivelit rikuperues pas sëmundjes, lëndimeve, apo dëmtimeve sportive.

- Çdo trajner qëllim të vetin e ka që përgatitjen fizike të sportistit të ri nga gjendja e tij initiale (fillestare) ta transformoj në një gjendje finale ideale të planifikuar. Meqenëse kjo gjendje finale rrallëherë në realitet mund të realizohet, më e afërt dhe ende strategjikisht e pranueshme është realizimi i gjendjes finale të dëshiruar, por për fat të keq në shumicën e rasteve realizohen disa gjendje të tjera finale krejtësisht të ndryshme nga ato të planifikuara apo të dëshiruara.
- Për mos shkuarjen në drejtim të duhur të procesit transformues shkaku mund të kërkohet në:
- Sportistin;
- Trajnerin (realizimi dhe lloji i programit stërvitor);

Faktorët e tjerë ekzogjen.

Që procesi transformues i sportistëve të jetë nën kontroll dhe të shkon në drejtim të planifikuar është e domosdoshme përcjellja e gjendjeve transitive të sportistëve (gjendjet ndërmjet asaj initiale dhe finale). Këtë detyrë mund ta realizojnë vetëm njësitet e mjekësisë sportive të pajisura me aparaturat përkatëse për testimin e sportistëve, respektivisht për ekzekutimin e kontrollimeve mjekësore me qëllim të caktuar.

Literatura:

Heimer S., Cajavec R. *Medicina Sporta*, Zagreb, 2006.

The History of Sports Medicine.

<http://www.peachtreportsmed.com/History20%of20%Sports20%Medicine.htm>

Sports Medicine A. J. Ryan.

<http://www.google.ca/search?hl=en&q=Sports+medicine+A.+J.+Ryan&btnG=Search&meta>

Medved R. Sportska Medicina, Zagreb, 1986.

Rexhepi A. Mjekësia Sportive, Prishtinë, 2009.

Sports Medicine A. J. Ryan.

<http://www.google.ca/search?hl=en&q=Sports+medicine+A.+J.+Ryan&btnG=Search&meta>

Ma. Vehbi Shatri

Haxhi Isa ef. Hasanaj

(01.10.1950 – 25.03.2018)

Tri vjet pa misionarin e fesë dhe të kombit, i cili kaloi një jetë të tërë për dritë e të ardhme!

Në plejadën e hoxhallarëve të dalluar të rrafshit të Dukagjinit e më gjerë, të cilët u shkolluan dhe vepruan për çështjen fetare dhe kombëtare, dhe të cilët lanë gjurmë në kujtesën e popullit për dituri islame, mençuri, trimëri e devotshmëri, ishte edhe hoxha i Xhamisë së Vrellës në Istog, mulla Isa Hasanaj. Mulla Isa ishte ndër ata që ishin krenaria e myslimanizmit dhe e kombëtarizimit. Ishte i tillë, meqë ishte predikues i shkëlqyeshëm i fesë islame dhe dha kontribut të madh kombëtar.

Familja

Në Strellc të Ulët, familja Hasanaj është e njohur si familje fetare, atdhetare, patriotike, humane, bujare e përparimtare. Familja e ngushtë e mulla Isës, ishte në ballë të aksioneve të kohës, në çdo rrethanë politike, shoqërore dhe ekonomike. Efendi Isa lindi më 01.10.1950, në fshatin Strellc të Ulët të Komunës së Deçanit. Babai i tij ishte Hajdin Hasanaj, ndërsa nëna e tij ishte Ajshe Hasanmetaj nga Strellci i Epërm.¹

Shkollimi

Isa Hasanaj si një fëmijë, u rritë dhe u arsimua në kushte të rënda ekonomike. Babai Hajdini, si një bujk e një njeri i urtë, i mençur e me vizione të qarta, qysh në moshën fëmijërore të djalit të tij, Isës, pa tek ai zgjuarsinë që ia kishte dhuruar Zoti. Këtë zgjuarsia u mundua që ta

Gjatë punës si imam në Vrellë, mulla Isa, përveç aktiviteteve fetare në të cilat ishte i rregullt, ishte aktivist edhe në aktivitetet e çështjes kombëtare e atdhetare, jo vetëm në fshatin Vrellë, por edhe më gjerë.

zhvillonte, duke e dërguar së pari në shkollën fillore në Strellc, për të marrë pastaj drejtimin kah dyert e Medresesë “Alauddin” në Prishtinë. Në atë kohë, Medreseja ishte shkollë pesë vjeçare. Gjatë shkollimit, mulla Isa tregoi sukses të shkëlqyeshëm. Ai ishte i dashur për medresistët, i respektuar dhe shumë i suksesshëm. Kushtet ekonomike në atë kohë ishte tepër të vështira, andaj Isa u detyronte që gjatë vikendeve të punonte punë krahu, për të siguruar mjetet financiare për shkollim. Pas diplomimit në Medrese, mulla Isa shërbeu si imam gjatë muajit Ramazan për disa vite në fshatrat e komunës së Deçanit. Më pas, Isa efendiu u regjistrua në Fakultetin e Gjuhës dhe Letërsisë.²

Punësimi

Me kërkesë të fshatarëve të Vrellës dhe me pëlqimin e Këshillit të Bashkësisë Islame të Istogut, në vitin 1974, mulla Isa pranohet si imam i xhamisë në fshatin Vrellë. Hoxha punoi dhe veproi në Vrellë deri në kohën e pensionimit.

Gjatë punës si imam në Vrellë, mulla Isa, përveç aktiviteteve fetare në të cilat ishte i rregullt, ishte aktivist edhe në aktivitetet e çështjes kombëtare e atdhetare, jo vetëm në fshatin Vrellë, por edhe më gjerë.³

Kam kënaqësinë që pata rastin të jetoj në kohën kur jetonte hoxha, e po ashtu edhe të bashkëveprojmë në një institucion me hoxhën Isa Hasanaj. Shumë kujtime i ruaj me kujdes në koleksionin e kujtimeve të veçanta. Nuk mundem t’i harroj asnjëherë këshillat e tij që të kemi kujdes në ligjëratat, na motivonte për përgatitje para se të dalim në xhemat – në terren. Ai na thoshte: “Kur keni plan me shku diku në xhemat, ma së pari përgatituni çka keni me fol, e pastaj nisuni.”

Xhamia e Vrellës – Istog

Mulla Isa ishte simbol edhe për të tjerët dhe mbi të gjitha, ai ishte prezantues i një modeli emblemantik. Ai ishte një figurë dhe një personalitet i dalluar, kishte vizion dhe njohuri të kapshme. Ishte elokuent, e elokuenca e tij rrezatonte kudo që ishte e kudo



Foto: Gjatë vizitës së Kryesisë së BIK-ut në KBI-në e Istogut

“Me të vërtetë dijetarët janë trashëgimtarë të të dërguarve. Të dërguarit nuk trashëgojnë dinarë dhe dërhëm, por ata trashëgojnë dituri. Kush e përvetëson atë, ka përvetësuar një fat të madh.”

(Hadith)

që fliste. Ai gëzonte një autoritet të lartë, respekt dhe nder të madh ndër njerëz. Ai kishte emamencë të dalluar. Njihej si i veçantë. Aty, në atë odë ku ishte hoxha, oda shndërrohej në një parlament ku shkëmbeheshin mendime e ide të shkëlqyeshme. Xhamia e fshatit Vrellë ishte një tribunë fetare dhe kombëtare. Mulla Isa ishte gjithnjë aktiv e i palodhur në Këshillin e Bashkësisë Islame të Istogut. Ky Këshill nuk ishte i madh, e edhe ato prona që i kishte, ua kishte uzurpuar pushteti i atëhershëm. Më parë, ky Këshill kishte selinë në qendër të qytetit, ndërsa më vonë mbeti edhe pa objekt të selisë. Deri

pas luftës së fundit, këndi i xhamisë shfrytëzohej për zyre. Ky Këshill përbëhej nga kryetari i Këshillit, sekretari, arkëtari, anëtarët dhe imamët e fshatrave. Kryetarët e këtij Këshilli ishin: mulla Mehmet Mahmutaj (1893-1964), mulla Sadik Hoxhaj (1908-1972), mulla Ragip Dautaj (1919-2006), mulla Nexhmedin Hoxhaj, (tani në pension), ndër ta ishte edhe mulla Isa Hasanaj.⁴

Mulla Isa gjithnjë ishte i angazhuar me poste e detyra në Këshillin e Bashkësisë Islame të Istogut, qoftë si kryetar, sekretar dhe delegat në Kuvendin e Bashkësisë Islame të Kosovës.

Mulla Isa ishte gjithnjë aktiv në xhemat, për çdo rast ai ishte prezent, për të thënë i pari, si në gëzim ashtu edhe në mërzi.

Përfundim

Pas pensionimit, hoxha largohet me familje nga fshati Vrellë dhe filloi jetën në Pejë. Gjatë këtyre ditëve, hoxhës iu paraqit një sëmundje, por që ishte tejet i përmbajtur gjatë sëmundjes. Gjithnjë kujdesej për këshillat në familje, e sidomos gjatë këtyre ditëve, asnjëherë nuk ndalonte të këshillonte, sidomos për vlerën e namazit.

Hoxha kaloi në Ahiret më 25 mars të vitit 2018, për të mos u harruar kurrë. Varrimi i tij u bë në fshatin e lindjes, në Srellc të Ulët, të komunës së Deçanit. Në varrimin e tij morën pjesë qytetarë të shumtë nga Istogu, Peja, Deçani, Klina, e në mesin e tyre edhe një delegacion nga Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, në krye me Myftiun Naim ef. Tërnavë. Në të pamën për hoxhën, morën pjesë masë e madhe pa dallim feje, mysliman dhe jo mysliman.

Kujtimet për mulla Isën janë të paharruara. Hoxha la pas vetës bashkëshorten, katër fëmijë, nipa e mbesa, si dhe la kujtimet, këshillat dhe fjalët e ëmbla që i kishte.

“Me të vërtetë dijetarët janë trashëgimtarë të të dërguarve. Të dërguarit nuk trashëgojnë dinarë dhe dërhëm, por ata trashëgojnë dituri. Kush e përvetëson atë, ka përvetësuar një fat të madh.”

Burimet:

Intervië me djalin e hoxhës. Muhamet Isa Hasanaj, 30.10.2020 Po aty. Mulla Ramadan ef. Shatri – Jeta dhe vepra. Vehbi Shatri, Bashkësia Islame e Kosovës, 2019, fq. 22. Seadbin Abd Errashid, Sahih Suneh, Ebu Davud, vëll. II, Kitab El-Ilm, f. 407, hadithi nr: 3641, Mektebe El-Me'arifë li neshri ve tevziye, Riad, 1421h /2000. Gjatë fjalimit në të pamën e hoxhës, incizim, don Fran Sopi, prift në Pejë.

U mbajtën garat “Të mësuarit përmendsh të dyzet haditheve të Imam Neveviut”

Në ambientet e medresesë së mesme “Alauddin”, më 3 maj, u mbajtën garat “Të mësuarit përmendsh të dyzet haditheve të Imam Neveviut”. Në hapje të këtyre garave mori pjesë edhe kryetari i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili në fjalën e tij përshëndetëse tha se është kënaqësi që në këtë muaj të bekuar Ramazan, të kemi nxënës e nxënëse që bëjnë gara. “Jemi mësuar të shohim gara të natyrave të ndryshme, por si kjo është hera e parë, andaj ka edhe një domethënie shumë të madhe, si dhe është një hap para që në të ardhmen të organizojmë edhe gara të tjera të këtij lloji, duke e rikujtuar dashurinë e njerëzimit, Muhamedin a.s., i cili e ndërroi faqen e historisë mbi këtë tokë” – tha ndër tjera Myftiu Tërnavë.

Drejtori i Medresesë “Alauddin” Fadil ef. Hasani, tha se të mësuarit përmendsh të haditheve të Pejgamberit a.s. është një vlerë e madhe, ndaj ne të gjithë sot jemi fitues, sepse është tejet kënaqësi që sot dëgjojmë fjalët e Resulullahut a.s. nga nxënësit e shkollës sonë, të cilët sot janë fituesit më të mëdhenj të ditës.

Në këto gara garuan 26 nxënës nga Medreseja amë në Prishtinë dhe nga paralelet e saj në Prizren dhe Gjiilan. Prej tyre 14 ishin vajza dhe 12 djem, të cilët garuan në dy grupe. Juria vlerësuese e përbërë nga kryeimami, Vedat ef. Sahiti, dr. Musa Vila, dr. Florentina Termkolli, dhe mr. Muhamed Stublla, vlerësuan se fitueset në garën e hadithit në konkurrencën e vajzave të jenë: Anisa Durguti, 12/4, vendi i parë; Ajna Hajdini, 12/5 dhe Merjeme Bajrami, 11/9, vendi i dytë; Amira Durguti, 12/4, vendi i tretë. Ndërsa në konkurrencën e djemve, juria vlerësoi këta fitues: Seid Arbanashi, 12/3 dhe Ubejd Ademi, 12/2, vendi i parë; Salmir Alija, 11/5, vendi i dytë; Lind



Gllareva, 11/2, vendi i tretë.

Në fund të garave, Drejtoria e Medresesë ndau mirënjohje dhe

shpërblime simbolike për të gjithë pjesëmarrësit, si dhe certifikata për fituesit. (R.S.)

U mbajt sesiioni shkencor “Ramazani dhe refleksionet e tij shumëdimensionale”

Më 3 maj, në ambientet e Fakultetit të Studimeve Islame, për nder të muajit të bekuar Ramazan, u mbajt sesiioni shkencor me temën: “Ramazani dhe refleksionet e tij shumëdimensionale”. Ky sesion u organizua nga Fakulteti i Studimeve Islame në Prishtinë. Pjesëmarrës në këtë sesion ishin tetë panelistë, profesorë eminent të fushave të ndryshme të cilët me kumtesat e tyre paraqitën vlerat shumëdimensionale të muajit të bekuar Ramazan. Hapjen e sesionit e bëri dekani i FSI-së, prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi, i cili fillimisht përshëndeti dhe falënderoi për pjesëmarrje të gjithë pjesëmarrësit. Më tej dekani Rexhepi foli për aktivitetet të cilat është duke i ndërmarr FSI-ja, si dhe për rëndësinë e organizimit të këtij sesiioni pikërisht në muajin Ramazan. Me një fjalë përshëndetëse u paraqit edhe Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, i cili gjithashtu përshëndeti të pranishmit dhe përgëzoi FSI-në për organizimin e këtij sesiioni pikërisht në dhjetë ditëshin e fundit të muajit Ramazan. “Ramazani është muaj i sakrificës, solidaritetit, është një muaj i edukimit shpirtëror e logjiko-mendor, ndaj ne shpresojmë dhe lutemi që të jemi nga ata që i përkushtohemi sa duhet këtij muaji të bekuar. Është kënaqësi që gjendem sot këtu para jush, shoh se këtu kemi ish profesorë të mi, nxënës dhe studentë tanë. Lus Allahun që të na falë shëndet, mirëqenie, begati në këtë muaj” – tha ndër të tjera Myftiu Tërnavë.

Në vazhdim sesiioni i vazhdoi punimet sipas agjendës vijuese, në të cilën u paraqitën prof. dr. Qazim Qazimi, me temën “Historiku i agjërimit dhe obligueshmëria e Ramazanit”; prof. Sabri Bajgora, me temën “Vlera dhe rëndësia e agjërimit në Islam”; prof. ass. dr. Xhabir Hamiti, me temën “Shpallja e Kuranit-historiku dhe thellësia kuptimore e tekstit të tij”; dhe dr. Ilmije Kuqi, me temën “Rëndësia e solidaritetit në muajin Ramazan”.



Në seancën e dytë ligjëruan panelistët: prof. asoc. dr. Sulejman Osmani, me temën “Vlera e Natës së Madhe të Kadrit”; dr. Agron Rexhepi, me temën “Agjërimit nga aspekti mjekësor”; mr. sc. Gyltene Dërguti, me temën “Efektet psiko-sociale të agjërimit të Ramazanit”; dr. Valon Myrta, me temën “Betejat dhe fitoret e myslimanëve në muajin Ramazan”.

Në fund të sesiionit, prodekani i FSI-së, prof. dr. Zija Abdullahu mbajti një fjalë përmbyllëse, ku ndër të tjerash tha: “Arritëm deri në përfundimin e këtij sesiioni shkencor, e që ju falënderojmë për zëmërsisht

për pjesëmarrjen tuaj, duke filluar nga myftiu i cili gjeti kohë që të marrë pjesë në këtë sesiion. Gjithashtu i falënderojmë mysafirët që na e begatuan këtë sesion. Po ashtu falënderojmë edhe profesorët me pjesëmarrjen e tyre, pa mos i harruar assesit studentët tanë që me pjesëmarrjen e tyre e bënë edhe më interesant këtë sesion. Posaçërisht falënderojmë panelistët të cilët ishin edhe thelbi dhe boshti i sesiionit, nga të cilët dëgjuam trajtesa të ndryshme e që në mënyrë praktike shtjelluan temat e Ramazanit me refleksionet e tij shumëdimensionale.” (R.S.)

Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj shtroi iftar për krerët e Bashkësisë Islame të Kosovës

Më 4 maj, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, mori pjesë në iftarin e shtruar nga lideri i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Ramush Haradinaj. Kryetari i AAK-së, z. Haradinaj shprehu mirënjohje për kontributin e çmuar të Bashkësisë Islame të Kosovës në të gjitha etapat drejt lirisë, pavarësisë dhe shtet ndërtimit. Ndaj me këtë rast, ai, në shenjë mirënjohje për kontributin e veçantë dhe meritat e jashtëzakonshme për avancimin e çështjes sonë kombëtare, ndau për Myftiun Naim ef. Tërnavë mirënjohjen “Me besim në Zot, atdhe e shtet”.

Myftiu Tërnavë falënderoi për zemërsisht kryetarin Haradinaj

për iftarin që tashmë është bërë tradicional, duke nënvizuar se BIK-u në vazhdimësi është duke punuar që në Kosovë të mbretërojë harmonia,

bashkëjetesa e respekti i ndërsjellë ndërmjet të gjithë njerëzve, pavarësisht dallimeve etnike e fetare që mund t'i kemi. (R.S.)



Presidentja e Kosovës, znj. Vjosa Osmani-Sadriu shtroi iftar për krerët e Bashkësisë Islame të Kosovës

Më 11 maj, presidentja e Republikës së Kosovës, znj. Vjosa Osmani-Sadriu, e shoqëruar nga kryeministri i Kosovës, z. Albin Kurti dhe nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Glauk Konjufca, shtroi iftar për Myftiun e Kosovës, Naim ef. Tërnavën me bashkëpunëtorë. Presidentja Osmani tha se përgëzojmë të devotshmit që përgjatë këtyre ditëve patën kurajën që ta dëshmojnë sakrificën dhe solidaritetin e tyre, vlera këto që na shquajnë ndër breza. “Me shpresën që Zoti t'i pranojë lutjet e të gjithë atyre që agjëruan këtë muaj të shenjtë, uroj që ndjenja e solidaritetit ndërmjet gjithë qytetarëve të mbizotërojë përgjatë gjithë vitit” – u shpreh ndër të tjera znj. Osmani-Sadriu.

Kryeministri Kurti tha se Ramazani na rikujton t'i vendosim nevojat e të tjerëve para nevojave tona, ndërsa vlerat islame të dhembshurisë dhe

bujarisë marrin edhe më shumë kuptim në situatën aktuale me Covid-19.

Ndërkaq, Myftiu Naim ef. Tërnavë, e falënderoi për zemërsisht presidenten Osmani-Sadriu për shtrimin e këtij iftari, duke thënë se: “... sigurisht se ne si Bashkësi Islame

e Kosovës do të jemi në vazhdimësi gati që të bashkëpunojmë me të gjitha institucionet e vendit tonë, të cilat u krijuan me shumë mundë e sakrificë, gjithnjë për një të ardhme sa më të mirë të shoqërisë sonë, për një prosperitet dhe për forcim të shtetit.” (R.S.)



Urimi i Myftiu të Kosovës, Naim ef. Tërnavës me rastin e festës së Fitër-Bajramit

Me emrin e Zotit Mëshiruesit,
Mëshirëplotit!

Falënderimi i takon Zotit të botëve,
Atë e madhëron çfarë ka në tokë e
çfarë ka në qiej, Ai është i Gjithëpush-
tetshmi, Absoluti.

Salatet e selamet tona ia dërgojmë
më të mirit të njerëzisë, Muhamed
Mustafasë, familjes së tij të pastër dhe
shokëve të tij besnikë.

Të dashur besimtarë, Të
nderuar qytetarë të
Kosovës, Vëllezër e motra!

Sonte është natë e madhe, Nata e
Fitër-Bajramit, me iftarin e së cilës
besimtarët myslimanë përfundojnë
agjërimin e muajit të madhëruar
Ramazan dhe bëhen gati për të
shënuar festën e Fitër-Bajramit, si një
ndër festat më të rëndësishme në
kalendarin mysliman.

Agjërimi në islam është ibadet që
kryhet në kohë të caktuar e me orar
të caktuar, me norma e rregulla të
caktuara, të cilin besimtarët e kryejnë
vetëm për hir dhe kënaqësi të
Krijuesit të Gjithësisë.

Përmes agjërimit, besimtari u afrua
te Krijuesi, u bë edhe më i ndjeshëm
ndaj familjes, rrethit e shoqërisë, më
dorëlidhur e solidar, si dhe më human e
tolerant me familjen, nevojtarin e
shoqërinë.

Muaji Ramazan në vete ka bartur
momente e ibadete të veçanta, të cilat
na kanë shoqëruar duke na fisnikëruar
e urtësuar me nimetet e iftarit, syfyrit,
namazit të teravive, pastaj lutjet e
duatë si dhe veprat e hajrit që bëhen
vetëm për Krijuesin.

Po ashtu, gjatë muajit Ramazan i
kemi shtuar ibadetet e adhurimet, si
dhe jemi kujdesur për tjetrin. Ishim
më shumë pranë me të dashurve
tanë, pranë njëri-tjetrit me ndjesinë
për të dëgjuar e ndihmuar tjetrin.

Pas një muaji agjërimi, sakrificë e
përkushtimi, nesër myslimanët kudo



që gjenden festojnë festën e Fitër-
Bajramit, të bindur që kanë kryer një
nga kushtet që i ka obliguar Zoti i
Madhëruar, e për të cilin ka premtuar
që Ai do ta shpërblejë me shpërblim
të veçantë.

Vëllezër e motra!

Festa e Fitër-Bajramit edhe te ne, si
në tërë botën myslimane, është ndër
festat më të dashura, më familjare e
më popullore, e shtresuar thellë në
identitetin e kulturën e popullit tonë.

Festa e Bajramit si asnjë festë tjetër,
sjellë gëzim, ngrohtësi e qetësi
shpirtërore, për të gjitha kategoritë e
shoqërisë pa marrë parasysh moshën,
gjininë, statusin social e shoqërorë.

Është festë që ofron prindërit më
fëmijët, fëmijët me prindërit, të rinjtë
me të moshuarit, të pasurit më të
varfrit, festë që e ndien dhe e përjeton
e gjithë shoqëria.

Vëllezër e motra!

Edhe këtë Ramazan, si edhe
Ramazanin e vitit të shkuar, e
rrjedhimisht edhe këtë Bajram, po e
presim të përballur me pandeminë
Covid-19, e cila ka shkaktuar pasoja
të mëdha në të gjitha rrafshet.

Në këtë natë të madhe, e në
vigjilje të festës së Fitër-Bajramit
kujtojmë me rahmet të gjithë ata

që kaluan në Ahiret, duke lutur
Krijuesin që t'i marrë në mëshirën
e Tij, ndërsa të infektuarit të gjejnë
shërim sa më parë.

Ne, nesër kemi festë dhe
bashkërisht do të jemi në xhamitë
për ta falur namazin e Fitër-Bajramit,
por të kemi kujdes se virusi ende
është në mesin tonë, andaj për ta
ruajtur vetën e shëndetin publik, ne
kemi hequr dorë nga ana ceremoniale
e manifestimit tradicional të
Bajramit. Në xhami do të jemi duke
i respektuar protokollet anti-covid
dhe për ta falur vetëm namazin e
Fitër-Bajramit.

Ju ftoj që të bëni kujdes edhe me
vizitat tradicionale të Bajramit, do ta
ruajmë karakterin e festës, do të jemi
pranë njëri-tjetrit, por do të kemi
kujdes për shëndetin publik sepse
rreziku nga pandemia nuk ka kaluar.

Vëllezër e motra!

Duke lutur Zotin që ta ketë
pranuar agjërimin, lutjet, ibadetet e
punët tona të mira, kudo që jeni ju
përgëzoj e ju uroj të gjithëve Festën e
Fitër-Bajramit.

Me hair e me të mira na qoftë
Fitër-Bajrami!

Prishtinë, 12 maj 2021

Myftiu i Kosovës

Naim ef. Tërnavë

Shpërndahen 600 dhurata për fëmijë në ditën e Fitër-Bajramit

Më 13 maj, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mori pjesë në shpërndarjen e 600 dhuratave për fëmijë, të cilën e organizoi Këshilli i Bashkësisë Islame të Mitrovicës. Këto dhurata u dedikuan për fëmijët e Mitrovicës, por me një theks të veçantë ato u shpërndanë me dashuri te fëmijët me sindromën down, te fëmijët nga shkolla speciale, si dhe te fëmijët e komuniteteve të ndryshme në këtë komunë.

Myftiu Tërnavë në fillim uroi të gjithë të pranishmit për festën e Fitër-Bajramit, me lutjet për agjërime dhe ibadete të pranuar, si dhe potencoi se dhuratat e tilla në një ditë kaq të veçantë kanë një rëndësi të madhe për shkak të gëzimit që sjellin ato te këta fëmijë. Këtë organizim e përshëndeti edhe i pari i Mitrovicës, Agim Bahtiri. Ndërkaq, kryetari i Këshillit të BI-së në Mitrovicë, Enis



ef. Rama, potencoi se iniciativat e tilla që për qëllim kanë gëzimin e fëmijëve duhet të jenë çdoherë prioritet i të gjithë besimtarëve. Ai ndër të tjera falënderoi gjithë xhamatin që kanë mundësuar gëzimin e këtyre fëmijëve

me këto dhurata. Pjesë e këtij organizimi ishte edhe drejtoresha rajonale e Policisë së Mitrovicës, znj. Afërdita Mikullovc, së bashku me komandantin e stacionit, z. Ahmet Xhoshën.

Myftiu Tërnavë priti në takim anëtarin e xhamisë “Nurul Islam” nga Gjermania z. Shamollin

Më 18 maj, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, së bashku me drejtorin e Diasporës në Kryesinë e BIK-ut, Ekrem ef. Simnica, pritën në takim anëtarin e xhamisë “Nurul Islam” në Monchegladbach të Gjermanisë, z. Dugaxhin Shamollin, i shoqëruar nga sekretari i KBI të Drenasit, Eset ef. Bajraktari.

Myftiu Tërnavë në këtë takim shprehu falënderime për veprimtarinë e anëtarëve të kësaj xhamie, por edhe të gjithë mërgatës sonë në diasporë për punën dhe angazhimin e tyre që jeta fetare atje të zhvillohet ashtu siç është më së miri.

Ai shprehu gatishmërinë e tij dhe të institucionit të BIK-ut për bashkëpunim dhe për koordinim sa më të mirë të aktiviteteve edukativo-fetare.



Nga ana e tij, z. Shamolli falënderoi përزمërsisht Bashkësinë Islame të Kosovës dhe Myftiun Tërnavë për mikpritjen dhe gatishmërinë e tyre që të ketë një bashkëpunim sa më të mirë për të

gjithë. Në fund të këtij takimi, z. Shamolli dorëzoi vitrat dhe zekatin e mbledhur nga mërgata jonë, për çka drejtori i Diasporës, Ekrem ef. Simnica ndau një mirënjohje për kontributin e dhënë. (B.Z.)

Ekrem Dragusha dhuroi truallin për ndërtimin e xhamisë në fshatin Rufe i Ri

Më 8 maj, Ekrem Dragusha nga fshati Rufe i Ri, në këto ditë të bekuara Ramazan, ka dhuruar një truall për Këshillin e Bashkësisë Islame të Lipjanit, për ndërtimin e xhamisë.

Me këtë rast, kryetari i KBI-së së Lipjanit, Zaim ef. Baftiu, shprehu falënderimet me të sinqerta për z. Dragushën, duke e lutur Allahun xh.sh. që kjo dhuratë me vlera të larta të pranohet si sadaka rrjedhëse

(sadakatul xharije) për të dhe për familjen e tij.

Ky akt u shoqërua me lutje për z. Ekrem Dragushën dhe për familjen e tij. Zoti e shpërbleftë dhe urojmë që sa më shpejt të ndërtohet xhamia. (R.S.)



Ambasada e Amerikës përkrahu aksionin “Sofra e Ramazanit”

Më 11 maj, aksioni “Sofra e Ramazanit” i organizuar nga Shoqata Humanitare Bamirëse “Bereqeti”, e cila funksionin në kuadër të Bashkësisë Islame të Kosovës, mori përkrahje nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ngjashëm sikurse edhe vitin e kaluar, kjo Ambasadë ka ndihmuar 25 familje nevojtare anëmbanë Kosovës. Me këtë rast, drejtori i shoqatës “Bereqeti”, Behxhet ef. Ajvazi ka pritur në takim John Bushin, përfaqësues për çështje fetare pranë Ambasadës së Amerikës. Drejtori Ajvazi falënderoi për zemërsisht z. Bush, e nëpërmjet tij edhe Ambasadën e Amerikës, si dhe gjithë popullin amerikan për ndihmën e dhënë për popullin e Kosovës me vite të tëra. Ndërkaq, z. Bush, u shpreh tejet i impresionuar me punën dhe aktivitetin e shoqatës “Bereqeti”. “Ne jemi shumë të kënaqur dhe të gëzuar që edhe këtë



vit po na mundësohet që të jemi pjesë e aksionit “Sofra e Ramazanit”. Shoqata “Bereqeti” edhe këtë vit, sikurse edhe viteve të tjera po bën një punë jashtëzakonisht të mrekullueshme në ndihmë familjeve

nevojtare”- tha ndër të tjerash z. Bush. Në fund të takimit, drejtori Behxheti, në shenjë falënderimi ndau një mirënjohje për Ambasadën e Amerikës për kontributin e tyre të çmuar dhënë për bamirësi. (B.Z.)

Kremtohet festa e Fitër-Bajramit



Si tradicionalisht, pas përfundimit të muajit Ramazan, më 13 maj 2021, në të gjitha xhamitë e Republikës së Kosovës, si në tërë botën ku jetojnë myslimanët, me gëzim e hare u kremtua përfundimi i muajit të agjërimit – Ramazani sherif, duke e falur namazin e Fitër-Bajramit. Nën respektimin e protokollit të pandemisë COVID-19 manifestimi qendror kushtuar festës së Fitër-Bajramit për Kosovë u mbajt në xhaminë “Sulltan Mehmet – Fatih” në Prishtinë ku numër i madh i qytetarëve kanë kryer këtë ritual fetar, kurse brenda objektit të xhamisë është kërkuar vazhdimisht respektimi i distancës. Bazuar në udhëzimet e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, duke pasur parasysh se ndodhemi në situatën e pandemisë, namazi i sabahut është falur në shtëpi.

Namazit të Fitër-Bajramit i priu kryemami i Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ndërsa hytben e Bajramit e mbajti kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili edhe njëherë iu drejtua opinionit të gjerë me mesazhin për këtë festë, duke nënvizuar se ne sot po shënojmë festën e Fitër-Bajramit e cila në vetë

përmban përkushtimin ndaj Zotit të cilin besimtarët me bindje e përkushtim e dëshmuar gjatë tërë muajit të bekuar Ramazan.

“Muaji Ramazan na mbajti të bashkuar në ibadete dhe mirësi, namaze, iftare e syfyr, në zekat e sadaka, si dhe në solidaritet e bamirësi e mirëkuptim. Sot kemi festë që na bashkon me familje dhe më të dashurit tanë, fqinjët dhe fafësin tonë. Kjo festë për besimtarët vije si një freski që gëzon dhe shëron shpirtin e besimtarëve, ngroh fëmijët e familjeve tona, prindërit tanë dhe tërë besimtarët myslimanë anekënd botës. Feja islame angazhohet në

formimin e një shoqërie të shëndoshë e humane. Sot kemi festë që na bashkon me miq e fafëfis.” Festa e Fitër-Bajramit kultivon në formën më të mirë ndjesinë e mirëkuptimit, tolerancës, harmonisë, respektit dhe bujarisë, vlera këto që fisnikërojnë individin dhe shoqërinë. Kjo festë madhore parqet një nga momentet që shërbejnë për të njohur vetën, për të mësuar drejt misionin tonë dhe për të ruajtur ekuilibrin mes shpirtërores dhe materiales” - ka nënvizuar Myftiu Tërnavë.

Ai më tej tha se edhe në këtë Ramazan sikurse në Ramazanin e vitit të kaluar rrjedhimisht edhe këtë



Bajram po e presim të përballur me pandeminë Covid-19 e cila ka shkaktuar pasoja të mëdha në të gjitha rrafshet. Në këtë ditë feste kujtojmë me rahmet të gjithë ata që kaluan në ahiret duke lutur krijuesin që t'i marr në mëshirën e Tij ndërsa të infektuarit të gjejnë shërim sa më parë.

Ai duke përfunduar mesazhin e Fitër-Bajramit tha se ne sot kemi festë dhe bashkërisht po e shijojmë festën e madhe të Fitër-Bajramit, por duhet të kemi kujdes që të jemi të vëmendshëm se virusi ende është në

mesin tonë, andej apeloj te ju që ta ruani shëndetin tuaj dhe ta ruani njeri-tjetrin. Po ashtu ju ftoj që të keni kujdes me vizitat tradicionale të kësaj feste. Ne do të festojmë më familjarët, të dashurit dhe miqtë tanë, të ruajmë karakterin e festës, do të jemi pranë njëri-tjetrit, por do të kemi kujdes maksimal për shëndetin publik sepse rreziku nga pandemia ende nuk ka kaluar.

Në fund ai u lut që Allahu t'i ketë pranuar agjërimin, lutjet, ibadetet e punët tona të mira, të gjithëve iu uroj

festën e Fitër-Bajramit, duke iu dëshiruar shëndet e mbarësi kudo që jeni, ju përgëzoj dhe iu uroj të gjithëve festën e Fitër-Bajramit.

Duke marrë parasysh gjendjen pandemike në të cilën gjendemi, si dhe në kuadër të marrjes së masave preventive për mos përshkallëzim të mëtejshëm të situatës, Kryesia e Bashkësisë Islame të Republikës të Kosovës, nuk organizoi pritje për nder të festës së Fitër-Bajramit në Kryesinë e BIK-ut dhe as në selitë e këshillave lokal. (R.S.)

U mbajt duaja e hatmes në xhaminë e fshatit Pllanjane të Prizrenit

Më 16 maj, në një solemnitë madhështorë e në prezencë të shumë xhematëve, Këshilli i Bashkësisë Islame të Prizrenit, organizoi mbajtjen e duasë së hatmes në xhaminë e fshatit Pllanjane, me rastin e përfundimit të leximit të Kuranit nga nxënësit e mësim-besimit. Imami i xhamisë, Selvir ef. Azari, falënderoi të pranishmit për prezencën e tyre, e në mënyrë të veçantë i falënderoi prindërit për interesimin dhe bashkëpunimin e tyre. Në emër të Këshillit të BI-së së Prizrenit foli kryeimami Orhan ef. Bisliman, i cili vlerësoi lart angazhimin e imamit të fshatit. Ai tha se: "Secili imam që jep një kontribut të këtillë bëhet i



pavdekshëm ndër gjenerata. Këta fëmijë të mektebit dhe të tjerët si vëllezërit dhe motrat e tyre, që fitojnë edukatën e mirëfilltë në mekteb, janë pjesa elite e shoqërisë, ata janë e ardhmja e shëndoshë e shoqërisë."

Leximin e Kuranit e përfunduan 31 nxënës, prej tyre 25 vajza e 6 djem. Në fund të programit për nxënësit që përfunduan hatmen, Këshilli i BI-së së Prizrenit ndau nga një certifikatë dhe nga një dhuratë modeste. (R.S.)

Redaksia e revistës "Dituria islame" mbajti mbledhjen e radhës

Më 20 maj, redaksia e revistës fetare, shkencore e kulturore "Dituria islame" mbajti mbledhjen e radhës, në të cilën u diskutua dhe u analizuan tre numrat e fundit të revistës 363, 364 dhe 365. Të pranishëm në këtë mbledhje ishin kryeredaktori i revistës, dr. Ajni Sinani, sekretari i redaksisë, dr. Rexhep Suma, anëtarët e redaksisë, prof. Sabri Bajgora, mr. Ramadan Shkodra, dr. Fahrush Rexhepi, PHD (c) Besir Neziri, mr. Driton Arifi, Bashkim Mehani si dhe Bajram Zeqiri.

Hapjen e mbledhjes e bëri kryeredaktori dr. Ajni Sinani, i cili prezantoi rendin e ditës dhe shfaqti bindjen dhe vlerësimin e



përgjithshëm të artikujve të publikuar. Më pas anëtarët e redaksisë paraqitën mendimet e tyre përkitazi mbi artikujt e publikuar në revistë. Ata edhe njëherë theksuan vlerën dhe peshën e lartë që përçojnë

këto shkrime të lexuesi dhe opinioni i gjerë. Në fund kryeredaktori Sinani, falënderoi për angazhimin dhe punën e kritikës konstruktive të anëtarëve të redaksisë që kanë dhënë deri më tani. (R.S.)

Në të gjitha xhamitë e Kosovës u mbajt hytbe kushtuar përgjegjësisë ndaj fëmijëve

Me rekomandim të kryetarit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim ef. Tërnavë, më 21 maj, në të gjitha xhamitë e Kosovës është mbajtur hytbe me temën kushtuar përgjegjësisë individuale dhe kolektive që kemi ndaj fëmijëve. Në mes të tjerash në këtë hytbe thuhet se dashuria për fëmijët është ndjenjë e lindur natyrshëmrisht te njeriu. Fëmijët janë gëzim dhe kënaqësi, janë stoli e jetës së kësaj bote (El Kehf, 46). Kjo ka bërë që edhe të Dërguarit e Allahut (paqja qoftë mbi ta!) të shfaqin dashuri për fëmijët. Pejgamberi Zekerija a.s., qe lutur: “(Përkujto) Edhe Zekerijanë kur e luti Zotin e vet: “Zoti im, mos më lë të vetmuar se Ti je më i miri trashëgues (pas çdokujt).” (El Enbija, 89). Po ashtu më tej u tha se meqë fëmijët janë dhuratë hyjnore, atëherë edhe përkujdesja për ta është detyrë e shenjtë dhe përgjegjësi për secilin prind. Kjo edhe për shkak të rolit të pazëvendësueshëm që ka prindi në edukimin e fëmijës së vet. Roli i prindit, siç na mëson Muhamed a.s., është vendimtar në përcaktimin e rrugës të cilën do ta ndjek ai fëmijë. Bazuar në këtë, Kurani na urdhëron që të kujdesemi për familjen “O ju që besuat, ruajeni veten dhe familjen tuaj



prej një zjarri, lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët...” (Et Tahrim, 6) Këtë përgjegjësi në edukimin e fëmijëve na e kujton edhe Pejgamberi Muhamed a.s., i cili thotë: “Të gjithë ju jeni kujdestarë dhe të gjithë ju do të përgjigjeni për ata që kanë qenë në përgjegjësinë tuaj.” (Buhariu dhe Muslimi). Imamët në këtë hytbe po ashtu sqaruan se edukimi i fëmijëve nuk është vetëm përgjegjësi e prindërve, por është përgjegjësi edhe e shoqërisë, respektivisht institucioneve tona edukativo-arsimore. Fakti se kohëve të fundit janë shfaqur kaq shumë dukuri negative në mesin e fëmijëve tanë, duhet të na alarmojë të gjithëve, dhe të na vë në lëvizje për të gjetur zgjidhjet më të mira për këto dhe probleme të ngjashme që për bazë kanë edukimin.

Theks të veçantë iu kushtua rolit të prindërve ku në hytbe u tha se

“Prindërit, duhet të jenë në vijën e parë të frontit dhe për asnjë moment të mos ndalen së punuari me fëmijët e tyre, derisa shteti duhet të ndërtojë politika arsimore-edukative që në fokus kanë jo vetëm arsimimin, por mbi të gjitha edukimin e fëmijëve” Këtu rol qendror dhe të pazëvendësueshëm kanë prijësit fetarë të komuniteteve fetare në Kosovë, që me këshillat e tyre mund të asistojnë shumë në ruajtjen e karakterit dhe personalitetit të fëmijëve në secilën etapë të zhvillimit të tyre. Ndaj, le të jetë kjo një thirrje për institucionet tona qeverisëse që ta marrin në konsideratë futjen e edukatës fetare në shkolla, ashtu siç veprojnë një numër i madh i shteteve në perëndim. Le të jetë ky një mesazh i yni kundër këtyre dukurive negative që po prekin fëmijët tanë. (R.S.)

Mblidhen gjeneratat e para të Medresesë “Alauddin” në prag të 70 vjetorit të themelimit

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, ka filluar që nga e shtuna, më 22 maj, shënimin e 70 vjetorit të themelimit të Medresesë “Alauddin” në Prishtinë, duke ftuar gjeneratat e para të kësaj shkolle.

Tashmë të gjithë ish-nxënës të shtyrë në moshë u mblodhën në ambientet e Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës dhe në atë të Medresesë “Alauddin” për të kujtuar hapin më të rëndësishëm në jetën e tyre, si dhe për të diskutuar për sfidat dhe sukseset që kanë pasur gjatë gjithë jetës.





Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, mirëpriti gjeneratat e para të Medresesë “Alauddin” duke potencuar se vetë pjesëmarrja në këtë aktivitet është tejet e rëndësishme. Myftiu shtoi se gjeneratat e para të Medresesë janë me fat për dy arsye, e para, që ishin pjesë e Medresesë “Alauddin” dhe e dyta që ende kanë jetë që të jetojnë dhe të shohin suksesin e kësaj shkolle.

“Në këto ambiente ku sot jemi, takimi ynë merr peshë e rëndësi edhe më të madhe dhe ka simbolikën e vet, ngase pikërisht këtu, në këtë vend, 70-vjet më parë filloi punën dhe nisi rrugëtimin e saj plot bereqet e suksese, së bashku edhe me ju, Medreseja e Prishtinës. Hapja e kësaj vatre arsimore islame shqipe, s’ka dyshim që qe një arritje e madhe për Bashkësinë Islame, sepse ajo rifitoi të drejtën për arsimim e edukim në udhën e Zotit në një sistem që ishte

jo dashamirës i feve e besimeve, por i promovimit të ateizmit e komunizmit”, deklaroi para të pranishme Myftiu Naim ef. Tërnavë.

Kujtimet e tyre i shpalosën me rend përfaqësuesit e pesë gjeneratave të kësaj Medreseje.

Nga gjenerata e parë, të pranishmit i përshëndeti prof. Selim Maloku, pastaj nga gjenerata e dytë prof. Ejup Sahiti, prof. Jashar Jashari nga gjenerata e tretë, prof. Mehmet Gashi nga gjenerata e katërt, si dhe prof. Feti Mehdiu nga gjenerata e pestë, por edhe të tjerët që morën fjalën, vlerësuan lart personalitete të shumta të cilat për vite me radhë kanë kontribuar për Medresenë “Alauddin” dhe Bashkësinë Islame të Kosovës që përmes tyre të përhapet fjala e Zotit në shoqërinë myslimanë shqiptare.

Në anën tjetër, të gjithë pranishmit nga pesë gjeneratat e para të kësaj shkolle evokuan kujtimet dhe mbresat nga e kaluara, si dhe u

shprehën të kënaqur me punën dhe me ndryshimet pozitive që Medreseja “Alauddin” ka pësuar për gjatë gjithë këtyre viteve, e padyshim se një sukses i tillë lidhet ngushtë edhe me vet faktin e kohës, e cila tashmë mundëson demokraci dhe liri për të gjithë qytetarët e vendit.

Të pranishmëve iu drejtua edhe drejtori aktual i kësaj shkolle Fadil Hasani, i cili në pika të shkurta njoftoi ish-nxënësit për sukseset, ndryshimet, por edhe për sfidat që ka kaluar Medreseja “Alauddin”.

Në fund të këtij takimi u kujtuan, me që rast u këndua edhe një Fatiha për të gjithë ata nxënës që ishin në gjeneratat e para të kësaj shkolle, e që më nuk janë në mesin tonë. Medreseja “Alauddin” këtë vit mbush 70 vjet që prej se është themeluar, e që ka kaluar nëpër etapa të ndryshme.

Shoqata Humanitare “Bereqeti” është pajisur me tri automjete pune gjatë muajit Ramazan

Gjatë muajit Ramazan, Këshilli i Bashkësisë Islame të Prishtinës ka siguruar një veturë për degën e “Bereqetit” në Prishtinë, falë donacioneve nga xhemati. Me nga një veturë është pajisur edhe dega e “Bereqetit” në Prizren dhe ajo në Kaçanik, e të cilat janë donacion nga bamirësit vendor dhe nga mërgata. Qendra “Döttingen Türk Kültür Vakefi” në “Türkischer Kulturverein

Döttingen” në Zvicër ka dhuruar automjetin e tipit “Nissan” për nevojat e “Bereqetit” në Prizren, e cila u mundësua nga transporti i “Fanaj Transport”, ndërsa Xhevdet Berisha ka dhuruar automjetin tjetër të tipit “Renault” për nevojat e “Bereqetit” në Kaçanik. Këto automjete do të përdoren për nevojat e “Bereqetit”, e cila synon të jetë afër familjeve në nevojë dhe atyre me kushte të rënda



ekonomike. Automjetet e tilla janë të nevojshme edhe për degët e tjera të “Bereqetit” e cila aktivitetin e saj humanitar e shtrinë në tërë territorin e Kosovës dhe më gjerë. (A.C.)

Shkëlqimi i njeriut

Ç'vlerë kanë ato ditë që si net i shohim?
 Ç'vlerë kanë dijet tona nëse veten s'e njohim?
 Ç'vlerë kanë fjalët tona kur me to urrejmë?
 E kush na i do buzëqeshjet kur në lot ua kthejmë?!

Ata që të vërtetën harruan, për jetën nuk dinë,
 A i bën dashuria njerëz, apo njerëzit dashurinë?!
 E nëse dashuria i bën njerëz për t'u bërë si hënë
 Pse s'udhëtuan në rrugën që qielli e ka thënë?!

Koha gjithnjë tretet, por ka për të lënë shenjë,
 Ka për ta dalluar çdo udhëtar të denjë,
 E nëse brenditë lumturohen duke u bërë fanarë,
 Pse nga burgu i shpirtit ende nuk janë ndarë?!

Blerim Halili



Tregimi për dëshmorin

Ai thoshte "një ëndërr e pata"
 Lirinë e bëra me lëngata,
 Stinëve të gjata.

Dheut t'lagësht u rilinda,
 Qiellit veç më shumë iu binda,
 S'ma zhbën qenien autoblanda.

Kam qitë pushkë se m'erdhën n'prag,
 E konaku n'gjak mu lag,
 Që i lirë me zbardhë një ag.

Njoha këngën n'shi e n'borë,
 Besën n'ballë, plisin kurorë,
 Në atë kopsht i thonë dëshmor!

Blerim Halili





KRYESIA
E BASHKËSISË
ISLAME
E KOSOVËS

MEDRESEJA
E MESME
“ALAUDDIN”
PRISHTINË



**“Thuaj: Namazi im, kurban i im,
jeta ime dhe vdekja
ime janë thjesht për Allahun,
Zotin e botëve!**

Për Të nuk ka rival. Dhe për këtë jam i urdhëruar”.

(El-En'am, 162)

KURBANI 2021

Bashkësia Islame e Kosovës dhe Medreseja e Mesme “Alauddin” në Prishtinë, njoftojnë të gjithë besimtarët se edhe këtë vit organizojnë dhe udhëheqin prerjen e kurbanëve për nevojat e Medresesë “Alauddin” në Prishtinë, me paralelet e saj në Prizren dhe Gjilan. Një sasi e konsideruar e mishit të kurbanit do t'iu ndahet edhe qytetarëve me gjendje të rëndë ekonomike, jetimëve dhe personave me nevoja të veçanta.

**ÇMIMI
I KURBANIT
120 €**



Porosinë tuaj mund ta bëni:

- Këshillin e Bashkësisë Islame
- Përmes bankës & PayPal

NLB Banka

IBAN: XK05 1700200100103672
SWIFT Code (BIC): NLPRXKPR

PayPal: paypal.me/bislame